



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 19. 04. 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 19. 04. 2012. GODINE**

**PRILL – APRIL
2012**

E enjte, më 19. 4. 2012

Drejton seancën kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Mirë se keni ardhur në mbledhjen plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Pasi për pikën e parë të rendit të ditës nuk janë të nevojshëm kuorumi fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Fjalën e ka kërkuar sipas radhës deputetja Teuta Haxhiu.

Veç deklarohu, në emër të tënd apo në emër të Grupit.

TEUTA HAXHIU: Në emrin tim.

Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Krasniqi,

Të nderuar kolegë deputetë,

Me të vetmin qëllim nderimin për të gjithë ata shqiptarë që gjatë vitit 1999 u kidnapuan dhunshëm, u vranë e u zhdukën nga forcat policore paramilitare serbe, Kuvendi i Kosovës, në vitin 2006 ka shpallur 27 prillin- Ditën e të zhdukurve të Kosovës.

As kohe ky vendim i Parlamentit shënoi aktin më të lartë të respektit për këtë kategori njerëzish, që janë dhunuar për së gjalli e për së vdekuri duke iu zhdukur kufomat, ndërsa 13 vjet pas përfundimit të luftës nuk janë gjetur mbi 1500 të zhdukur, do të thotë, sot e kësaj dite vazhdon ankthi i mijëra familjarëve në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Data të cilën Kuvendi e ka shpallur Ditë të zhdukurve të Kosovës ishte zgjedhur ngase më 27 prill të vitit 1999, në Meje të Gjakovës ndodhi masakra më e madhe në Kosovë, kur vetëm për 2 orë u rrëmbyen nga familjarët, u vranë e u zhdukën 376 shqiptarë, kryesisht nga zona e Rekës së Keqe, Junikut e disa fshatra të Deçanit. Po atë ditë ndodhi edhe spastrimi më i madh etnik në ato hapësira, ndërsa të gjitha vendbanimet u dogjën në masën mbi 90%.

Me qenë se shënimi i kësaj dite është shumë afër, për faktin se tradicionalisht, më 27 prill në Meje, marrin pjesë mijëra familjarë nga e gjithë Kosova, unë kam një shqetësim të madh.

Për fatin e keq edhe kësaj radhe ata do të ndahen të zhgënjyer nga mos përmbushja e premtimeve qeveritare, posaçërisht premtimi i vet kryeministrit për ndërtimin e kompleksit memorial. Familjarët pyesin vazhdimisht se ku janë premtimet e Qeverisë, do të pyesin edhe më 27 prill. Është mirë që përgjigjja përsëri t'ju kthehet në lëndinën e lotëve të pikëllimit, natyrisht nga udhëheqësit qeveritarë.

Komuna e Gjakovës, brenda mundësive të saja, ka realizuar projektin përmes një konkursi, me këtë rast edhe zyrtarisht ishte kërkuar përkrahje materiale nga Qeveria e Kosovës, por deri më sot nuk është dhënë asnjë centë.

Në të vërtetë lëndinën e pikëllimit në Meje edhe ka filluar ndërtimi i këtij kompleksi, por nga komuna e Gjakovës e cila si e vetme e ka të pamundur realizimin e këtij meqë projekti ka kosto të lartë. Pra, 900 mijë euro sa nevojiten për këtë kompleks për komunën janë të papërballueshme.

Ndërtimi i këtij kompleksi memorial, i kësaj kujtese kombëtare është domosdoshmëri, mbase për shumë arsye. Kësaj radhe po e përmend vetëm një, parandalimi i harresës sonë kolektive që historikisht na ka kushtuar shumë.

Nga ky vend kryetar unë u bëj ftesë gjithë deputetëve, që të paktën moralisht, më 27 prill të jemi në Mehe të Gjakovës, të solidarizohemi me këta familjarë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Fadil Demaku.

FADIL DEMAKU: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,

Një gjendje krejtësisht e papranuar dhe e padëshiruar e cila krijon imazh tepër të keq në gjithë opinionin e brendshëm dhe atë të jashtëm, është edhe dhuna dhe huliganizmi i shfrenuar në stadiumet tona sportive që herë pas herë po ndodhin. Ato pamje na janë shfaqur në ekranet tona kohëve të fundit edhe me tendenca rritjeje.

Aktivitetet sportive në formë aktive apo pasive përfshijnë një numër të madh të qytetarëve të vendit të cilët për nga mosha shumica janë të rinj. Është e domosdoshme që urgjentisht të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme duke filluar nga vetë Ministria e Kulturës me dikasteret e saj përkatës, pastaj federatat sportive duhet të jenë shumë më të përgjegjshme dhe më serioze në punën e tyre për të ndërmarrë të gjitha masat e duhura ligjore në mënyrë që të bëhet parandalimi i këtyre akteve të shëmtuara dhune që rrezikojnë edhe jetën e qytetarëve kur nuk gjenden fajtorët e kur nuk merr përgjegjësi askush.

Jemi mësuar tani më të shohim dënime qesharake që vijnë nga federatat sportive ndaj klubeve, udhëheqësve të tyre apo lojtarëve dhe si për ironi as ato dënime nuk zbatohet, arsyet mund të jenë nga më të ndryshmet.

Të gjithë në njërën anë flasin dhe tregojnë gatishmëri të madhe deklarative për padrejtësinë që po na bëhet si vend e që kemi shumë të drejtë, që kemi mbetur të izoluar nga sporti ndërkombëtar, në anën tjetër nuk merren veprime të duhura parandaluese ndaj akteve që na bëjnë të turpërohem edhe vetë nga kjo që na ndodhë e lere më se çfarë mesazhi dërgojmë në familje tona tek të rinjtë dhe fëmijët që e duan sportin e mos të flasin për imazhin në arenën ndërkombëtare sportive.

Të gjithë ata që janë përgjegjës duhet të mendojnë mirë, nëse nuk ndërmerren hapa të mirëfilltë nuk do të ketë zhvillim të sportit, as perspektivë dhe as konkurrencë nuk mund të ketë.

Duhet një herë e përgjithmonë që në logjikën tonë të dominojë shpirti sportiv garues që e bën të bukur dhe të pazëvendësueshëm sportin për gjithë spektaklin dhe emocionet që na ofron, e kurrësi nuk duhet lejuar që në emër të organizimeve sportive të dominojnë qëllime tjera. Është koha e fundit që të gjithë përgjegjësit të marrin masa të duhura për të parandaluar këto që po ndodhin, ose në të kundërtën institucionet duhet të ndërmarrin veprime të duhura ndaj të gjitha këtyre federatave dhe përgjegjësve për situatën e krijuar dhe për të shikuar: a ka monopol, burokraci, nepotizëm e anarki? Të eliminohen këto dukuri dhe të ketë organizim të mirëfilltë të sportit në Republikën e Kosovës.

Me këto hapa të nevojshëm do të lehtësonim edhe punën tonë dhe të gjithë miqve tanë të cilët po angazhohen për ndërkombëtarizimin e sportit në vendin tonë. Është shumë për të ardhur keq, por skena të tilla dhune nëpër stadione sportive nuk gjenden askund në kontinentin evropian, përveç në Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë, fatkeqësisht. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Hashim Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: Në emër të Grupit.

I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Po bëhen gati 10 vjet prej kur ka nisur procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe ende nuk dihet se kur do t'i vijë fundi i këtij privatizimit. Kjo ndodh për arsye të shumta, madje edhe për faktin se nuk ka një listë të saktë të numrit të ndërmarrjeve që duhet t'i privatizohen. Së paku atë asnjëherë nuk e ka prezantuar as AKM-ja e atëherëshme e as sot AKP-ja e tanishme.

E kuptoj se mund të ndodhur për shkak të dokumentacionit jo të rregullt, mungesës së tij, kundërshtimit që mund të dalin si është rasti i Gjakovës e çështje të tjera.

Mirëpo këtë proces i cili është zhvilluar me shumë dyshime dhe plotë kundërshtime po e ngulfat mos puna e Dhomës së Veçantë pranë Gjykatës Supreme.

Madje, sipas deklaratave të zyrtarëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit ajo për 3 vjet nuk ka përfunduar asnjë lëndë. Vërtetë kjo është brengosëse, madje ka edhe dyshime se ajo edhe më tutje i nënshtrohet urdhrave të UNMIK-ut dhe me këtë, realisht po e saboton përfundimin sa më të shpejtë të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, përkatësisht deblokimit të parasë së krijuar përmes këtij procesi.

Ndërkaq dëmet nga kjo mos punë e Odës së Veçantë janë të shumëfishta, pësojnë popullata dhe ekonomia jonë. Për shkak të kësaj neglizhence ka ngecur procesi i

likuidimit të ndërmarrjeve të mbetura shoqërore. Për pasojë nuk janë trajtuar kërkesa ndaj precedentëve në pronë apo ato të natyrës komerciale.

Për tri vjet Oda e Veçantë nuk ka miratuar asnjë listë përfundimtare të punëtorëve që përfitojnë nga procesi i privatizimit, ndërkaq atyre u takojnë mbi 100 milionë euro të cilët janë pak në krahasim me kontributet që i kanë dhënë ata për ngritjen e këtyre ndërmarrjeve, po në këtë kohë skamje, ato nuk janë për t'i nënçmuar.

Falë një kompromisi apo një zgjedhje që ka bazë të paqëndrueshme ligjore, AKP-ja ka gjetur një zgjidhje të përkohshme dhe në këtë mënyrë në formë të pagesës së përkohshme ka shpërndarë rreth 50 milionë euro, por ajo nuk mund të lëvizë shpejtë përderisa ngec Oda e Veçantë.

Për shkak të mos punës së Dhomës së Veçantë, përkatësisht të mos likuidimit të ndërmarrjeve të mbetura shoqërore, probleme kanë edhe pronarët e ri të ndërmarrjeve të privatizuar. Ka raste ku në adresë të këtyre ndërmarrjeve vijnë kërkesa për pagesa të ndryshme, ndaj të cilave pronari i ri nuk ka asnjë obligim, por kjo ndërlikon punën, meqenëse mos pagesat për obligimet e ndërmarrjes së vjetër mund të jenë problem për marrëdhëniet komerciale që zhvillon ndërmarrja e privatizuar.

Ne kemi miratuar ligjin për AK-n, ashtu edhe për Dhomën e Veçantë, po ashtu buxheti i Kosovës llogarit se do të përfitojë nga procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, përkatësisht se do t'i tërheqë paratë e mbetura pas përmbushjes së të gjitha detyrimeve dhe përfundimit të procesit të likuidimit. Mirëpo, me punën që po bënë Dhoma e Veçantë nuk duhet të kemi shpresa të mëdha për këto përfitime, ajo duket se qëllimisht nuk po merret me likuidimet, ndërsa përfundimi i tij njëkohësisht shënon edhe përfundimin e procesit të privatizimit.

Në këtë situatë nuk janë papërgjegjësi as institucionet e pushtetit në Republikën e Kosovës, më saktësisht ky Kuvend dhe Qeveria, ligji e obligon Dhomën e Veçantë që të jetë ekspeditiv në përmbushjen e mandatit që e ka, kurse kjo duhet të bëhet edhe në koordinim me subjekte ndërkombëtare, përkatësisht me EULEX-in, mirëpo procesi nuk guxon të ngecë për çështje banale, si është emërimi i gjyqtarëve.

Qeveria e Kosovës me kohë duhet ta krijojë pjesën e vet të përgjegjësisë që e ka, që emërimi i gjyqtarëve mos të ngecë për arsye banale si është mungesa e buxhetit për përkthyesit, apo zvarritja të ndodhë edhe për shkak se së pari duhet të emërohet një këshilltar që do t'i caktojë rregullat e procedurat për emërimin e gjyqtarëve.

Kuvendi i Kosovës nuk duhet të hezitojë dhe që të kërkojë raport pune që është bërë për arsye të ngecjes kaq të madhe. Kërkesat e këtilla, në asnjë mënyrë nuk cenojnë pavarësinë e gjyqësorit, por është një përpjekje e domosdoshme për zbatimin e ligjit drejt përmbushjes së një të drejte reale të punëtorëve, pronarëve të komuniteteve dhe biznesit apo edhe të buxhetit të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit të “Vetëvendosjes”, deputeti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,

Çështja që do të ngrehë unë prapë lidhet me atë çka u tha dje, por intriguese është një pjesë e deklarimit të kryeministrit që po më bën të flas sot në lidhje me një çështje.

Pra po flasim për atë pjesën e fjalimit të tij ku thotë se iu drejtua gishti një komuniteti. Kjo gjë më intrigoj mjaftë për këtë deklarim, pasi që konsideroj që kjo pjesë është jashtëzakonisht me shumë rreze dhe është e domosdoshme për trajtim e sidomos kur kemi të bëjmë me një të pavërtetë se mua nuk më rastisi të dëgjoj që dikush të fajësojë dike në baza etnike apo të komunitetit, si thotë kryeministri.

Tani dua të flas se kujt ia drejtojmë ne gishtin si lëvizje “Vetëvendosje” dhe kjo është saktësisht e kundërta e asaj që bën Qeveria.

Kur flasim për strukturat në veri, ne themi: “strukturat e Serbisë”, i emërtojmë ato armiqësore, si ilegale, ndërsa kur bëhet fjalë për incidente, Qeveria këto struktura i quan kriminale, ekstremiste dhe çdoherë jep mundësinë që krimi të konsiderohet që është bërë nga dikush i panjohur dhe me motiv të panjohur dhe fajtori me këtë çdo herë të lihet anonim.

Edhe për krimin e fundit që nga akti terrorist keni filluar ta quani si sulm kriminal. Thoni se po punohet në hetim dhe deri atëherë nuk mund të drejtojmë gishtin nga askush.

Institucionet e Republikës së Kosovës nuk e kanë kontrollin në veri, kontrollin atje e kanë strukturat e Serbisë, ato ndalojnë dhe legjitimojnë, madje edhe EULEX-in edhe KFOR-in dhe ju nuk mund të jeni atje, as që mund të thoni se po bëjmë hetim dhe pas hetimit do të mund të dalim me deklaratë, sepse që të bëni hetim, ju duhet ta keni situatën në kontroll, duhet të keni mundësi lëvizje që të bëni hetim, përndryshe ai hetim nuk është hetim.

Akti terrorist po ndodh dhe ju nuk po mund të shkoni atje për shkak të strukturave të Serbisë dhe deklaroni se pa ndodhur hetimi nuk mund të bëjmë me gisht. Pra, shumë thjesht gishti duhet t’u drejtohet strukturave të organizuara armiqësore të Serbisë në veri, janë atje, e mbajnë rendin, nuk lejojnë institucionet e Republikës së Kosovës, e ndalojnë edhe EULEX-in edhe KFOR-in, pra shumë thjesht janë përgjegjëse dhe në këtë rast ju jepni deklaratë neutrale. Për derisa deklaroni kështu ju po doni bashkëjetesën me ato struktura. Po përse po ndodhë kjo?

Mos të harrojmë që ndarja në baza etnike historikisht ka buruar nga Serbia. Është shteti serb dhe apetitet e tij për territore shqiptare që e mbollën urrejtjen etnike ndaj shqiptarëve. Ky shtet vazhdon të jetë i tillë edhe sot. Natyrisht, ndaj këtij shteti ka pasur çdoherë reagime edhe nga vetë serbët, madje edhe të organizuar. Edhe sot ju mund t’i gjeni deklaratimet e socialdemokratëve serbë të kohës së tyre, të kohës kur u pushtua Kosova, madje edhe komunikatat e organizatave të tyre, si dhe shkrimet e Tucoviqit e Zogoviqit e të tjerë.

Ndarja nuk është te komunitetet etnike ashtu siç e tha kryeministri dje, sepse ka serbë në këtë anë të politikës, e ka po ashtu edhe shqiptarë në atë anë të politikës. Problemi nuk

është shqiptaro- serbë, por problemi është midis shqiptarëve si komb dhe Serbisë si shtet. Dhe ju me këtë shtet po mbani marrëdhënie të mira, atë e dëshmojnë takimet, negociatat dhe deklaratimet e tua. Ju e quani atë si shtet verior, si fqinj verior, edhe deklarimi juaj mund të shkojë deri në pikën kur bie fjala për fajësim të shtetit serb, të fajësohet vetëm krahu ekstremist dhe jo i tërë shteti edhe kjo është më e rrezikshmja. Ju po e amnistoni shtetin e Serbisë për shkak të Tadiqit dhe me këtë rast jeni edhe indiferent përballë strukturave të Serbisë në Kosovë e madje edhe përballë terrorizmit. Dhe, kjo gjë prodhon ndarjen në baza etnike këtu në Kosovë. Politikanët janë afër dhe gjithnjë e më afër, ndërsa qytetarët larg e gjithnjë e më larg njëri- tjetrit.

Ju në vend të reciprocitetit institucional: politik, ekonomik e tregtar, ju krijoni hapësirën për reciprocitet e incidente dhe duke lënë që ajo hapësirë ta bëjnë vetë për reciprocitet, pra në incidente dhe këtë reciprocitet ta bëjnë vetë qytetarët.

Mungesa e veprimit reciprok të shtetit e lë hapësirën për incidente reciproke ndëretnike dhe kjo prodhon ndarje, jo integritet.

Kjo politikë mbjell urrejtjen ndëretnike në terren dhe krijon hapësirën për veprime të dhunshme reciproke dhe kjo është një lojë jashtëzakonisht e rrezikshme.

E tërë politika e Qeverisë së Kosovës është politikë e ndarjes në baza etnike. Integriteti i serbëve pasi të jenë ndarë në baza etnike një herë nëpër komuna, në fakt është ndarje dhe thellim i urrejtjes mes qytetarëve.

Decentralizimi e territorializoi ndarjen, i ashtuquajturin natyrisht decentralizim dhe kjo pashmangshëm po sjell dhe do të sjellë incidente mes qytetarëve.

Madje edhe trajtimi dhe instrumentalizimi nationalist i trashëgimisë kulturore nuk bën gjë tjetër përpos thellon ndarjen në baza etnike...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Hajde edhe 20 sekonda.

LIBURN ALIU: Jo, jo nuk e kemi kaluar. Dhe, tërë këto ndarje po thellohen paralelisht në kohë kur ju takoheni me Beogradin.

Lëvizja “Vetëvendosje” asnjëherë nuk drejton gishtin kundër asnjë komuniteti apo populli, ne e dimë ku e drejtojmë gishtin, ai është shteti i Serbisë, politika e të cilit po i sjell vetëm dëme qytetarëve të Kosovës.

KRYETARI: Deputetja, Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuara kolege deputete dhe ju kolegë deputetë,

Zhvillimet e fundit në vendin tonë janë një pasqyrë e qartë e pozicionit politik të Serbisë. Kjo pasqyrë tregoi qartë se Serbia s'e ka bërë as lëvizjen më të vogël drejt përmirësimit të politikës së saj në rajon dhe as që ka ndërmend një gjë të tillë.

Me këtë Serbia dërgoi një sinjal të fortë për Bashkimin Evropian dhe bashkësinë ndërkombëtare në përgjithësi.

Derisa Serbia me politikën e saj destabilizuese për gjithë rajonin tashmë gati një vit po i mban të barikaduara rrugët e veriut të Kosovës dhe po e degradon dhe shndërron bashkësinë ndërkombëtare në një aktor që bën sehir karshi situatës, kjo e fundit të vetmen mundësi veprimi politik e sheh në presionin ndaj institucioneve dhe qytetarëve të Kosovës. Është e pranueshme dhe shumë racionale thirrja për gjakftohtësi e për tolerancë, por kjo nuk duhet banalizuar tej mase, gjë që ka filluar të ndodhë në Kosovë.

Situata aktuale është bërë një top i cili shkelmohet sa te KFOR-i sa tek EULEK-si dhe sa tek institucionet vendore. Nëse të gjithë këta faktorë kanë kompetenca për zgjidhjen e situatës, atëherë përgjegjësia duhet të kërkohet po ashtu tek të gjithë. Nëse njëri nga këta faktorë ka primatin për zgjidhjen e çështjes, atëherë edhe përgjegjësia duhet të kërkohet në atë adresë, sepse paraliza e përgjegjësive ka bërë që debati politik, ditët që lamë pas të shndërrohet në një debat aksionist dhe pa kurrfarë substance.

Të nderuar,

Ne të gjithë ishim dëshmitarë që debatet politike që u bënë gjatë gjithë kësaj jave që e lamë pas, ishin jo në favor të një zgjidhje sa më efikase të problemit në veri, por u bënë më tepër për grumbullimin e poenëve politikë dhe akuza në adresë të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Në këtë lloj aksionizmi hyn për mendimin tim edhe veprimi i anëtarëve të lëvizjes "Vetëvendosje" të cilët duke u fshehur prapa dy emrave të cilët janë dhimbje për ne të gjithë pa dallim, për qëllim nuk kishte asgjë tjetër veç bllokimin e punës së Kuvendit dhe miratimit të Ligjit për bankat dhe institucionet mikro-financiare. Ndryshe si do të shpjegohet largimi i tyre prej sallës së Kuvendit sapo u përmend kuorumi për vazhdimin e seancës.

Mendoj që është jashtë çdo etike njerëzore të keqpërdoret tragjedia e dikujt për popullaritet personal dhe fundi i fundit mua personalisht dhe besoj që edhe shumë deputetëve tjerë të këtij Kuvendi, as që na është afruar për të nënshkruar kërkesën për seancë të jashtëzakonshme që e ka thirrur "Vetëvendosja" dhe vetë fakti që dje u lëshua në mënyrë të organizuar seanca kur ne diskutonim për sigurinë e vendit, nuk don koment.

Zonja dhe zotërinj,

Po mbushen 13 vjet nga përfundimi i luftës dhe qytetarët shqiptarë në veri ende maltretohen dhe rrezikojnë jetët e tyre. Ata ende vazhdojnë të jetojnë jetën prej refugjati në shtetin dhe pronën e tyre, përderisa gjithë institucionet e vendit dhe ato ndërkombëtare po e bëjnë të pamundurën që pakicat e Kosovës, të gëzojnë të drejtat si askund tjetër në

botë, kjo për mendimin tim është një politikë e dyfishtë e cila jo që qon drejt një zgjidhje të pranueshme, por është jo produktive, të dëmshme dhe të rrezikshme....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe 20 sekonda!

GANIMETE MUSLIU: Falemnderit!

Njëherë e përgjithmonë duhet të bëhet e ditur se qytetarët e Kosovës kanë dëshmuar gatishmërinë e tyre me kompromiset që i përmban pakoja e Ahtisarit. Deklaratat e shumta politike për shkëmbim territoresh, statutet speciale, autonomi e lloj-lloj tjera definicione, që vijnë nga opozita, nuk janë asgjë tjetër veçse dëshmi e qorrsokakut politik serb. Qeveria e Kosovës duhet të vazhdoj...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem, predsedniče!

Uvaženi ministri,

Poštovani poslanici,

Postoji problem o Bošnjačkoj zajednici na teritorije opštine Prizren, odnosno region Župe, gde se unazad godinu dana vrši proces privatizacije bivših „Lirijinih“ parcela ili objekata od strane Agencije za privatizaciju. Koristim priliku da za ovom govornicom u Parlamentu Kosova, iznesem veliku zabrinutost jer se radi o strateški bitnim mestima koja su planirana za izgradnju infrastrukturnih objekata za planiranu buduću našu opštinu, pa bih apelovala na direktora Agencije za privatizaciju da se taj proces privremeno zaustavi ili stagnira na određeni vremenski period.

Takođe, želim istaći veliki problem koji se pojavio u selo Nebregšte, Skupština opštine Prizren, oko privatizacije „Lirijinog“ objekata, površine 50 metara kvadratna a Direktorijat za Kulturu, Omladinu i Sport, pri opštini Prizren, je planirao da 2012. godine, izgradi kulturno-sportsku salu koju omladina tog sela čekaju još od 1985. godine. Rukovodstvo sela, se u više navrata obraćala relevantnim opštinskim faktorima za suzbijanje prodaje ove parcele kao i Javnom pravobraniocu, ali nikakav pravni odgovor od Agencije za Privatizaciju do sada nije dobijen.

Poštovani, u ime bošnjačke zajednice, molim sve institucije naše države da ozbiljno stave ovu našu problematiku i pozitivno reše u interesu naših građana, mesnih zajednica pri skupštini opštini Prizren. Zahvaljujem, predsedniče!

KRYETARI: Ju falemnderit! Fjalën e ka deputeti Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Falemnderit!

I nderuar kryetar,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë dhe kolege,

Dje, padyshim që gjatë seancës në të cilën u debatua për veriun, shumë nga ne, në mesin e tyre edhe unë përmendëm se si bandat kriminale serbe, grupet e organizuara kriminale po i terrorizojnë shqiptarët në veri të Mitrovicës, për qëllime tashmë të njohura të tyre, qoftë për pastrim etnik apo për dëbim të shqiptarëve, ndërsa atë çka dua të them sot është se me keqardhje në Kosovë, prej pas luftës nuk kemi të bëjmë vetëm me banda kriminale serbe, por kemi të bëjmë edhe me grupe apo banda kriminale të organizuara shqiptare. Që 13 vjet pas luftës po i terrorizojnë qytetarët e Kosovës, e në veçanti fjalën e kam për rastin e fundit që është duke ndodhur në qytetin e Pejës, ku si pasojë e këtyre krimeve të organizuara, konkretisht dje ka vdekur, ndërsa sot varroset qytetari i Pejës, Sali Kastrati, i cili është edhe një viktimë e radhës së këtyre bandave që 13 vjet pas luftës që Pejën e kanë shndërruar në një vatër të krimit, të terrorizimit të qytetarëve të asaj ane që pa fije turpi dhe fije ndalese i terrorizojnë shqiptarët.

Duhet cekur që 13 vjet pas lufte, vrasja në Pejë, vrasjet e shumta të qytetarëve të Pejës, duke përfshirë që nga pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, figurat e ndryshme politike të qytetarëve të Pejës, më pastaj intelektualë, juristë, bizismenë dhe afaristë të ndryshëm, kanë qenë pre e këtyre bandave kriminale serbe çka deri tash ende nuk është marrë kurrë kundër këtyre. Veçori tjetër apo dukuri tjetër që është zhvilluar në qytetin e Pejës që këto 13 vjet pas luftës, është dukuria e haraçit apo e reketit që njihet në popull, ku shumë biznese të Pejës, janë pre e këtyre grabitësve dhe bandave kriminale.

Gjithashtu edhe rrëmbimet e shumta, pastaj rrjeti i zhvilluar i drogës, kanë gjetur pre në qytetin e Pejës dhe në Kosovë në përgjithësi. Vite më parë është djegur Dhoma e Hetimeve kur Stacioni i Policisë, konkretisht Njësi i Hetimeve ka qenë i stacionuar në ndërtesën e ish-Shtëpisë të Kulturës, çka janë pamundësuar shumë hetime të këtyre rasteve, ndërsa me plot përgjegjësi mund të them se gati, jo gati të gjitha, por shumica e këtyre rasteve ende nuk janë zbardhur, vrasjet të cilat kanë ndodhur në qytetin e Pejës për këto 13 vjet pas luftës.

Unë mendoj se qytetarët e Pejës edhe qytetarët e Kosovës, në përgjithësi askujt nuk i kanë borxh që për këto 13 vjet të jenë pre e vrasjeve të tyre, pre e rrëmbimeve të tyre, pre e reketit apo e haraçit dhe krimeve të tjera. I ndjeri i cili sot varroset, është vrarë në pragun e shtëpisë së tij, vetëm e vetëm duke mos bërë kompromise me bandat e tilla duke mos u dhënë reket atyre që kanë kërkuar nga pasuria e tij, ndërsa ne sot vazhdojmë të jemi pre ende e këtyre grabitësve.

Peja është duke shkuar në një rrugë, në një qytet i cili vetëm tash ka marrë përmasa të mëdha qoftë në Meksikë, siç Meksiko Siti apo edhe Sicilia çka vetë kam pasur rastin ta vizitoj, kur krimi dhe mafia e kontrollojnë jetën e qytetarëve, nuk e kontrollon policia...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Në emër të Grupit, po është dashur të më lajmërosh në fillim. Edhe dy minuta.

GËZIM KELMENDI: Falemnderit!

Më vëmendje dhe dëgjova raportin e ministrit të Punëve të Brendshme, doktor Bajram Rexhepi, i cili paraqiti para neve masat e ndërmarra për kalimin e situatës së tensionuar në veri dhe përmendi se në mesin e këtyre masave është dërgimi i një togu special i Njësisë Speciale në atë anë. Unë propozoj dhe kërkoj nga ministri që një gjë të tillë ta ndërmarrë edhe në rajonin e Pejës. Përveç njësive speciale, të dërgojë edhe forca speciale, qoftë nga ana e hetuesisë, të merren me hetimin e këtyre krimeve dhe ndalimin e këtyre krimeve që 13 vjet e kanë pllakosur Pejën. Falemnderit!

KRYETARI: Në emër të vet, fjalën e ka deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Falemnderit, kryetar!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Po e shfrytëzoj këtë hapësirë që ta jap një propozim ose të përsëris një propozim që e kemi dhënë edhe më herët, për nevojën e rishkrimit të strategjisë nacionale të sigurisë dhe kjo nevojë nuk lidhet domosdoshmërisht me zhvillimet e fundit, por lidhet me nevojën edhe me domosdoshmërinë që institucionet e Kosovës të kenë përgatitje të duhur edhe në dokumente për atë se në cilën fazë është Kosova, cilat janë kërcënimet dhe cilat janë sfidat e brendshme dhe të jashtme të Kosovës, cilat janë interesat nacionale, cilat janë pikat vitale nacionale, cilat janë mundësitë e kontrollit dhe cilat janë mundësitë e zhvillimit të pikave të vendeve dhe objekteve vitale për Kosovën dhe normalisht se cilat janë mundësitë e ndërtimit të kapaciteteve për të zhvilluar këto interesa vitale për shtetin e Kosovës?

Fatkeqësisht, prej vitit 2010 kur është shkruar ajo që quhet: “Strategji e sigurisë së Kosovës”, e kemi vlerësuar dhe po e vlerësoj sërish se ka qenë vetëm një analizë shterpë për gjendjen në Kosovë, por assesi nuk ka arritur që t’i vendosë parimet bazë në politikat e sigurisë. Ta themi qartë se Kosova sot nuk ka politika të sigurisë dhe si pasojë e kësaj nuk ka arritur asnjëherë që të zhvillojë edhe kapacitetet për të mbrojtur dhe zhvilluar dhe implementuar politikat e sigurisë së shtetit.

I bëj thirrje Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Ministrisë të Punëve të Brendshme, Zyrës së Kryeministrit, sikurse edhe Kuvendit të Kosovës, që sa më shpejt të fillojë rishkrimin total që kësaj që quhet: “Strategji e sigurisë së Kosovës”, sepse kjo që ekziston tash prej vitit 2010, nuk është strategji e sigurisë, është vetëm një analizë politike e shterpë dhe pa ndonjë analizë të qartë të veprimeve dhe mundësive që i ka Kosova. Kjo, jam i bindur që i mundëson hapjen e fazës tjetër që është rishikimi funksional i sektorit të sigurisë në Kosovë dhe kjo duhet të bëhet sa më shpejt.

I nderuar, zoti kryetar,

Ftoj edhe Kuvendin e Kosovës edhe institucionet që i përmenda që sa më shpejtë të fillojë kjo dhe jemi të gatshëm që të japim angazhimin tonë edhe si deputetë të Kuvendit të Kosovës. Falemnderit!

KRYETARI: Si shkurt, se koha është në harxhim, e ka fjalën deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Falemnderit, zoti kryetar, shumë shkurt.

Janë dy çështje të cilat dua t'i ngre sot për kujtesë të Kuvendit të Kosovës. E para ka të bëjmë me zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit, të Komisionit të Pavarur për Media. Siç e dini, ka më shumë se sa dy vjet që ky komision ka mbetur i pezulluar faktikisht. Shumicës së anëtarëve iu ka mbaruar mandati dhe duke qenë se edhe ligji është miratuar në Kuvend, në qoftë se është pritur ai ligj, mendoj se është koha që të plotësohet numri i anëtarëve të këtij Këshilli.

Çështja e dytë, ka të bëjë me shtrirjen e sinjalit të RTK-së. Ka shumë fshatra këtu në Kosovë dhe shumë zona që më kanë kontaktuar dhe personalisht dhe ankohen që nuk kanë fare sinjal të RTK-së, dhe duke qenë se edhe ligji është miratuar, mendoj se është momenti i fundit që këtyre banorëve t'ju ofrohet sinjali për të parë Televizionin Publik. Faktikisht, ata janë në terr informativ, madje as televizionet e tjera nuk shohin, vetëm informohen nga televizionet e vendeve fqinje. Nuk besoj se është e drejtë dhe besoj se Radiotelevizioni i Kosovës duhet ta përmbushë misionin e tij edhe për sa i përket shtrirjes territoriale. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit!

Edhe me këtë kemi përfunduar për deputetët, rendin e ditës- Deklarime jashtë rendit të ditës. Është mirë që vërtetë ne si Parlament, si Kuvend, si organ më i lartë legjislativ, të kërkojmë nga Policia, nga Prokuroria dhe nga sistemi i drejtësisë, në përgjithësi, të merren me lëndën, zbardhjen dhe zbulimin e veprave kriminale dhe mos të na bëhet kjo pikë, t'i ngritim këto çështje sa herë të vijnë. Ne nuk mund të marrim rolin e institucioneve që janë përgjegjëse për t'i kryer detyrat dhe përgjegjësitë e tyre mbi bazën e ligjeve. Këtë pikë e konsideroj të mbyllur.

Por, por një fjalë, deklaratë gjithashtu, jashtë rendit të ditës, e ka kërkuar fjalën edhe kryeministri.

Zoti Thaçi e ke fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni edhe një herë që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, t'ju drejtohem për zhvillimet e fundit që kanë ndodhur në Republikën e Kosovës, fillimisht t'ju drejtohem edhe qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Unë e kuptoj plotësisht dhe drejt shqetësimin e qytetarëve të Kosovës për situatën e tensionuar në veri të vendit, i kuptoj edhe ndjenjat dhe emocionet e të gjithë qytetarëve pa dallim etnie. Në të njëjtën kohë, përpiqem dhe i kuptoj edhe reagimet emocionale të ndonjë deputeti të nderuar, mirëpo në të njëjtën kohë nuk mund t'i kuptoj dhe arsyetoj

dhe nuk pajtohem dot, përsëri i ritheksoj, me thirrjet e shkëputura të ndonjë deputeti për përdorimin e forcës.

Secili prej jush do të mund të kishte idenë se çka mund të ndodhte në rasat se do të autorizonim përdorimin e forcës në veri të vendit, ashtu siç kërkohet nga disa deputetë me deklaratat elektorale. Sigurisht që e dini mirë, mirëpo ndoshta për këta deputetë është edhe e parëndësishme.

Dëshiroj të ritheksoj edhe një herë se integriteti territorial i Republikës së Kosovës, është i pacenueshëm, është i njohur dhe i pranuar ndërkombëtarisht, Kosova është një dhe e pa ndarë. Ju për disa ditë me radhë kërkuat kryeministrin në Kuvend, disa prej juve dhe ju falënderoj për këtë respekt. Në të njëjtën kohë, disa theksuan edhe atë se s' ka kuptim debati për situatën e sigurisë, pa prezencën e kryeministrit në Kuvend. Gjithashtu, faleminderit për respektin, por, ishte tejte zhgënjyese kur ju e kërkonit kryeministrin të jetë në Kuvend dhe kryeministri vjen në Kuvend për debat, për ballafaqim dhe menjëherë largoheni në mënyrë demonstrative, bojkotuese, në mungesë të argumenteve dhe ballafaqimeve. Kjo, të kthen në situatën se të gjitha ato deklarime bombastike elektorale për gjendjen në veri, kanë qenë të motivuara politikisht, me motive elektorale dhe me mesazhe të tensionimit të situatës dhe të rolit psikologjik të qytetarët e vendit.

Pra, interesi juaj, i disave prej juve, nuk ishte, ata deputetë që kanë folë, nuk ishte gjendja e sigurisë por si të krijojnë një tension të ri dhe në të njëjtën kohë si të zhvillojnë një kampanjë elektorale, që gjithashtu nuk do të mund të shndërrohet në votë.

Në të njëjtën kohë kërkonin edhe kthimin tim nga Amerika edhe ata që nuk mund të hyjnë fare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Dhe, pse nuk mund të hyjnë? Ata e dinë vetë!

E lëre se kërkuan nga unë që të kthehem urgjentisht, por kur u ktheva, ata u larguan dhe ikën nga Parlamenti, se s'kishin asnjë argument. Por, madje shkuan edhe aq larg sa pretenduan t'i japin udhëzime e këshilla Shteteve të Bashkuara, NATO-s dhe Bashkimit Evropian se çka duhet bërë në Kosovë.

Prandaj, e theksoj edhe një herë se dhuna ka qenë e papranueshme dhe e dënueshme nga të gjithë.

U deklarua edhe në adresë të Qeverisë përgjegjësia për kidnapimin e dy policëve të Kosovës në Mërdare.

Kanë qenë deklarime jo fer, të papërgjegjshme, të paarsyeshme dhe ato deklarime, e dini edhe ju, se nuk qëndrojnë.

E para. Të dy policët janë kidnapuar në territorin e Kosovës. Secili polic dhe pjesëtar i sigurisë dhe mbrojtjes së Kosovës e ka obligim të respektojë Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. E kam theksuar edhe dje dhe për rikujtuesen tuaj, do të shpalos edhe sot

qëndrimin tim se xhandarmëria serbe ka qenë e veshur me uniformën serbe. Policia e Kosovës, gjithashtu, me uniformën e shtetit të Kosovës. Policët serbë kanë qenë të armatosur. Në të njëjtën kohë policët e Kosovës kanë qenë edhe më të armatosur dhe me armatim edhe më modern dhe këtë armatim e ka kryer, si përgjegjësi, Qeveria e Republikës së Kosovës, institucionet e Kosovës. Prandaj, çdo pjesëtar i sigurisë së Kosovës ka obligim, në moment që shkelet vetëm një centimetër integriteti territorial i Kosovës nga çizmja e kujtdo qoftë, e në veçanti e atyre që kanë kryer gjenocid në Kosovë, natyrisht se kanë obligim të respektojnë Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.

Tash, ju po i fajësoni ata dy policë, unë nuk dëshiroj të hyj këtu tash. Fajësia në adresë të atyre dy policëve le të mbetet... E ju tash kaluat nga adresimi i përgjegjësisë në Qeveri, e tash te ata dy policë. Okej, le të mbetet edhe kjo në ndërgjegjen tuaj!

Në anën tjetër, pas aktit kriminal që ndodhi në veri të Mitrovicës, vrasjes së Selver Haradinajt, opinionin u bombardua me deklarime prej më të ndryshmeve prej atyre më të përgjegjshme për sjellje qytetare, pritje të përgjegjësisë shtetërore deri te deklarimet më ekstreme me motive të mllefeve ndëretnike, por dhe me akuza të rënda ndaj një komuniteti të caktuar.

Dëshiroj të potencoj se politika, kushdoqoftë ai qoftë të pozitës apo të opozitës, përderisa të flet, apo te flasin organet kompetente të hetuesisë dhe drejtësisë, nuk ka të drejtë të akuzojë askënd, as në baza politike, as etnike.

E kuptoj motivin e rritjes së tensioneve politike në Kosovë prej individëve të caktuar të opozitës, por është krejt e papërgjegjshme me pretendua, me e kriju një terror psikologjik, pa asnjë argument.

Vrasja e Selver Haradinajt, shprehi edhe sot ngushëllime familjes së tij, ka qenë akt kriminal dhe gjithë autoritetet shtetërore të Kosovës, EULEX-i dhe KFOR-i, janë duke punuar për zbardhjen e asaj vrasjeje.

Gjithë qytetarët e Kosovës dhe të rajonit, pa dallim, kanë përjetuar mjaft dhunë, krime, por dhe trauma. Dhe, përderisa ne të gjithë ftojmë autoritetet në Maqedoni që të mos drejtohet gishti kundër një komuniteti për vrasjen e 5 qytetarëve në Maqedoni, disa deputetë këtu e bëjnë gabimin e njëjtë, kur drejtojnë gishtin kundër një komuniteti për vrasjen e Selver Haradinajt, pa folur drejtësi. Ky është gabim i madh.

Prandaj, po theksoj edhe njëherë, do të jetë i kotë pretendimi për të fituar vota mbi aktet kriminale, të kujtdo qoftë, që i kryen në Republikën e Kosovës. Askush nuk do të mund të ndërtojë të ardhme politike mbi viktimat, kushdo që i kryen ato viktima. Prandaj, ne do të vazhdojmë dhe jemi të përcaktuar, që në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin ndërkombëtar, Bashkimin Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, EULEX-in dhe NATO-N, të krijojmë një situatë normale edhe në veri të vendit.

Por, pasi që kishit kërkuar me aq ngulm, unë isha dje, ju u larguat. Më vjen mirë që jeni rikthyer pas bojkotit, ju ftoj që të punojmë maksimalisht, bashkërisht, tash në agjendën

për përmbylljen e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës. Dhe, uroj që këtu, së paku, të punojmë bashkërisht, pasi që dokumentin e Ahtisarit e kemi pranuar të gjithë dhe të gjithë kemi obligime për ta implementuar këtë dokument, për të respektuar Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, ndërsa për çështje të tjera, gjithashtu, jemi këtu për çdo debat me juve, që për juve është me interes për shtetin dhe shoqërinë kosovare. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Po, edhe kjo, ishte jashtë rendit të ditës! Sabri Hamiti e ka kërkuar fjalën.

SABRI HAMITI: Zotni kryetar i Kuvendit,

Zotni kryeministër,

Nuk ka nevojë të përdoren figurat, sepse unë e kam thënë publikisht tri herë në mbledhje të Kryesisë edhe këtu dje, që për tema të tilla, që lypen përgjegjësi edhe të Qeverisë si ekzekutiv i vendit edhe të Kuvendit si përfaqësues, kurrë, dhe jo vetëm kësaj radhe, nuk është mirë të diskutohet pa qenë kryeministri këtu.

Dhe, mirë që je këtu! Pra, puna e gjestit politik, dalja ose mos dalja në një moment nga Kuvendi i partive politike, është problem i tyre.

Unë, megjithatë, dua ta shikoj pak edhe praktikisht këtë problem.

Jam njëri prej atyre që rri më së shumti në bankë. Dhe, dje 5 orë s'e kam lëshuar bankën.

Po, kërkuesit e mbledhjes së jashtëzakonshme, ka pas raste kur 3 vetë kanë qenë në sallë. Katër a tre?! Domethënë, s'i kanë rezistuar, tërë kohës. Po, edhe 10 edhe 3! Mirë!

Domethënë, durimi s'ka qenë permanent, keni kujdes! Dhe, është mirë të shihet, sepse edhe ju vetë nuk i qëndroni 5 orë pa lëvizë.

Kjo do të thotë që është mirë të studiohen problemet dhe të shihen ashtu si duken e si janë.

Në anën tjetër, unë kisha këtu, si pikë të dytë, ta përmend një çështje tjetër.

Është bërë zakon këtu, që referencë për çkadoqoftë, për diskutimet e brendshme, e referencë i bie pikë mbështetje e diskutimit të bëhet Serbia.

Është koha që të hiqet dorë nga ky tip i referencës, sepse deshtëm a nuk deshtëm, po hyjmë në klisenë që është që 100 vjet, nuk është që dje, që Serbia kur t'i teket i prodhon armiqte ose patriotët brenda shqiptarëve, pa e ditë këta mbrenda qysh po i prodhohen. Sepse, një masë e manipulueshme, e lehtë, në këtë kuptim, mjafton ai me i thënë që ky është i mirë dhe ti përnjëherë e shpall të keq.

Ky tip dialogu, ky tip raporti, për fat të keq, është prodhuar edhe në bankat e këtij Kuvendi dhe ka pas reflektime edhe dje, edhe sot bile.

Unë mendoj, që ka kaq njerëz të dijshtëm dhe të vetëdijshtëm këtu, që kanë referenca të brendshme, të vlefshme sa të doni, për vetëvlerësim dhe vetënjohje, ose në historinë e vet, ose në historinë e Ballkanit dhe të Botës, që shkon përtej një fqiu, për të mos prodhuar vlerësime ose pika reference. Këtë, po ndiej nevojë personalisht ta them.

Dhe e treta. Edhe këtu te ne, edhe këto ditë, edhe dje, edhe më vonë janë klishetë e përgjithshme, çka është perëndimore e tash po i thuhet evropiane, po e njëjta gjë është, kur jemi na evropianë e s'jemi.

Problemi i shqiptarëve evropian, në mes lindjes e perëndimit, tradicionalisht është çështje që është shtruar moti. Është prurë fuqishëm, që kur është ndërtu shteti shqiptar, e sidomos në vitet e 30-ta.

Dhe, një Krist Maloku, një mendimtar i madh, i Prizrenit ka qenë ky, ka jetue në Austri. E ka shkruar një tekst, unë mendoj antologjik, për këtë problem: “Oriental apo Okcidental”. Dhe, a di çka thotë Maloku, në 36-shin? Thotë është gabim, që mendohet në gjendje gjeografike, kush është në perëndim i vendosur në Tokë, është perëndimor, kush është në lindje është lindor. Jo! Është gjendje vetëdije! Perëndimor është ai që është transparent, flet saktë edhe e kryen detyrën me përgjegjësi. Lindor është ai që megjullon, që merr detyra - nuk i kryen ose së paku flet katërfish, tri-katër farnash.

Dhe, përfundon me një shembull shumë konkret, për ta bo ma të qartë. Thotë Maloku: “Ma i rëndësishëm për mua është dhe më perëndimor një roje e kufirit të Shqipërisë, i cili punën e kryen me afat dhe si duhet, se sa diplomatët perëndimorë, që enden rrugëve të Tiranës.”. Unë këtu po e përfundoj! Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Liburn Aliu e ka kërkuar fjalën! Replikë, a?

LIBURN ALIU: Do të replikoj edhe një herë tek çështja e akuzës ndaj komunitetit.

Unë po mund ta kuptoj, që kryeministri po dëshiron që dikush këtu me e akuzua komunitetin. Po ka dëshirën që dikush me e akuzua komunitetin e mos me u folë për strukturat e Serbisë në veri.

Pra, këtu kemi të bëjmë me strukturat e Serbisë, jo me komunitetin. Ti mund të kesh dëshirën që të akuzojë dikush komunitetin dhe pastaj të themi: Jo, kjo qenka ndarje etnike! Jo, jo! Kemi të bëjmë me shtetin, konkretisht - strukturat e Serbisë.

Për sa i përket ngritjes së tensioneve e krejt. Ju ishit e pari që e quajttë akt terrorist, sulmin në veri. Tani jeni tërheq nga ky deklaram dhe po i thoni “një sulm kriminal”, ndërsa reagimin e opozitës po e quani – terror.

Për sa i përket policëve, ju po deklaroni se i keni armatosë dhe po mendoni se e keni kryer punën me vetë faktin që i keni armatosë ata mirë. Po, ju po harroni se - ju i keni çarmatosë policët moralisht përmes negociatave të vazhdueshme me Serbinë dhe duke e quajt Serbinë si fqinj verior.

Pra, kur ta quajsh Serbinë fqinji im verior i dashur dhe Borislav Stefanoviçin e quan Borko, edhe polici pavarësisht armës, është i çarmatosur moralisht dhe normalisht përfundon ashtu si përfundoi.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Edhe një është! Ardian Gjini e ka fjalën! Për dy minuta, më shumë s'bën!

ARDIAN GJINI: Falemnderit, kryetar!

Një gjysmë minute, nuk ka nevojë hiç më tepër!

Po më duket që po i hupim, dje e përmenda amnezinë dhe po më duket që këta të Qeverisë prej kryeministrit e poshtë, po harrojnë çka po flasin, po harrojnë çka po bëjnë edhe atëherë po ju duket, po iu bëhet, ne themi ne "hija hijallë", që krejt tjerët janë armiqë.

Zëvendësi i tij, ka thirr për me i dërgu trupat në veri. Jo deputetët e opozitës. Ai vetë ka thirr edhe atij duhet me i thanë "Çka je kah bon, a je në vete, a je në tokë të bukës?".

Çështja tjetër, është se po më duket që i paska djeg fort dje që jemi dal, se iu ka folë karrigeve, dhe e mori fjalën edhe një herë sot me na kallëzua çka po bahet e çka s'po bahet në Kosovë.

Po më duket, që po e humbim edhe sistemin e sjelljes si Qeveri, po e humbim edhe sjelljen e sjelljes si Kuvend. Po më duket, që po degradon dhe nuk ka mbet asnjëfarë kënaqësie me mbet edhe me e ngu kah të flet. Bën vaki edhe në të ardhmen nuk rri me e ngu. Falemnderit!

KRYETARI: Berat Buzhala e ka fjalën!

BERAT BUZHALA: Duke besuar që kryetari i Kuvendit po e arsyeton tash edhe Rregulloren, unë e kam vetëm një pyetje.

Kur po flasim për zotin Selver Haradinaj dhe vrasjen e tij, unë kisha me e pyetur liderin e Lëvizjes Vetëvendosje: A është e vërtetë që në atë kohë, ky ka qenë në kateteri të Tiranës, duke rrahë këngëtarët rom, të cilët po këndonin këngën "gjurgjevdan je"?

KRYETARI: Fjalën e ka kryeministri!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari kryetar,

Të nderuar deputetë,

Natyrisht se secili nga ne e ka legjitimitetin qytetar që të prezantojë atë për çka është zgjedhur.

Dëshiroj të potencoj edhe një herë se është vendim i tyre, i asaj partie apo kësaj partie, i atij grupi parlamentar apo këtij grupi parlamentar që të rrijë në sallën e Parlamentit apo të del jashtë, është zgjedhja e tij.

Prandaj, pajtohem me zotin Hamiti. Ka qenë zgjedhje e Grupit Parlamentar të tyre, që të largohen. Por, në të njëjtën kohë, dua të jem, por edhe zoti Hamiti duhet të jetë i sinqertë para opinionit publik, se ka qenë pikërisht kërkesë e LDK-ës që kryeministri të jetë në sallë.

Kur kryeministri...

(Reagim)

Ishe i paqartë, dhe ju e dini se kritika letrare dhe politika janë dy botëra pak si më ndryshe. Prandaj...

(Ndërhyrje: Unë, i di të dyja çka janë...)

Po de, ti tana i din! Kemi me të dhënë ndonjë çmim për merita!

Edhe një herë, është zgjedhje e juaj. Unë kam ardhur këtu që të marr pjesë në debat, megjithëse s'e kam pasur obligim kushtetues dhe ligjor, por si shqetësim sepse tek e fundit ka qenë si debat në Parlament dhe nuk ka qenë e ftuar Qeveria, dhe nuk ka qenë e iniciuar nga Qeveria.

Ju keni kërkuar që të jam, dhe natyrisht e ndjej obligim qytetar, kombëtar dhe shtetëror. Sikur që askush prej asnjë deputetëve nuk do të mund t'i ikë përgjegjësisë për rrethanat e reja të krijuara, dhe përgjegjësisë për të ardhmen.

Prandaj, nuk ia vlen që të flitet për perëndimin vetëm me fjalë të thata, por sistemi perëndimor, i nderuari zoti Hamiti, ndërtohet mbi sistemin e vlerave perëndimore. Por, te ne ende jetojmë... I përmende vitet e 30-ta, kur ndonjëherë njerëzit kanë rënë në gjumë patriotë e janë çuar në mëngjes tradhtarë, ose janë ra tradhtarë e janë çuar patriotë... Flas sidomos prej atyre, që kanë deficite patriotike dhe mundohen të gjithë me i futë në një thes.

Sa i përket uniformës së Policisë së Kosovës dhe asaj serbe, dje e përmendët përsëri komunikimin tim me uniformën e ushtrisë dhe policisë serbe, dhe nëse s'e dini ju si më të ri të Vetëvendosjes, e dinë baballarët tuaj!

(Ndërhyrje)

Po, po, e dinë, shumë mirë e dinë! Por, kur ka qenë koha. Prandaj e di që ju ka mbetur merak, por shansin e keni pas, e keni humbur, kurrë më ajo shans për ju s'ka me u kthye.

(Ndërhyrje...)

Po edhe Preshevën, që po e përmend, kush po të pengon me shku në Preshevë? Kush është duke të penguar?

(Ndërhyrje...)

Edhe në Ulqin, kush duke të penguar me shku në Ulqin?

Tjetra. Çfarë gabimi trashanik, zoti Hyseni e di shumë mirë, se ka qenë ministër i Jashtëm, ka bërë një nga kryetarët e një partie opozitare me i dërgu letër Këshillit të Sigurimit për seancë të jashtëzakonshme?!

Ne po përpiqemi si ta zhvendosim çështjen e Kosovës nga Këshilli i Sigurimit, ku është Rusia, ndërsa këtu dërgohen letra për seanca të jashtëzakonshme në Këshillin e Sigurimit. Gabim trashanik politik! Por, s'them tradhtar. Kjo është injorancë politike, pa dije, ka ndodhë. Ne tash nuk duhet me e gjykua! Po, s'mund t'i thuhet njeriut tradhtar për gabim politik, siç e bëni ju.

Por, dëshiroj të theksoj edhe një herë, se sulmet që ndodhin kundër një komuniteti të caktuar, duhet të jemi shumë të kujdesshëm dhe të përgjegjshëm politikisht dhe kombëtarisht dhe të mos motivojmë apo të mos nxisim gjëra, që nuk janë në interes të shtetit tonë.

Nuk mund ta ndërtojmë shtetin me incidente dhe dhunë. Mjaft Millosheviqi ka ushtruar dhunë ndaj shqiptarëve! Cili ishte rezultati? Kosova e pavarur sovranë, e njohur prej 90 shteteve.

(Ndërhyrje...)

Kur ta përmbylli, dil edhe fol këtu, tash dëgjo!

Është e vërtetë se e kam quajtur akt terrorist dhe qëndroj pas atij qëndrimi. Vrasja e Selver Haradinajt ka qenë akt terrorist kryekëput, edhe kriminal, por juve ju kujtohen edhe ndaj UÇK-së kur me broshurën tuaj i quanit aktet e UÇK-së terroriste, se s'janë të lidhura shumë me popullin. Njëherë duhet puna me masat pastaj veprimet kundër ushtrisë dhe policisë.

Jo, jo se edhe ti je njëfarë njësi gueril, Rexhep Mala e din! Ke pas nxënë pritë nganjëherë, por kurrë s't'ka shkrep! Pse s't'ka shkrep, e di vetë! Për ty Liburn po flas, na njihemi qitu jemi. Dhe ju e dini se ata që kanë pretenduar me luftua kundër Serbisë kurrë dorëzuar s'janë, me përjashtim të Naitit që u kidnapua.

Prandaj, edhe sa i përket negociatave që mendoj që nuk është fer, është e pasinqertë, është e papërgjegjshme të sulmohen njerëzit ashtu kur ne vetë bashkë me Lidhjen Demokratike të Kosovës - si koalicion, i qëndrueshëm dhe funksional në atë kohë e mirëkuptuam, e mirëpritëm në Parlament për të filluar dialogun për çështje teknike. Zoti Hyseni është këtu! Një rezolutë që doli nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të vazhduar me dialogun teknik. Ai dialog ka filluar, natyrisht se duhet implementim dhe duhet presion edhe më i madh në veçanti ndaj Brukselit që të

insistojë tek Serbia që të implementohen ato marrëveshje. Por, e kam potencuar, e dje potencoj edhe sot, më vjen keq Ardiani doli jashtë do të ishte mirë me kon brenda, ndihem tepër mirë që e keni dërguar me shkollua, por mendoj që përsëri duhet me i çuar në ndonjë kurs tjetër pak ma gjerë dhe thellë me i kuptua gjërat në politikë. Negociatat dhe takimet që kanë ndodhur mes Qeverisë së Kosovës me aprovimin e plotë të Parlamentit të Kosovës kanë qenë transparente. Kanë qenë të hapura, kanë qenë të hapura për opinion publik kosovar, për rajonin, për të gjithë botën të udhëhequra nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Por, në të njëjtën kohë kur akuzoni për takime me zyrtarë të Serbisë bënu edhe të vetëpërgjegjshëm, të ndërgjegjshëm edhe kur zyrtarët e juaj takohen me ministrat e Qeverisë së Serbisë boni bile publike, le ta dijë edhe elektorati juaj që po takoheni edhe ju të Vetëvendosjes edhe Ardiani, e unë nuk i akuzoj pse po takohen por së paku le të ketë transparencë e të bëhen të hapura, apo të gjysmë të hapura.

Tanë takohen edhe Lidhja Demokratike këtu si në të djathtë, edhe Partia Demokratike!

(Ndërhyrje)

Po, po, po! Po, po edhe Aleanca, edhe Vetëvendosja bile të Qeverisë së Kosovës... jo, jo të lutem, të lutem!

(Ndërhyrje, reagime)

Jo, se nëse ju akuzoni për tradhti një takim publik në Bruksel Edita Tahirin, unë ju them “po” deputetët tuaj takohen në konferenca ndërkombëtare edhe me: ministra të Qeverisë së Serbisë, i nderuari zoti Hamiti, takohen edhe me... Të lutem, të lutem po dëgjomë tash, të lutem! Po ju e dini, se vetë i keni dërguar, të lutem, të lutem. Takoheni me ministrat e Qeverisë së Serbisë, takoheni edhe me kryetarë të komunave paralele që janë në veri, takoheni edhe me këshilltarë të autoriteteve të Serbisë, unë nuk po flas vetëm për LDK-ën, por flas edhe për LDK-në, edhe për Partinë Demokratike, edhe për Vetëvendosjen, po flas edhe për AAK-në. Ndoshta, edhe Dautit s’i ka kallëxu Ardiani, apo Albinit nënkryetari i tij, por kjo ka ndodh.

Krejt ajo çka ke, është që të mos merren takimet e dikujt publike për akuza të ndërsjella, ndërsa takimet që ndodhin në takime ndërkombëtare, për mua çdo komunikim dhe pretendim për të gjetur zgjidhje, për të ecur si shtete të pavarura drejt NATO-s dhe Bashkimit Evropian janë të mirëpritura. Por, së paku le të jenë të hapura, le të jenë transparente.

(Ndërhyrje)

Po, mi kanë kallëzuar të juajt. Ata bashkë janë shku kanë udhëtuar prej Prishtine deri në takime, bashkë kanë shku krejt edhe ju e dini. Tash unë nuk jam ai që dëshiroj të flas me emra, se tek e fundi për secilin prej tyre unë kam respekt, por së paku tregohuni të singertë para opinionit publik kosovar. Përkundrazi, unë e çmoj atë guxim të atyre njerëzve që e kanë marrë nga partitë e juaja për takime të tilla për të diskutuar në tubime

regjionale, ndërshtetërore dhe i falënderoj për qëndrimet e tyre të forta shtetërore. Po, takime ndodhin, por bëhuni transparentë. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Jo, në fillim Qeveria edhe kryeministri edhe ministrat e kanë të drejtën siç e kanë deputetët për fjalë jashtë rendit të ditës. Pastaj, e keni marrë fjalën 4 deputetë, 4 grupe parlamentare që e keni të drejtë me Rregullore të Punës së Kuvendit.

(Ndërhyrje)

Shikoni, nuk është qashtu! Këqyrni rregullin 48, e keni bile me nëntitull: Deklaratat e ministrave. Prandaj, fjala-fjalën, thotë populli s'e mund kurrë. Kështu që më mirë po e mbyllim këtë. Ardian pasi ta ka përmend emrin, 2 minuta shkurt!

ARDIAN GJINI: Edhe 20 sekonda. Faleminderit, zoti kryetar!

Mendoj se ajo që duhet të thënë këtu, është kështu: duhet me u taku, duhet edhe me kërkua takime edhe sikur ne të ishin në pushtet në vend të zotit Thaçi, kishim kërkuar takime - të gjitha llojeve. Nuk kishim pritur me na i organizua tjerët, por i kishim kërkuar vetë, po nuk ishim taku tinëz.

Dhe, po më duket që Berati mirë e ka krye punën. E ka informua kryeministrin se Berati u kanë për takimin, për të cilin është ka flet edhe për Vetëvendosjen, edhe për mu, edhe për LDK-në, edhe për përfaqësuesit e Malit të Zi, të Maqedonisë, të Serbisë, të Amerikës e të gjithë.

Po flet për një konferencë dhe po abuzon me një fakt! Por po ju them: bukur Berat! Po ju them që këto takime i vlejné Kosovës edhe unë e kisha nxit edhe kryeministrin me marrë pjesë vetë mos me i çuar veç këshilltarët edhe deputetët se u kanë rendi edhe vetë me marrë pjesë në këto takime, janë të mira.

Por, e keqja është me u taku tinëz, dhe e keqja është me u taku me përfaqësues të biznesmenëve, e keqja është me bo biznese të ndryshme, e keqja është mos me ditë kurrkush që po takohen. Takimi me 40 vetë, nuk është i fshehtë kryeministër. Takimet me një me një, vetëm me biznesmena, janë të fshehta.

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë vetëm kërkova që takimet që ndodhin, të jenë transparente.

Unë nuk akuzova, thash: e çmoj vendosmërinë dhe guximin tuaj që me të vërtetë të gjithë që keni marrë pjesë keni mbrojtur qëndrimin kushtetues dhe ligjor të Kosovës, edhe qëndrimin e shtetit të Kosovës. Bile jeni prezantuar në mënyrë shumë unike për çka edhe duhet t'ju jemi mirënjohës.

Por, në të njëjtën kohë, vetëm kërkova që të mos akuzoni të tjerët që takohen para kamerave, ndërsa takimet tjera që ndodhin edhe ato le të bëhen transparente. Prandaj, ju

keni përvojë edhe më herët, keni përvojë edhe në takime tjera, edhe për veriun se tek e fundit ke qenë në pushtet, mirë me është iu tregu qytetarëve çka ke bë kur ke qenë 3-4 vjet në pushtet. Aq, me treguar sa për hatër. Dhe, e di çka ke bo për hatër!

KRYETARI: Deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën. Vetëm një prej Lidhjes Demokratike. Rend shkoj, rend jam duke shkuar, mos u ngutni, fare.

ISMET BEQIRI: Veç një fjali zoti kryetar!

E tha edhe kryeministri në fillim, na është e drejtë e grupit parlamentar edhe i yni është me ndej ose me dal, duke e ditë që ka me i thanë këto që i tha, edhe normalisht kemi dal.

Por, është mirë kur të bëhen adresimet me i përmend me emra, sepse u përmendën... Ajo që më irritoi dhe e kërkova fjalën është se u përmendën strukturat paralele. Domethënë, takime me strukturat paralele.

Do të doja zoti kryeministër, vërtetë kush është i LDK-së që takohet me struktura paralele?! Dhe, sinqerisht po e them, diçka e tillë ne as s'e besojmë që ka ndodh as s'mund të ndodh.

I përmend konferencat, nuk po dua tash me thënë takimet e tjera, e tjera, po është mirë mos me i gjeneralizuar gjërat dhe është mirë me i thënë me emra konkretë po qe se ka pas të tillë dhe absolutisht ne as nuk jemi në pushtet dhe as nuk e kemi dëshirën e as vullnetin të takohemi aq më pak me strukturat paralele, sepse këtë e thatë. Dhe, nëse e kam marr gabim, duhet të më thonë s'e kam thënë, por ju e thatë kësaj - ka pas takime.

Kjo nuk qëndron. Kjo nuk qëndron dhe të LDK-ës nuk marrin pjesë në takime të tilla, sepse as s'i shohin të arsyeshme, e as s'i pranojnë, sepse ata janë ilegalë për ne dhe janë struktura që po e kriminalizojnë atë pjesë të vendit. Kjo ishte.

KRYETARI: Kryeministri po e do fjalën, se e pyet, le të përgjigjet!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Zoti shef i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Ismet Beqiri,

unë besoj se e ki atë guxim qytetar me më shiqu. Atë që ta them, ta them me bindje të plotë me argument të plotë, por përgjigjen në këtë pyetje i takon kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të nderuarit zotit Isa Mustafa.

(Ndërhyrje)

Po, nëse s'është këtu. Gjejani!

KRYETARI: Berat Buzhala e ka fjalën.

BERAT BUZHALA: Ardiani tha: "Berati paska raportua mirë" e në tjetrën anë tha "kanë qenë 40 veta".

Ndoshta, Ardian kanë raportuar 40 veta për këtë punë, por veç një gjë mund ta them unë që në darkën ku keni qenë ti edhe Shpendi unë s'kam qenë. Unë kam qenë me bodigarda, më kanë lënë diku në fund, e ju keni qenë në darkë që unë s'di çka keni fol aty.

KRYETARI: Visar Ymeri e ka fjalën!

(Ndërhyrje)

E, mos e ço dorën për Liburnin se ai është vet këtu. Po, këtu e kam Liburnin, po ti je shef i grupit. Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: U deklarua! Pra kryeministri deklaroi se ka qenë akt terrorist dhe unë mendoj që reagimi është dashur të jetë në përputhje me këtë deklaram. Kur thuhet “akt terrorist” reagimi duhet të jetë shumë urgjent dhe diskutimi duhet të jetë, prandaj edhe ka qenë e nevojshme seanca e jashtëzakonshme.

Por, sa i përket UÇK-ës dhe të kaluarës. UÇK-ëja, nuk është personale e juaja, UÇK-ëja është e qytetarëve të Kosovës, është edhe e fëmijëve tanë. Na i edukojmë fëmijët në luftën e popullit shqiptar dhe prandaj e mbrojmë atë. Dhe, e mbrojmë atë nga ju! A po e din, e mbrojmë pikërisht nga ju, sepse është kjo politikë sot që e dëmton atë luftë dhe ne në mbrojtje të vlerave kombëtare dhe në frymën e edukimit të brezave të ri e kemi për obligim me mbrojt atë.

E, sa i përket arrestimeve, kanë mund të arrestohen në Kosovë ata që kanë qenë në Kosovë. Kush ka qenë në Kosovë në atë kohë i organizuar ka mund të arrestohet. Nuk është mirë me paragjykuar kush e qysh është arrestuar, a është kidnapuar, a ka ndodh në atë mënyrë apo në këtë mënyrë. Pra, ka mund të arrestohet në Kosovë ai që ka qenë dhe ka vepruar në Kosovë. Ka qenë përballë rrezikut, dikush është zënë i paarmatosur, dikush është zënë i armatosur në mënyra të ndryshme.

Për sa i përket të kaluarës dhe LKÇK-ës, ku kam qenë unë anëtarë dikur do të mund të debatojmë në një rast tjetër, sepse është çështje historike, është diçka tjetër.

Tash, për sa i përket takimeve, unë dua t'ju informoj dhe besoj që është informuar Kuvendi dhe e kemi informuar Kuvendin. Na kemi qenë në një takim rajonal në Sarajevë, si komision, nga i cili takim ne kemi dal për shkak se është synuar të na prezantojnë me Rezolutën 1244. Kemi dal nga takimi dhe mbasi që kanë vendos që të na prezantojnë baras, njëjtë të gjithëve jemi kthye në takim dhe këtu kemi qenë anëtarë të komisionit nga Kuvendi.

Pra, ky ka qenë një takim rajonal është njoftuar Kuvendi. Gjatë daljes, kemi qenë vazhdimisht në komunikim, dhe ne nuk kemi dashur të pranojmë që të prezantohemi si 1244. Por, sa i përket letrave që i kemi dërguar, ne i kemi dërguar edhe Bamir Topit, Presidencës së Republikës së Kosovës edhe presidentes. Dhe, kur bëhet fjalë për

Këshillin e Sigurimit ne nuk i kemi dërguar Këshillit të Sigurimit. I kemi dërguar OKB-ës. Ne OKB-ën e njohim...

KRYETARI: I ke kaluar 2 minuta!

LIBURN ALIU: Ne OKB-ën e njohim, por nuk e njohim Rezolutën 1244.

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Po ia jap fjalën edhe Sabri Hamitit, le përgjigjet kryeministri dhe vetëm kah dy minuta edhe e mbyllim këtë pjesë.

SABRI HAMITI: Zoti kryeministër,

Faleminderit për adresimin që ma bëre 2-3 herë me emër!

Faleminderit edhe për bisedimet, sepse kur fole për çka është perëndimore, ju në të vërtetë më cituat, por ju po flitni me sedër s'po ma pranoni mendimin tani po e përdorni. Dhe më vjen mirë edhe kjo, që jeni perëndimor dhe ju uroj që të jeni perëndimore, sepse jeni kryeministër. Absolutisht edhe veç më bën mirë.

Në anën tjetër, mu po më vjen keq! Unë dola dhe i thashë tri pika dhe kryesorja ishte kjo që u prodhua më vonë: Pse, pse të mos ketë referenca njohjeje, e vetë njohje brenda, por po zhvillohet dialogu kush çka është, a është taku me dikënd me një shtet fqinj. Është gabim.

Nëse ka nevoja për takime në emër të institucioneve të Republikës së Kosovës, ato janë bërë dhe do të bëhen. Dhe nuk ka nevojë të verifikohet kush çka është nëpërmes një takimi a ka qenë a s'ka qenë.

Ky ishte insistimi im i fillimit, ky është edhe fundi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëro!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Zoti Hamiti, faleminderit që tash u pajtove në fund me mua plotësisht...

(Ndërhyrje)

Natyrisht, bota perëndimore dhe bota demokratike, mbi të gjitha e respekton transparencën.

Prandaj, unë kërkova vetëm për atë, që një takim i para kamerave i një zyrtari të Qeverisë që ndodh në Bruksel të vlerësohet si tradhti shtetërore, ndërsa takimi i mbyllur, që unë nuk e them me qëllim të keq që ka ndodhur e që nuk u bë transparent, të vlerësohet patriotik.

Zoti Hamiti, të jemi të qartë! Nuk është tradhti dhe kërkoj që të mos vlerësohet tradhti shtetërore një takim që ndodh publik me prezencë e udhëheqje të Bashkimit Evropian dhe prezencën e SHBA-së, ndërsa një takim tjetër jo transparent dhe pjesëmarrja edhe e opozitës të vlerësohet si diçka patriotike që është në interes të fqinjësisë së mirë.

Pra, unë e respektoj gjithmonë transparencën më tepër,, por nuk jam edhe kundër atyre takimeve që të marrin pjesë, e a kanë qenë 40, a kanë qenë 45 a 30, tek e fundit, ajo organizatë që i ka organizuar takime të tilla shumë e çmuar dhe vlerësuar në gjithë botën.

Në anën tjetër sa i përket takimit në Sarajevë, mendoj se do të ishte mirë, dhe për këtë e keni liderin tuaj afër pyeteni se kanë ndodhur disa takime tjera ku kanë marrë pjesë zyrtarët tuaj. Ju tregon menjëherë, dhe nëse doni unë pres këtu derisa të tregon. Edhe ti e din!

KRYETARI: Faleminderit!

(Ndërhyrje)

Ju lutem, unë dua ta lexoj se dikush po më doket s'po e din rregullën ose nenin 48 të Rregullores së Punës së Kuvendit. Unë po e lexoj në tërësi:

“Në çdo mbledhje plenare të Kuvendit ministrat, me kërkesë dhe me marrëveshje me kryetarin e Kuvendit, mund të flasin në Kuvend për ndonjë çështje që ka të bëjë me fushëveprimtarinë dhe përgjegjësinë. Pasi ta ketë marrë fjalën kryeministri ose ministri, kryetari i Kuvendit lejon të parashtrohen komente ose pyetje në emër të grupeve parlamentare dhe nga deputetët e Kuvendit individualisht, ministri që e ka mbajtur fjalën e ka të drejtën e përgjegjësitë shkurtimisht komenteve ose pyetjeve me iu dhënë që mund t'i parashtrohen”.

Kjo është e përcaktuar në Rregulloren, por realisht koha duhet të jetë më e shkurtër, jo bash me i dhënë hapësirë të pakufishme. Deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën

ISMET BEQIRI: Zotni kryetar,

Ne ju paralajmëruam më herët, për shkak të një akademie që mbahet, kishim dashur meqenëse dëshira e shumicës deputetëve të LDK-së është që të marrin pjesë, nëse e jepni një pauzë OK Nëse jo, ne shkojmë po arsyeja është kjo.

Unë nuk mund t'i them asnjërit prej deputetëve të mos merr pjesë sepse e ka dëshirën edhe vullnetin, prandaj po qe se do të ishte e mundur ua kishim ditur për nder, nëse mund të thuhet, që ta jepni një pauzë ose, ose ju mund të vazhdoni pa ne, por kjo është arsyeja që ne dëshirojmë të marrim pjesë. Faleminderit!

KRYETARI: Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Unë e vlerësoj se nuk është vullnet vetëm i LDK-së por është vullnet i gjithë deputetëve dhe i gjithë qeveritarëve se Sali Çeku është dëshmor i kombit.

Prandaj, unë e mbështes, dhe kërkoj që të japim një pauzë derisa të kryhet akademia.

KRYETARI: Unë po e jap pauzën, por po dua ta them publikisht se kjo është lojë me perspektivën e qytetarëve tani e tutje.

Unë kam respekt për të gjithë dëshmorët dhe heronjtë dhe ditët e pushimit janë të përcaktuara me ligj. Megjithatë, ju bëni pushim nëse doni tërë kohën. Pushim deri në ora 15:00!

(Vijoi pauza)

(Pas pauze, seanca vazhdoi punën)

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,
Ju e dini që atëherë kur nuk kemi votuar, mund t'ia fillojmë edhe pa kuorum seancën dhe nëse jeni dakord, pra ju që jeni këtu, pyetjet parlamentare do t'i kishim lënë për nesër?

A jeni dakord që t'i lëmë për nesër? Në rregull! Atëherë, nesër vazhdojmë me pikën e 3 të rendit të ditës.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Mirë, po vazhdojmë me pyetjet parlamentare. Deputetja Blerta Deliu – Kodra pyetje për ministrin Dardan Gashi.

BLERTË DELIU – KODRA: Faleminderit, kryetar!

Ndër problemet kyçe sot ministër është edhe ndotja e mjedisit. Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë, por edhe i industrisë ka bërë që mjedisi të ndotet edhe në shkallë shumë të lartë. Sot është më se e qartë se problemet mjedisore, ndonëse ndjehen në nivel lokal, ato vazhdojnë të jenë edhe çështje globale.

Fatkeqësisht edhe në Kosovës ndotja e mjedisit vazhdon të jetë e lartë dhe mjaftë shqetësuese. Mjedisi po ashtu, paraqet edhe një sfidë pasi që mbrojtja e tij e ka edhe koston e saj. Andaj, besoj që si institucione duhet të jemi të përgjegjshëm përballë problemeve mjedisore që ndikojnë drejtpërdrejtë në shëndetin tonë.

Zoti ministër, çfarë veprimesh ja ndërmarrë ministria që ju e drejtoni që të ndikojë në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit në përgjithësi në Kosovë dhe duke u mbështetur në Ligjin për mbrojtjen e mjedisit a ka ndërmarrë Ministria hapa konkretë për themelimin e fondit për mbrojtje të mjedisit? Fond ky që do të përdorej për përmirësimin e gjendjes së mjedisit pasi që, siç e thash edhe më herët, mbrojtja e mjedisit e ka edhe koston e saj.

KRYETARI: Ministër Gashi, e ke fjalën.

MINISTRI DARDAN GASHI: I nderuar, kryetar!

Të nderuar kolegë të kabinetit,

Të nderuar deputetë,

Deputetja Deliu, faleminderit shumë për pyetjen! Se çka ka ndërmarrë Ministria për Mbrojtjen e Mjedisit vitin e kaluar e deri tash, besoj se edhe dihet. Ndër të tjera, janë edhe aksionet ndaj Ferronikelit, ndaj KEK-ut, ndaj Sharrcemit - aksioni për mbrojtjen e lumenjve.

E sa i përket Ligjit për Fondin e mjedisit, ky ligj ashtu siç ka qenë në draftin e kaluar, ka qenë në kundërshtim me Ligjin për financa publike, andaj edhe është vonuar. Ndërkohë, ne i kemi afruar pozicionet në Ministrinë e Financave dhe besoj se shumë shpejt ky ligj do të paraqitet edhe para jush për miratim.

Pra, ky ligj do të mundësojë pra që kostoja e lartë e mbrojtjes së ambientit dhe riparimit të shkatërrimit të ambientit deri sot, të mbulohet nga ky fond. Faleminderit!

KRYETARI: A ke pyetje shtesë deputete? Faleminderit!

Deputetja Blerta Kodra – Deliu pyetje për ministrin Ramë Buja.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

BLERTA KODRA – DELIU: Studentët e Universitetit të Prishtinës, kryesisht ata të kategorive të dala nga lufta, janë të pakënaqur me trajtimin që atyre po u bën Qendra Studentore.

Studentët thonë se janë të privuar nga e drejta për t'u liruar nga pagesa e konviktit edhe pse i kanë plotësuar të gjitha kriteret e parapara. Madje, atyre nuk u janë marrë parasysh as ankesat që janë bërë në adresë të zyrtarëve kompetentë.

Studentët, të cilët kryesisht janë fëmijë të dëshmorëve, janë të pakënaqur me mënyrën se si ata janë anashkaluar nga kjo qendër përderisa ata i akuzojnë këto institucione se i kanë privilegjuar anëtarët e Parlamentit studentor me lirim nga pagesa.

Zoti ministër, a kanë të drejtë anëtarët e organizatave studentore të lirohen nga kjo pagesë dhe si mund tu privohet kjo e drejtë familjarëve të dëshmorëve dhe kategorive të tjera, të cilat janë në nevojë?

KRYETARI: Ministër Buja, e ke fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuari, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë ministra,

Të respektuar deputetë,

E nderuar deputete Kodra, faleminderit, shumë për pyetjen e bërë!

Unë këto ankesa do t'i kisha pritur me shumë kënaqësi po të ishin bërë me shkrim për tek unë. Te unë nuk ka ardhur asnjë, por unë dua të sqaroj atë që në fakt është e shkruar dhe

është e faktuar për këto kategori të studentëve që i kemi në Qendrën Studentore dhe po ju them që drejtorja e Qendrës së studentëve, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë i përmbahet memorandumit marrëveshje apo të mirëkuptimit të nënshkruar nga ministri i MASHT-it dhe Zyrës së Kryeministrit për çështjen e kategorive të luftës së UÇK-së të datës 25.9.2009 me numër të protokollit 625 dhe vendimit të MASHT-it të datës 19.10.2011 numër protokollit 25-2, ku në mënyrë të qartë rregullohet se cilat kategori të studentëve lirohen nga pagesat në qendrën studentore.

Lirimi lejohet për: fëmijët e dëshmorëve djalë/vajzë; fëmijët e invalidëve të luftës me shkallë invaliditeti 40% e më lartë; studentët invalidë të luftës dhe studentët e veteranë të luftës.

Në 3 vjetët e fundit janë liruar të gjithë studentët e këtyre kategorive, të cilët i kanë plotësuar kushtet me dokumentacionin valid që e kanë sjell.

Në vitin akademik 2011-2012, të gjithë studentët që kanë aplikuar e që i përkasin këtyre kategorive janë pranuar dhe numri i tyre është ky: fëmijët e dëshmorëve 240 studentë; fëmijët e invalidëve të luftës me shkallë të invaliditetit 40% e më lartë 40 studentë; studentët invalidë të luftës janë 10; studentë veteranë të luftës janë 10.

Studentët e kategorive të dala nga lufta nuk kanë nevojë që të aplikojnë në qendra të studentëve për lirim nga pagesa, sepse listat e këtyre hartohen dhe vijnë nga shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së me seli qendrore në Prishtinë si: Shoqata e Familjarëve të Dëshmorëve; Shoqata e Invalidëve të Luftës dhe Shoqata e Veteranëve të Luftës.

Vlen të theksohet se të gjithë këta studentë lirohen nga strehimi dhe ushqimi ose pagesa për ushqim dhe strehim në Qendrën e studentëve.

Përveç kësaj duke iu referuar Vendimit të MASHT-it, nga pagesa lirohen edhe këto kategori të tjera: studentët invalidë civil të luftës që janë 10 sosh; studentët në asistencë sociale janë 200 studentë; studentët që i kanë prindërit e zhdukur në luftë janë 30; studentët me aftësi të kufizuar janë 10 studentë; studentët që janë anëtarë të Parlamentit studentor janë 40 prej tyre.

Në grupin e studentëve të Parlamentit studentor hynë kryesia, senatorët, anëtarë të këshillit të fakulteteve dhe anëtarët e redaksisë së gazetës studentore “Bota e Re”, sepse këta studentë janë pjesë e angazhimit të përditshëm për çështje studentore. Por, studentët që janë pjesë e Parlamentit studentor që janë 40 sosh lirohen vetëm nga pagesa e strehimit jo edhe ajo e ushqimit. Sa për dijeni kosto e lirim për një vit për këta studentë është 247.000 euro. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputete, a ke pyetje shtesë?

BLERTA KODRA – DELIU: Faleminderit, për shpjegimin zoti ministër! Unë këtë pyetje e bëra për shkak se në vargun e ankesave që janë bërë, më kanë kontaktuar mua dhe

shumë studentë nga komuna e Skenderaj, të cilët i kanë plotësuar kriteret dhe janë privuar nga kjo e drejtë.

Unë do të doja të bëja një pyetje, në fakt këtë pyetje e parashtrova më herët, sepse si duket anëtarësimi i studentëve në këto organizata studentore po duket si mundësi e mirë për të përfituar një bursë këta studentë dhe për tu anashkaluar studentët për të cilët me të vërtetë i plotësojnë kushtet.

Të dhënat e Ministrisë së Arsimit thonë se rreth 700 studentë përfitojnë nga mos pagesa që ata duhet t'i bëjnë Qendrës studentore. E thatë edhe ju më herët se kjo është arritur në sajë të një memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë dhe Zyrës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së lidhur me statusin e studentëve fëmijë të dëshmorëve të luftës.

Ndryshe, sipas këtij memorandumit të mirëkuptimit parashihet që invalidët e luftës, fëmijët e dëshmorëve dhe fëmijët e invalidëve të luftës të lirohen nga detyrimet financiare të strehimit dhe të ushqimit....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër, a do me thënë edhe ndonjë fjalë?

RAMË BUJA: E nderuara deputete!

Unë shpjegova që ato lista që kanë shkuar nga shoqatat që i para përmenda janë respektuar të gjitha.

Unë do të kisha dashur me shumë kënaqësi t'i pres studentët të cilëve iu është mohuar kjo e drejtë. Unë akoma nuk kam pasur asnjë të vetme ankesë as me shkrim e as duke ardhur për tu ankuar për këtë gjë.

Andaj, sinqerisht nëse keni kontakte me njerëz të tillë, me studentë të tillë ju thoni që të vijnë në Ministrinë e Arsimit që të sqarohemi për këto gjëra. Por unë, asnjë ankesë të tillë të shkruar, nuk kam. Ju faleminderit!

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Kërkoni për këtë çështje debate, pastaj bëjmë debat. E tash, respektoni pyetjet parlamentare! Deputetja Ganimete Musliu pyetje për ministrin Ramë Buja.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti ministër, në janar të vitit 2012 Parlamenti Studentor i Universitetit të Prishtinës, pas një hulumtimi të bërë, ka dal me të dhëna jo të mira për përgjegjësinë e profesorëve universitarë në mbajtjen e rregullt të ligjëratave, ku jo rrallëherë ndodh që studentët të presin me orë të tëra dhe mos të kenë mundësi të dëgjojnë ligjëratën e paraparë me orarin mësimor.

Kjo dukuri po e dëmton imazhin e Universitetit dhe po ndikon negativisht në procesin e studimeve në të gjitha fakultetet.

Duke pas parasysh që posa të ngritët kjo çështje, gishti drejtohet nga MASHT-i, a mund të na sqaroni se cili është roli i MASHT-it në disiplinën e profesorëve dhe përmirësimin e imazhit të Universitetit të Prishtinës, apo kjo është thjeshtë në përgjegjësinë e Rektoratit?

KRYETARI: Ministër e ke fjalën! Veç ndoshta deputetja është mirë me i pyetur deputetët që janë profesorë!

MINISTRI RAMË BUJA: Kryetar, pak kom me i shtuar asaj që po thua. Por, po ju them për hir të opinionit të qytetarëve dhe të deputetëve, që mbase nuk janë të sqaruar për këtë gjë, por edhe ligji, që ju keni aprovuar këtu në këtë Kuvend dhe unë gjithsesi e respektoj, është ai që përcaktohen detyrat e secilit institucion që është në vartësi të MASHTI-it por fakt këto janë përgjegjësi ekskluzive të Universitetit Publik të Prishtinës.

Kështu që, ne bëjmë intervenimin legal ligjor atëherë kur shkelen procedurat në procese të caktuara, por asnjë gjë tjetër. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputete a ke pyetje shtesë? Atëherë, e ke fjalën!

GANIMETE MUSLIU: Fillimisht, dua të falënderoj kryetar për sugjerimin që ma dhatë që t'ju bëj pyetje deputetëve, por këtë nuk e kam has në Rregullore të punës së Kuvendit se ekziston mundësia që t'ju drejtohem me pyetje parlamentare deputetëve të mi kolegë.

E dyta. Zoti ministër, të falënderoj shumë për sqarimet që na i dhe. Unë dua të sqaroj se kam qenë e shtyrë të bëj këtë pyetje, sepse në të gjitha debatet televizive dhe në të gjitha konferencat e studentëve gishti është drejtuar nga Ministria dhe tani besoj që edhe studentët, por edhe ne si deputetë, e kemi të qartë se në përgjegjësinë e kujt është kjo kompetencë. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Ju e dini që me ligj institucionet dhe Universiteti si institucion është i pavarur në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të veta. Dhe, deputetët konsideroj që duhet ta dinë këtë. Deputetja Alma Lama, pyetje për kryeministrin Thaçi. Kryeministri s'është! Alma a do ta bësh pyetjen? Fjala deputetes Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Po, sigurisht që kryeministri s'është, se ai di vetëm të akuzojë, dhe se nuk ka dëshirë të ballafaqohet. Ai mendon që tjerët s'kanë dëshirë të ballafaqohen me të, por në fakt ai nuk ka guxim të vijë këtu dhe të ballafaqohet.

E tillë është edhe pyetje parlamentare, të cilën unë ia kam drejtuar. Dhe pyetja është: Përse Qeveria nuk e ka sjell në Kuvend Projektligjin për legalizimin e ndërtimeve pa leje, i cili është përgatitur që prej vitit 2009 nga Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor?

Kur e bëra herën tjetër këtë pyetje, thash se, qoftë se kryeministri nuk vjen do t'ia jap përgjigjen vet. Dhe përgjigja është kjo: Ky ligj po flenë në sirtarin e kryeministrit, sepse ai nuk është i interesuar që të vendos rregull në urbanizëm. Përkundrazi, është i interesuar të favorizojë firmat, të cilat ndërtojnë pa leje, sepse ato e mbushin arkën e buxhetit të partisë së tij. Faleminderit!

KRYETARI: Kjo e fundit s'di sa qëndron?! Deputetja Time Kadrijaj pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Ministër, a keni dështuar kur e keni bërë hartimin e Ligjit të punës Nr. 03 L-212 apo keni dështuar në ndërtimin e mekanizmave mbikëqyrës për monitorimin e zbatimit të ligjit për shkak se po kërkonin ndryshime të Ligjit të punës, onkretisht keni ankesa edhe keni bërë kërkesë që të shkurohet pushimi i lehonisë prej 12 muajve në 6 muaj, në deklaratimet televizive që keni bërë kohë më parë në televizionet publike?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI NENAD RASIĆ: Hvala gospodine predsjedniče!

Poštovani kolege ministri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Gospodo Kadrijaj,

Iako sam u jednom momentu mislio da je retoričko pitanje, ipak treba da vam kažem da apsolutno mislim da nismo – nuk kemi deshtu – nismo izneverili ni u načelu, kad smo Zakon usvajali, ni sad u toku ideja nekih, koje bi trebale da znače poboljšanje zakona.

Ja sam zvaničnu izjavu, koja je bila odnosno intervju gde uvek kažem da bi bilo dobro razmotriti kao jednu od ideja mogućnost smanjenja trudničkog bolovanja, zbog toga što današnja prezentacija „hulumtimi“ ili jednog istraživanja koje smo radili, je bila da je od 30.000 ispitanika, ispitanih radnika u privatnom sektoru, od toga je bilo samo 5.600 žena ili tačnije 18%, što znači da je broj žena, pogotovo zadnjih godinu dana, u znatnoj meri opao u upoređenju sa drugim godinama.

E sad, kao što znate i vi, jer ste i sami bili na sastanak u Ministarstvu za rad gde smo pričali o analizi koja je u toku i koju radi Parlamentarna grupa za zdravstvo i socijalno staranje. I na tom sastanku smo pričali o tome kad budete vi odnosno parlamentarna grupa završila analize u vezi jednogodišnjeg izveštaja o implementaciji Zakona o radu, tad ćemo pričati o mogućim merama poboljšanja zakona o radu.

E sad, naravno opet se vraćam na onu moju izjavu, da ukoliko smatrate vi kao deo poslaničke grupe, kao deo poslaničke komisije, da neke određene mere treba preduzeti kao što ja smatram i ukoliko smatrate da 18% zaposlenih žena u privatnom sektoru jeste malo, onda to znači da nešto bi sigurno trebalo da menjamo.

I ja bih vas samo zamolio jednu stvar, pošto vaša istraga ili vaše sad delovanje u analizi jednogodišnjeg izveštaja o implementaciji Zakona o radu jeste u toku, ja vam

preporuĉujem da prvo navratite kod predstavnike poslodavaca, pre svega Privredne Komore, koja siguran sam moĝe da vam da podatke o tome koliko je ŝena zapoŝljeno u prethodnoj godini i koliko je trend zapoŝljavanja ŝena opao.

Prema tome, kada budete videli sve te podatke, kao ŝto sam ja video, ja sam siguran da ċete doċi...

(Ndĕrprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdojani, pĕr nja 30 sekonda!

NENAD RASIĆ: ... do iste ideje da neŝto moramo da promenimo, da bi stimulisali zapoŝljavanje ŝena. Jer, opet ponavljam, samo 18% u privatnom sektoru, po meni, to je stvarno – deshtim! Nije dĕshtim ono ŝto smo mi usvojili zakon. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, ministĕr! Deputete, a ke pyetje shitesĕ? Fjalĕn ia jepni, deputetes Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Ministĕr, gjatĕ vizitĕs qĕ e kemi bĕ ne si Komision parlamentar, meqenĕse jemi nĕ monitorimin e Ligjit tĕ punĕs, ne nuk kemi kĕrkuar qĕ tĕ ndryshohet ligji, as qĕ tĕ zvogĕlohet pushimi i lehonisĕ prej 1 vit deri nĕ 6 muaj, por kemi kĕrkuar qĕ tĕ implementohet ligji. Dhe me mekanizmat monitorues qĕ i keni, siĝ ĕshtĕ inspektorati i punĕs, ju tĕ bĕni monitorimin dhe institucionet qoftĕ publike apo private t’i detyroni me mekanizmat ligjorĕ qĕ tĕ respektohet Ligji i punĕs dhe konkretisht pushimi i lehonisĕ.

E di qĕ jeni tĕ thirrur nĕ numĕr tĕ vogĕl tĕ inspektorĕve tĕ punĕs dhe numrin e madh tĕ organizatave punuese, mirĕpo ka edhe mekanizma tĕ tjerĕ me tĕ cilĕt ju mundeni me i detyruar institucionet me i respektuar Ligjin e punĕs, konkretisht nenin 48 tĕ pushimit tĕ lehonisĕ qoftĕ me nĕj qarkore informative, me tĕ cilĕt i informoni institucionet se duhet tĕ respektohet, pĕrmdryshe do tĕ merren masa ligjore...

(Ndĕrprerje nga regjia))

KRYETARI: Ministĕr!

NENAD RASIĆ: Faleminderit, zotĕri! Hvala gospodine predsedniċe!

Joŝ jednom ponavljam ono ŝto sam odgovorio pre nekoliko nedelja, mislim, ovde.

Posle godinu dana implementacije, bilo je samo ċetiri sluċajeva trudniċkog bolovanja, gde su evidentirani kao krŝenje prava. Ponavljam: samo ċetiri sluċajeva.

A naravno, da smo ono ŝto smo obavljali svi sve ovo vreme - godinu i tri meseca, je bilo informisanje, i podsetiċu vas da smo ċak u aprilu 2011. objavili mesec takozvane „amnestije“ za sva preduzeċa da bih u tih mesec dana samo poseċivali i informisali koja su glavna naċela Zakona o radu.

Znaçi mi smo sa naše strane, pogotovo Inspektorijata za rad, i bez obzira što imamo, tačno je da imamo ograničen broj radnike, informisali većinu poslodavaca, a pored toga uspeh smo da skromno povećamo za 10% broj inspektora, sa 50 tadašnjih sad jeste 55, odnosno biće vrlo skoro 55. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Vazhdojmë! Deputetja Kimete Bytyqi pyetje për ministrin Fehmi Mujota. Deputete e ke fjalën!

KIMETE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

I nderuari, zoti ministër.

Duke pasur parasysh faktin se gjendja e tanishme e rrugës: Maqitevë, Dobërdolon, Pagarushë, Nishor, Krevasari të komunës së Therandës është në gjendje të mjerueshme. Si dhe, duke pasur parasysh premtimet që i është dhënë komunitetit të këtyre fshatrave nga ana e Qeverisë për asfaltimin e kësaj rruge, kërkojmë nga ju, zoti ministër, të më njoftoni si ka ndodhur që këto rrugë të mos asfaltohen deri më tani dhe, a planifikohet asfaltimi i tyre në të ardhmen?

KRYETARI: Ministër e ke fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, nderuari kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Bytyqi, ju falënderoj shumë për kujdesin që keni treguar për gjendjen, përkatësisht nevojën e shtrimit të rrugëve në fshatrat që i keni përmendur. E unë, vetëm dua t'ju bëj një korrigjim ndoshta teknik se nuk bëhet fjalë për një rrugë që lidh Maqitevën me Dobërdolanin se fizikisht janë të palidhura, por bëhet fjalë për disa rrugë dhe disa fshatra për të cilat është e vërtetë se ka nevojë që këto rrugë të asfaltohen.

Rruga për të cilën ju keni shtruar pyetje ose rrugët për të cilat ju keni shtruar pyetjet janë rrugët të cilat kategorizohen si rrugë me karakter lokal. Pra, janë ekskluzivisht përgjegjësi dhe kompetencë e komunës së Suharekës.

Mirëpo, duke pas parasysh gjendjen e infrastrukturës rrugore, prej pasluftës e deri tani janë bë shumë investime dhe sidomos në vitet e fundit dhe neve na vjen mirë që tani mund t'i numërojmë fshatrat veç e veç të cilat kanë ngelura të pa asfaltuara. Por, është e nevojshme që të bëjmë më shumë që edhe ato fshatra që kanë ngelur pa përfunduar këto punë t'i përfundojmë sa më parë.

Me këtë nuk dua të heq përgjegjësinë, përkatësisht angazhimin e Ministrisë së Infrastrukturës karshi komunës së Suharekës edhe pse ka përgjegjësinë dhe kompetencën e plotë mbi këto rrugë, por ju bëj me dije se për hir të fjalës publike kryetari i komunës, organet komunale të Suharekës kanë dërguar projektet e këtyre rrugëve dhe unë mund të numëroj cilat rrugë që kanë dhënë një buxhet të tyre për bashkëfinancim dhe Ministria e

Infrastrukturës po e shqyrton secilën kërkesë veç e veç nga ato komuna, të cilat iu kanë përshtatur plotësisht programit të bashkë financimit.

Dhe, këtu dua të sqaroj një gjë sepse ka kërkesa të tri kategorive. Ka komuna të cilat bëjnë kërkesa për projekte të reja që e kanë një procedurë tjetër të miratimit përmes buxhetit në këtë Kuvend dhe natyrisht ka edhe kërkesa që kanë të bëjnë me lidhjen e projekteve përkatësisht projekte që lidhin dy komuna që kanë një përparësi në bashkë financim dhe projekte të cilat kanë karakter ekskluzivisht lokal ose edhe lidhje rrugësh brenda fshatrave, me një prioritet pak më të ulët.

Prandaj, jemi duke i shqyrtuar të gjitha këto kërkesa dhe nga komuna e Suharekës, përkatësisht mbi bazën e angazhimit të komunës investimet që do t'i ketë komuna e Suharekës janë këto: në Tërrnje në Prebisht, Budakov lagjja Kololli, magjistrerja M25 – Grejokovc, rruga në fshatin Nishor, rruga Pagarush - Dobërdolan dhe rruga “Brigada 123”.

Sipas dokumentet që kemi marrë duket se serioze janë angazhimet në rrugën e Grejkovcit dhe në rrugën “Brigada 123” në bazë të investimeve që ofron komuna dhe atëherë Ministria e Infrastrukturës do të angazhojë një buxhet fillestar për vitin 2012 dhe përfundimtar në vitin 2013, për t'i përfunduar këto rrugë.

Njëkohësisht, dua të sqaroj publikun dhe natyrisht interesimin e të gjithë deputetëve se gjitha angazhimet tona në këtë vit janë të përmbushura deri tani dhe investimet kryesore kapitale, se dihet se kanë shkuar në ndërtimin e rrugëve...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Pyetje shtesë, deputete? E ke fjalën!

KIMETE BYTYQI: Faleminderit!

Zoti ministër, ju gjatë fushatës u keni premtuar qytetarëve të fshatit Maqitev që do t'ju shtrijmë asfaltin. Mirëpo sot e asaj dite, asgjë s'keni bërë. Këta qytetarë kanë qenë edhe në Ministrinë tuaj, mirëpo asgjë s'keni bërë deri më sot.

KRYETARI: Ministër e ke fjalën.

FEHMI MUJOTA: Faleminderit!

Po vazhdoj aty ku mbeta. Komunat duhet të kenë vëmendjen pak më të madhe në harxhimin e buxhetit të tyre për rrugët lokale. Por, për prapë po them, për hir të fjalës publike, ministri Mujota s'ka dhënë asnjë premtim dhe po bën angazhim maksimal që ta bëjë maksimumin në këtë drejtim.

Edhe për Maqitevën edhe për fshatrat tjera projektet, të cilat do të vijnë do të trajtohen dhe jemi të bindur se në këtë periudhë kohore edhe mbi bazën e mundësive buxhetore do të realizohen, dhe jo vetëm në komunën e Suharekës por edhe në shumë komuna tjera, sepse të mos mbesim borxh ka shumë nevoja.

Kërkesat janë për 61.000.000 investime, përkundër investimeve të mëdha që janë bërë deri tash. 61.000.000 nuk i kemi për të investuar në të gjitha rrugët që kërkohet të investohet, por do të zgjedhim prioritet dhe sigurisht komuna e Suharekës do të ketë zgjidhje të mirë në këtë drejtim.

KRYETARI: Kërkoj nga shefat e grupeve t'i thërrasin deputetët të rrinë në sallë! I keni pas 3 orë e më tepër pauzë.

Mësoni dhe duroni me ndej në detyrën primare që e keni, dhe e keni marrë edhe nga qytetarët e Kosovës. Është përgjegjësi totale e deputetëve që s'rrinë as 30 minuta në sallë.

Deputetja Time Kadrijaj pyetje për ministrin Ferid Agani. Ministri s'është këtu! Deputete a do me bë pyetjen? Urdhëro, e ke fjalën!

TIME KADRIJAJ: Po, më vjen keq që ministri nuk është sot. Kohëve të fundit ministri i Shëndetësisë Ferid Agani ka marrë një vendim dhe ua ka dërguar të gjitha institucioneve shëndetësore, me të cilin i obligon institucionet shëndetësore që femrat e mbuluara të kontrollohen nga femrat mjeke gra, gjë që është e pamundur.

Me Kushtetutë, Kosova është vend laik dhe më vjen keq dhe le të mbetet e shënuar se Qeveria e Kosovës po merr vendime që kanë të bëjnë me natyrë fetare, me bindje fetare dhe me punë që janë krejtësisht profesionale, siç është shëndetësia. Andaj, më tutje do ta elaboroj këtë temë, kur ministri është prezencë në seancën e radhës. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, kjo temë nuk është për pyetje parlamentare. Realisht, kjo temë duhet të jetë për debat se politika i përcakton shumë mirë detyrat dhe përgjegjësit që i kanë, sidomos institucionet, e në mënyrë të veçantë Qeveria.

Kjo nuk është edhe njëherë po them për pyetje parlamentare, kjo është për debat dhe secili ministër që e merr detyrën duhet ta respektojë në rend të parë Kushtetutën e shtetit ose nëse ai ka diçka tjetër le të shkojë të bëhet ministër atje ku atje ia lejon Kushtetuta e shtetit.

Jo, realisht kështu duhet të jetë, sepse disa gjëra që po bëhen, qoftë deklaratat jashtë rendit të ditës, qoftë në pyetje parlamentare nuk e kanë vendin në këto pika rendit të ditës. Disa çështje është mirë të trajtohen në debate dhe është përgjegjësi e Kuvendit me e mbrojt Kushtetutën.

Deputeti Ramiz Kelmendi, pyetje për ministrin Bedri Hamza. Deputet, e ke fjalën.

RAMIZ KELMENDI: Procesi i fiskalizimit ka filluar në vitin 2010 dhe po bëhen dy vjet që nuk po përfundon ende. Një grup i madh kompanish janë angazhuar për ta përfundu këtë proces po procesi nuk po përfundon.

Duke e ditur se fiskalizimi si bazë e paraqitjes së shtetit modern ekonomik, si formë e barazisë së bizneseve, si teoremë e eliminimit të informalitetit, si element më strategjik të

mbushjes së buxhetit dhe stabilitetit buxhetor, si parametri i rëndësishëm për luftimin e korrupsionit, po bëhen dy vjet dhe ky proces nuk po përfundon.

Mua më intereson ta pyes ministrin: Kur ka planifikuar që procesin e fiskalizimit ta përfundojë në Kosovë?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari, zoti kryetar,

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

I nderuari deputet Kelmendi, faleminderit shume për pyetjen!

Fiskalizimi si proces dhe si projekt është zhvilluar në shumë vende, e posaçërisht viteve të fundit në vendet e regjionit. Është një projekt që në kohë ka kërkuar në shumicën e vendeve, të cilat është implementuar 3 deri në 5 vjet.

Qëllimi është se, dhe me shumë drejtë e thatë ju edhe në pyetjen e juve, përveç rritjes buxhetit të shtetit është që të krijohet ambient i përshtatshëm edhe për konkurrencë lojale.

Ky projekt në Kosovë ka filluar në prill të vitit 2012. Është paraparë që të implementohet në dy faza: faza e parë që përfshin periudhën prill 2010 dhe prill 2012, ku kanë qenë të planifikuara që të fiskalizohen të gjitha bizneset me qarkullim më të madh mbi 5.000 euro, dhe fazën e dytë që përfshinë periudhën prill vitit 2012 - prill vitit 2014, bizneset të cilat kanë qarkullim më të vogël se 5.000 euro.

Deri më tani ka pas progres për me vlerësuar në këtë projekt ku si rezultat i implementimit të arkave fiskale kemi pas edhe rritjen e të hyrave që administrohen dhe mbledhen nga Administrata Tatimore për 18% në vitin e kaluar në krahasim me vitin paraprak, mirëpo realisht ka pas mundësi që dinamika e këtij fiskalizimi të këtij projekti të jetë më e mirë.

Ka vonesa të caktuara, edhe pse s'janë të theksuara në të gjitha hallkat e këtij zinxhiri. Edhe në laboratorin i cili merret me certifikimin e këtyre pajisjeve edhe operatorët të cilët e kanë fituar licencën dhe të drejtën, kanë pasur vonesa. Edhe biznesi, një numër i tyre, ka hezituuar me u pajis me pajisje fiskale dhe me i shërbye konsumatorët me kupona fiskalë, por mbi të gjitha barra bie në Administratën Tatimore dhe në Ministrinë e Financave.

Deri më tani, janë pajisë me pajisje fiskale rreth 15.555 tatimpagues, rreth 19.000 pajisje fiskale dhe shprehur në përqindje nga totali i planifikuar sa janë fiskalizuar - janë rreth 83% deri në këtë moment dhe presim që pjesën tjetër, domethënë ta përfundojmë deri në 6 mujorin e parë të këtij viti dhe faza e dytë qysh tani startohet.

Jemi në fazën finale të certifikimit të pajisjeve për fiskalizimin e pompave të benzinës. Ka kompani që janë shembull i suksesit dhe duhet me u përdor si shembull për të mirë,

një prej tyre, jo pse ju e bëtë pyetjen zoti Kelmendi po pse është e vërtetë - është Kompania e juaj edhe me rastin e pajisjes me pajisje fiskale edhe me rastin e lëshuarjes së kuponave fiskalë, ndërsa për pjesën tjetër, bizneset të cilat kanë qarkullim më të vogël se 5.000 euro...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Pyetje shtesë! Deputet, a ke pyetje shtesë?

RAMIZ KELMENDI: Ne e dimë që pompat e benzinës janë biznese që operojnë me më tepër se 5.000 euro dhe deri më sot nuk janë fiskalizuar edhe pse e bartin barrën kryesore të mbushjes së buxhetit të Kosovës sepse kanë pjesëmarrje të fuqishme në akcizë, ndërsa i kemi fiskalizuar: qebaporet, trafikantët të cilat kanë ndoshta qarkullim edhe më të vogël.

Ishte dashur, për shkak të stabilitetit të buxhetit dhe për shkak të një barazie biznesore, që ky segment i mbushjes së buxhetit mos të anashkalohet dhe të përshpejtohet procesi i fiskalizimit.

Është e vërtetë që kemi bërë 83% të fiskalizimit të atyre që ju i keni paraparë, mirëpo ne i kemi 83.000 biznese që paraqet diku rreth 20% të realizimit të punës, ashtu ka qenë?

KRYETARI: Ministër, mund të vazhdosh!

BEDRI HAMZA: Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti deputetë. Përveç qebaporeve, barnatoreve kemi fiskalizuar edhe importues të mëdha, që në mesin e tyre jeni edhe ju.

Sa i përket fiskalizimit të pikave të karburanteve ato marketet të cilat shërbejnë brenda këtyre janë të fiskalizuara dhe janë të pajisura me arka fiskale, mirëpo aty kërkohet lloji i veçantë i pajisjeve që janë në fazën finale të licencimit nga laboratorit që këtë të drejtë e ka fituar Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike pranë Universitetit Publik të Prishtinës.

Ne presim që ky projekt të startojë shumë shpejt, të përfundojë gjatë këtij viti dhe normalisht nga prilli i këtij viti do të vazhdojmë me fiskalizimin e bizneseve të cilat kanë qarkullim më të vogël se 5.000 euro në vjet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Donika Kada – Bujupi, që nuk është këtu, i ka dy pyetje. Kalojmë në pyetjen e fundit: deputetja Rita Hajzeraj – Beqa pyetje për ministrin Nenad Rasiq.

RITA HAJZERAJ – BEQA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Në fakt, po bëhen shumë pyetje për Ligjin e punës po meqë nuk po zbatohet atëherë jemi të detyruar që të bëjmë pyetje vazhdimisht.

Zoti ministër, pse nuk po respektohet Ligji i punës?

Na tregoni sa akte nënligjore janë nxjerr nga ana e ministrisë tuaj për këtë ligj?

Dhe, na tregoni ju lutem sa gjoba i ka shqiptuar inspektorati i punës për ato institucione apo ndërmarrje private, të cilat çdo ditë i shkelin të drejtat e punëtorëve?

(Ndërprerje e incizimit)

NENAD RASIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Pa kad kažete zašto se ne poštuje Zakon o radu, to je kao da kažete sašto se ne poštuje Zakon o saobraćaju. Ko krši taj zakon, ako vozi više nego ograničenom brzinom, verovatno se kažnjava.

Tako da to je opet, kažem možda retoričko pitanje, ko ne poštuje zakon biće zbog toga adekvatno finansijski kažnjen.

E sad, što se tiče drugog dela vašeg pitanja u kome se pitate koliko administrativnih uputstava i pravila smo već usvojili.

Ja bih iskreno predložio da vam to dostavim pismeno, jer zato što ima tri strane, i neću moći sve sada da pročitam, ako se vi slažete naravno. A reči ću samo ovaj deo, koji se tiče kazni koje su dosad obrađene, odnosno finansijske nadoknade, koji su poslodavci bili obavezni da plate zbog nepoštovanja zakona o radu.

Pre svega da napomenem da, je recimo za 2010.godinu, u globalu bilo 121 novčana kazna. 2011.godine, je bilo 136, a ove godine, u ovom tromesečnom periodu je do sad kaznene mere i opomene u pismenoj formi izrečene su prema 166 radnih subjekata iz razloga što poslodavci nisu poštovali opomene date u pismenoj formi, a za eliminisanje konstatovanih nedostataka, izrečene su novčane kazne prema merama za 21 radni subjekat. Što znači, da pojednostavim, da mi pre svega dajemo opomene odnosno upozoravamo da stanje koje je prilikom prve inspekcije nije u poštovanju sa zakonom i kao u drugoj poseti, u drugom inspektorisanju, odnosno proveriti tih podataka, odnosno proveriti nedostataka, mi tek onda iskazujemo novčane mere, koje su predviđene zakonom.

Kao što rekoh još jednom, ako se slažete ja bih vam poslao u pismenoj formi, zato što imamo više administrativnih uputstava i više pravila i pravilnike, koje smo utvrdili kao dodatak Zakonu o radu i to ćemo vam poslati e-mailom ili poštom. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputete ke pyetje shtesë?

RITA HAJZERAJ – BEQA: Faleminderit, kryetar!

Ju i thatë disa shifra me të cilat jeni marrë dhe ndoshta i keni dënuar, por nuk e dimë se sa shifra apo sa është shuma e parave me të cilat i keni dënuar apo në bazë të ligjit. Ne e dimë që këto subjekte ekonomike, të cilat i keni vizituar asnjëra prej tyre, pasi që keni dal

nga vendi i punës, nuk e ka respektuar Ligjin e punës. Andaj, zoti ministër më vjen keq që ju fare nuk qenkeni në dijeni për zbatimin e këtij ligji.

Ju nuk e dini se gati në të gjitha ndërmarrjet private punëtorët punojnë më shumë se 40 orë në javë, çka është e ndaluar me Ligjin e punës.

Pastaj, ju nuk e dini që për punën shtesë, ata duhet të marrin para shtesë. As këtë nuk e bëjnë.

Për lëndime në punë të punëtorëve, as me këtë ju nuk merreni dhe as nuk zbatohet Ligji i punës në shumicën e ndërmarrjeve private.

Zoti ministër, ju thatë më herët që e kemi shtuar numrin e inspektorëve...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

NENAD RASIĆ: Još jednom ponavljam.

Ja mislim stvarno da nije... OK to je više puta, maltene isto pitanje postavljate više puta. I apsolutno mislim da nije fer da stalno pričate bez ikakve osnove.

Evo sad da vam kažem ako vam bude trebalo bilo koji izveštaj, iz vilo kog preduzeća, iz bilo kog doba dana ili dana u godini za bilo šta što vas interesuje iz zakona, mi smo u mogućnosti da vam dostavimo.

A nemojte tako paušalno i otprilike, da okarakterisujete da nijedno preduzeće ne poštuje zakon, a nemate nijedan pisani dokaz o tome.

Znači, pre svega to je stvarno kao da imate neke predrasude prema Ministarstvu i predrasude prema Inspektorijatu za rad, a ja vam opet kažem ukoliko budete na bilo koji način dokazali, pogotovo one inspekcije koje smo mi vršili a da nije bilo konkretnih rezultata od toga - ja stvarno mogu samo da čestitam na tome.

Inače ako vam bude bilo koji zvanični podatak trebao, mi smo spremni da vam ga dostavimo, ali nemojte tako da bez argumentacije kažete da se ne poštuje Zakon o radu i što je najbitnije da Inspektorijat za rad ne radi svoj deo posla nego jednostavno privatna preduzeća ne budu novčano kažnjena zbog toga što ne poštuju zakon o radu jer, baš na protiv, to se stalno dešava.

Ja nisam hteo da kažem te finansijske šifre i brojke, koliko su preduzeća bila kažnjena, zbog toga što mi jesmo partneri, a recimo prošle godine je bilo 320.000 „in come“, odnosno prihod od tih kazni.

Znači nije poenta u novčanom kažnjavanju preduzeća, zato što su oni naši partneri u celokupnom razvoju Kosova, ali kao nužna mera, na kraju krajeva mi radimo i to. Ali

ostvaruje se jedan određeni prihod koji jeste tu i ponavljam još jednom, ipak je prošle godine...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti)

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Faleminderit! Konstatoj që edhe kjo pikë e rendit të ditës është ezauruar.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës, që është:

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12 prill 2012

Në sallë janë 64 deputetë.

Atëherë, a ka ndokush vërejtje lidhur me Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 12 prill 2012?

Në qoftë se nuk ka, po konstatoj se Kuvendi e miratoi Procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur më 12 prill 2012.

Pika e katërt e rendit të ditës është,

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pasurimin e miellit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural zotin Stavileci që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kolegë të kabinetit qeveritar,

Më lejoni që para jush ta prezantoj ekspozenë e Projektligjit për pasurimin e miellit.

Ky projektligj përcakton rregullat që duhet të zbatohen gjatë pasurimit të miellit për konsum me minerale dhe vitamina, nëpërmjet të cilave pastaj do të ndikohet edhe në parandalimin dhe reduktimin e sëmundjeve që shkaktohen nga mungesa e hekurit dhe acidit folik.

Pasurimi i miellit do të bëhet në bazë të standardit ndërkombëtar, i cili do të rregullohet edhe me akte nënligjore dhe subjektet afariste që merren me aktivitete ekonomike, përkatësisht që prodhojnë, paketojnë, transportojnë ose edhe që importojnë dhe shesin

miell të pasuruar, do të obligohen që t'ju garantojnë konsumatorëve siguri dhe cilësi në bazë të kërkesave të përcaktuara me këtë ligj.

Ndërsa, nëse shikojmë arsyeshmërinë e këtij ligji në një aspekt tjetër, sipas të dhënave të UNICEF-it Kosova vlerësohet se në çdo vit i shpenzon rreth 10.000.000 euro për trajtimin dhe shërimin e sëmundjeve që burojnë nga përdorimi i miellit të pa pasuruar.

Ndër shkaqet më të shpeshta të defiçiensës dhe sëmundjeve të ndryshme që ndërliken me këtë problematikë, janë ushqimi i njëjlojshëm dhe mungesa e mikronutritientëve në ushqim dhe pasojat kryesore të mungesës së vitaminave dhe mineraleve, për shembull tek gratë shtatzëna janë lindja e foshnjave të vdekura, lindjet e parakohshme dhe me pesha të ulëta, si dhe lindjet me anomali të ndryshme.

Ndërsa, rreziku më i madh gjatë fëmijërisë janë: ngecjet në rritje, ngecjet në zhvillimin mental dhe kognitiv, si dhe mungesa e imunitetit dhe rezistencës ndaj sëmundjeve. Ndërkaq, ndikimi tek të rriturit qëndron tek reduktimi i produktivitetit dhe shtimi i rrezikut për sëmundje kardiovaskulare për shkak të mungesës së acidit folik.

Vlerësohet se shkalla e vdekshmërisë paranatale e fëmijëve në Kosovë llogaritet që është rreth 20 në 1.000 fëmijë, si dhe 15.4% e fëmijëve në Kosovë, gjithnjë sipas të dhënave të UNICEF-it, kanë ngecje në rritje.

Të nderuar deputetë,

Pasurimi i miellit është intervenim nga i cili përfiton e tërë popullata, por është vetëm intervenim parandalues dhe jo edhe trajtues. Buka është ushqimi kryesor i njeriut dhe nevojat për ta pasuruar miellin vijnë edhe për shkak që vitaminat e pranishme në grurë humbin gjatë procesit të bluarjes, prandaj kjo është njëra prej metodave më të efektshme që përkrahet më së shumti në botë si nga shkenca ashtu edhe nga mullistët.

Aktualisht, kjo fushë ka qenë e pambuluar ligjërisht dhe siç po nënkuptohet ky ligj si për ruajtjen e shëndetit ashtu edhe në aspektin ekonomik është shumë i rëndësishëm. Prandaj, ju ftoj që ta miratoni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetari i komisionit funksional zoti Hasani, e ka fjalën.

NAHIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Po desha ta pyes Adem Grabovcin a kam drejtë me fol? Sepse, tash demokracia në Kuvend është kufizuar për shkak se duhet me u lajmëruar për me folë, kështu që desha ta pyes, sepse të njëjtat parti, të gjitha e kanë bo me lista me u lajmëruar, e unë s'jam lajmëruar sot. Pra, a kam drejtë me fol shoku Adem, a jo?

Nëse po, atëherë flas, sepse po thonë jeni në emër të komisionit. Komisioni e ka shqyrtuar këtë të drejtë dhe ky ligj i plotëson kushtet për lexim të parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, janë përfaqësuesit të grupeve parlamentare apo kryetarët e grupeve. Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Nijazi Idrizi e ka fjalën.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Ky është një Projektligj i cili ka bërë një rrugë të gjatë të udhëtimit, ka 3-4 vjet që është duke u shqyrtuar derisa ka ardhur këtu.

Në vendet tjera, në vendet e Bashkimit Evropian ky problem është zgjidh përmes tregut të konkurrencës së lirë, domethënë vetë produktet janë ato që i kanë gjetur konsumatorët dhe kanë zgjidh këtë problem, por te ne për shkak të konsumit të madh të miellit që shkon diku rreth 160 kg në vit për kokë të banorit - këtë problem si duket duhet ta zgjidhim në këtë mënyrë siç e kemi menduar, përmes ligjit.

Nuk ka studime që thonë se shkak i anemisë është mungesa e këtyre vitaminave dhe mineraleve, por megjithatë edhe grupi parlamentar e ka ndërmend që ta mbështetë këtë projektligj dhe ne do ta trajtojmë më tutje me punën e grupit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe në parim e mbështetë Projektligjin duke u bazuar në atë se ky projektligj nuk shkakton implikime të mëdha buxhetore dhe njëkohësisht është në harmonizim me standardet e BE-së dhe kontributin tonë do ta japim në kuadër të komisionit që do të jetë, do të thotë lidhur me përpunimin dhe ndryshimin e disa amendamenteve të cilët do të jepen edhe nga ekspertët, e po ashtu edhe nga Komisioni funksional. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Vetëvendosje, zoti Aliu.

LIBURN ALIU: Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e ka trajtuar Projektligjin për pasurimin e miellit.

Natyrisht në fillim ky nuk do të ketë implikime buxhetore, por shpresojmë që meqenëse se do të ketë donacione për implementimin e këtij projektligji fillimisht dhe po shpresojmë që në të ardhmen Ministria do t'i kushtojë rëndësi që të sigurojë buxhet që ky ligj të vazhdojë të implementohet edhe pas përfundimit të donacioneve që janë aktualisht. Natyrisht, ne do t'i japim vërejtjet tona në Komision. Jemi në përkrahje të këtij ligji dhe konsiderojmë se është ligj i drejtë.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar AAK, deputetja Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për pasurimin e miellit.

Edhe ne e përkrahim dhe mbështesim këtë projektligj, sepse kemi punuar në grupe profesionale bashkë me OBSH-ën gjatë organizimit të tryezave të ndryshme, ku është diskutuar në mënyrë profesionale dhe janë elaboruar, arsyet pse është i nevojshëm pasurimi i miellit. Andaj, e përkrahim dhe e mbështesim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Koalicioni Kosova e Re, deputetja Lama.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit!

I nderuari zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re e përkrah në parim këtë projektligj, edhe pse nuk e dimë se a janë bërë hulumtime apo janë konsultuar Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet relevante se a ka pas nevojë në të vërtetë për hartimin e një ligji të tillë. Po sido që të jetë, ne fillimisht do ta përkrahim dhe kontributin tonë do ta japim në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! SLS, Goran Marinković!

GORAN MARINKOVIĆ: Parlamentarna Grupa SLS podržava nacrt zakona u načelu i slaže se sa tim.

KRYESUESI: Faleminderit! 6+, deputeti Demiri.

RASIM DEMIRI: Hvala, predsedavajući!

I parlamentarna grupa 6+, analizirala je ovaj nacrt zakona. Smatramo da odredbe nacrt zakona o obogaćivanju brašna ne krše osnovne principe Evropske zajednice i nema budžetske implikacije, tako da parlamentarna grupa „6+“ podržava ovaj nacrt zakona o obogaćivanju brašna i da će svoj doprinos u radu komisije, na drugom čitanju. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e deputetëve. Zoti Muja e ka kërkuar fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë mendoj që ky ligj është jashtëzakonisht i rëndësishëm të aprovohet dhe unë do të kontribuoj edhe në komision për plotësimin e disa amendamenteve meqenëse kam qenë kontribuues në krijimin e këtij ligji, para këtij legjislacioni dhe është me rëndësi edhe për deputetët që të bëhet një njoftim, dhe shpresoj që edhe në komision anëtarët kanë marrë informacion të plotësueshëm dhe të mjaftueshëm lidhur me benefitet që i gjeneron ky ligj.

Po ashtu, edhe nga aspekti shëndetësor është konsultuar edhe Ministria e Shëndetësisë, edhe studimet e mundshme të cilat sjellin mungesë të këtyre mikroelementeve që mungojnë sot në ushqimin bazë të qytetarëve të Republikës tonë e që është mielli e kur dihet që mielli dhe buka janë pjesa pothuajse më e madhe e ushqimit tek qytetarët tonë. Dhe, mungesa e tillë ka sjell jashtëzakonisht mungesa e këtyre mikroelementeve ka sjell

jashtëzakonisht të sëmundje të cilat janë duke u repokursuar mandej në Ministrinë e Shëndetësisë dhe ndikojnë direkt në buxhet.

Mendoj se, te çështja e implikimeve buxhetore ky ligj nuk paraqet ndonjë implikim buxhetor i cili është shqetësues, sepse flitet për 0,20 cent për kokë banori në total për një vit dhe këtë mund ta mbulojnë vetë mullistët, sepse në mënyrë indirekte mund të stimulohet edhe prodhimi vendor i miellit dhe të pengohet ardhja e pakontrolluar e miellit, i cili hyhet në Republikën e Kosovës.

E inkurajoj po ashtu, Ministrinë sepse kjo si pjesë e kontrollit të ushqimit dhe ushqyeshmërisë së sigurt të popullatës së Kosovës është si një faktor i cili do të stimulojë në mënyrë indirekte po ashtu edhe bujqit që të mbjellin arat e tyre dhe të kenë të garantuara edhe shitjen e produkteve të tyre në Republikën e Kosovës dhe që këto qasje, të cilat kohët e fundit bile këto dy vjetët e fundit flitet se ka një rritje të produktit të prodhimit të grurit në Republikën e Kosovës dhe mendoj që bujqit duhet të ndihmohen më shumë me asistencën profesionale të trajtimit të implementimit të këtij ligji dhe kjo është shumë e thjeshtë. Ne kemi pas rast me ministrin me e pa praktikisht se si bëhet, është shumë e thjeshtë dhe nuk ka asnjë teknologji shumë të diçka të ndërlikuar. Elementet ekzistojnë në treg, dhe këto patjetër duhet të aplikohen për një situatë.

Në Ligj, në nenin 8 dhe në nenin 9 ndoshta do të ishte më mirë që format e sanksionimit të caktohen në mënyrë më toleruese dhe pjesa e afirmimit të furrëtarëve të cilët e shesin miellin me elemente pastruese, të jetë me shenja njoftuese në hyrje të furrës se tyre, që do të theksonte se ky bukëpjekës ka këto elemente të prodhimit të bukës.

Edhe një herë ju falënderoj dhe do të keni përkrahjen dhe kontributin tim pozitiv për këtë ligj. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit për amendamentet! I shpalle para se të jenë... Deputetja Breca e ka fjalën!

NAZANE BRECA: Falemnderit!

I nderuari kryesues,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Ligji për pasurimin e miellit është një ligj shumë i rëndësishëm dhe sipas mendimit tim është pak i vonuar, se është dashtë pak më herët me ardhë në këtë Kuvend për miratim.

Duke u nisur nga fakti se mungesa e vitaminave dhe mineraleve ndikon në paraqitjen e patologjive të ndryshme në organizmin e njeriut, e në këtë rast mungesa e hekurit dhe e acidit folik ndikon në paraqitjen e anemisë.

Anemia është mjaft evidente në popullatën e Kosovës, që vjen si rezultat e mosushqyeshmërisë, apo si rezultat i ushqimit joadekuat.

Kjo më tepër është evidente tek fëmijët dhe tek gratë shtatzëne, ku tek fëmijët ndikon në zhvillimin jonormal të fëmiut, ndërsa te gratë shtatzënë mungesa e acidit folik në tre muajt e parë të shtatzënësisë, mund të ndikojë në paraqitjen e defekteve të tubit neural, e në këtë mënyrë ndikon në lindjen e fëmijëve me anomali të ndryshme. Për këtë arsye ky projektligj është rëndësishëm dhe duhet të miratohet, domethënë, sa më shpejtë.

Dhe në anën tjetër, është me rëndësi se ne duhet t'i shfrytëzojmë edhe donacionet, të cilat jepen nga UNICEF-i, sepse ata do ta bëjnë mbështetjen financiare në 16 muajt e parë, domethënë, pas miratimit të këtij ligji.

Për këtë arsye, është me rëndësi që ne ta shfrytëzojmë këtë kohë, që të përfitojmë edhe prej këtyre donacioneve, në mënyrë që këto donacione të mos shkojnë për ndonjë destinim tjetër. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputetja Bakalli!

AURORA BAKALLI: Falemnderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Nga ajo çka prezantoi ministri i Bujqësisë, këtu para nesh, u krijua një përshtypje, thuajse mielli i cili na ofrohet qenka ndër shkaktarët kryesorë për një vdekshmëri të lartë të foshnjave, më të madhen në Evropë që e kemi dhe për sëmundshmërinë e lartë të popullatës, në përgjithësi te ne.

Është e vërtetë, sepse kolegja Breca shumë mirë tregoi se pasurimi me acid folik në çka ndikon, por këtu një rëndësi shumë e madhe iu dha edhe sëmundjeve kardiovaskulare.

E pash të udhës, patjetër, të flas për këtë çështje, pasi është lëmia të cilën unë personalisht e punoj.

Dua të ju tregoj se në një studim, i cili është lansuar kohëve të fundit, në të cilin janë përfshirë 12.000 pacientë me infarkt të kaluar të zemrës dhe të cilëve iu është dhënë acidi folik dhe pacientëve të tjerë, të cilëve nuk iu është dhënë acidi folik është par se te këta që kanë marrë acid folik nuk kanë pas kurrfarë përfitimi, gjegjësisht nuk kanë pas zvogëlim të sëmundshmërisë nga ngjarjet kardiovaskulare.

Prandaj, të mos i hiperbolizojmë aq shumë, e ka efektin e vetë për ato që i paraqiti shumë bukur kolegja Breca, por jo edhe që mund të shkaktojë mrekullira pasurimi me acid folik e sidomos jo në aspektin kardiovaskular. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Falemnderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

U thanë shumë çështje, sa i përket Projektligjit për pasurimin e miellit, prandaj unë do të provoj të mos e zgjas.

Dhe, po e filloj me një filozofi bazë të kohës së Hipokratit, i cili thotë: “Më thuaj se çfarë ha, të them se si je me shëndet!”.

Andaj rregullimi me ligj i problematikës së pasurimit të miellit, është për t’u përkrahur dhe duhet admiruar ministrinë për punën e bërë. Ushqyeshmëria joadekuate është një nga shkaqet e gjendjeve jo të mira shëndetësore, sepse mungesa e mikronutritientëve në organizëm e njeriut prekë më së shumti shtresat më të ndjeshme të shoqërisë, u tha, shtatzënat dhe fëmijët.

Prandaj, prania e mikronutritientëve, në vlera të kërkuara, në ushqim përmes pasurimit të miellit me hekur dhe acid folik i jep qëndrueshmëri organizmit dhe mbron atë nga sëmundjet dhe çrregullimet e ndryshme, zvogëlon anemitë e lehta, si te fëmijët ashtu edhe te shtatzënat.

Sipas parallogaritjeve, trajtimi i anemisë si pasojë e mungesës së hekurit, është disa herë më i shtrenjtë në krahasim me koston për parandalim të anemisë, duke bërë pasurimin e miellit me hekur dhe me acid folik.

Gjatë leximit vërehet qartë, që ky ligj përcakton rregullat që zbatohen në pasurimin e miellit për konsum, si njëra nga mënyrat që ka për qëllim parandalimin dhe reduktimin e sëmundjeve, të cilat shkaktohen nga mungesa e hekurit dhe acidit folik.

Qëllimi kryesor i këtij ligji, vërehet se është për të bërë dhe përmirësuar gjendjen ushqesë, nutritive dhe shëndetësore, përmes intervenimit siç është pasurimi i miellit me acid folik dhe hekur.

Por një vërejtje është, ajo gjatë leximit të këtij ligji ka mundur të vërehet, domethënë, tek neni 7, te kompetencat e institucioneve për kontrollimin e cilësisë dhe sigurisë së miellit, thuhet se institucionet e autorizuar dhe të akredituara kryejnë vlerësimin e kontrollit të miellit të pasuruar në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Unë mendoj se këtu duhet saktë të precizohet, cili është institucioni i autorizuar për të bërë kontrollimin e miellit të pasuruar? Dhe mendoj, mendimi është se këtu nuk do të duhej përjashtuar Institutin e Shëndetit Publik të Kosovës, sa i përket kontrollit për pasurimin e miellit. Faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Falemnderit! S’ka tjerë të paraqitur. Tani duhet të deklarohe mi votim.

Në sallë janë 64 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët, të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Konstatohet se me 58 vota për, 1 abstenim dhe asnjë kundër, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për pasurimin e miellit.

Kërkohej nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta arsyetojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës, që është:

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për administratën tatimore dhe procedurat

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për administratën tatimore dhe procedurat dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadërgjonaj, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Falemnderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit Qeveritar,

Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për administratën tatimore dhe procedurat. I ka bërë të gjitha plotësim-ndryshimet e mundshme në këtë projektligj. I ka hartuar amendamentet, të cilat kanë kaluar që të gjitha nëpër komisionet kryesore tjerat.

Prandaj, unë i kisha ftuar të gjithë deputetët e Kuvendit, që amendamentet, të cilat i ka propozuar Komisioni për Buxhet dhe Financa t'i miratojnë, ashtu siç janë paraqitë në raport.

KRYESUESI: Shaip, hajde në sallë! O Shaip, Shaip, hajde ulu, ulu. Hajde se s'ka kuorum.

Fillojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet!

Amendamenti 2.

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet!

Amendamenti 3.

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet!

Amendamenti 4.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 5.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 6.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 7.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 8.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 9.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 10.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 11.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 12.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 13.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 14.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 15.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 16.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 17.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 18.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 19.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Të nderuar deputet, tani e votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara!

Në sallë janë 65 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët, të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Konstatohet që me 58 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për administratën tatimore dhe procedurat.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës, që është:

6 Shqyrtimi i raportit të parë për zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian për vitin 2012.

Komisioni për Integritet Evropian në koordinim me komisionet tjera parlamentare, e ka hartuar dhe Kuvendit i ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim Raportin për tremujorin e parë të vitit 2012 për zbatimin e Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës, për integritet evropian.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Integritet Evropian, deputetin Lutfi Haziri, që në emër të Komisionit para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë dhe prezantojë raportin. Zoti Haziri e keni fjalën!

LUTFI HAZIRI: Falemnderit, zoti nënkryetar i Kuvendit, kryesues i kësaj seance!

Ministre Çitaku,

Ministra të nderuar,

Më lejoni që para kolegëve deputetë dhe pjesëmarrësve në këtë seancë, të paraqes Raportin e parë për zbatim nga ana e Kuvendit si dhe i dyti pas miratimit të Raportit të Progresit, i cili është paraqitur nga komisionari Fuhle, më 12 tetor të vitit të kaluar.

Ky plan i veprimit është paraqitur dhe tregon i qartë të arriturat e këtij tremujori dhe si dokument është miratuar në seancën e fundit të dhjetorit të vitit 2011.

Plani i veprimit për integritet evropian për 2012 dhe nga kjo kohë Kuvendi i Kosovës ka ndërmarrë veprime për zbatim të këtij plani. Por, natyrisht që mbeten edhe veprime tjera të pa realizuara me qëllim që sfidat e parapara nga ky raport gradualisht të fitohen.

Plani i veprimit të Kuvendit është dokumenti më i rëndësishëm i institucioneve të Kosovës, i cili tregon punën, përgjegjësinë e institucioneve drejt shtyrjes përpara të agjendës evropiane tashmë si aspiratë e shtetit tonë.

Prandaj, edhe zbatimi i këtij plani nga ana e Komisionit për Integritet Evropian së bashku me komisionet tjera, pas periudhës së tremujorit të parë të këtij viti nxjerr në raport dhe paraqet realisht gjendjen çfarë e kemi.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, gjatë kësaj periudhe raportuese, ka shënuar progres të lehtë, sa i përket zbatimit të planit, por disa veprime mbeten sfida e madhe për t'u realizuar.

Shumica e veprimeve, që në këtë tremujor janë paraparë, kanë ndërmarrë veprime ose janë në zbatim e sipër.

Në këtë raport, në formë tabelore janë paraqitur të gjitha angazhimet, veprimet dhe detyrat e ndërmarra nga institucionet përkatëse, qoftë ajo e komisioneve parlamentare, trupave të Kuvendit, sekretarit, Kryesisë apo institucioneve tjera në vartësi të Kuvendit, që përfshijnë edhe linjat e Qeverisë apo sektorët qeveritarë.

Raporti i parë për zbatimin e këtij plani është i paraqitur në formë tabelore, në 4 kolona, ku në rreshtin e parë ju mund ta shihni që përfshihen sfida që kanë dalë nga Raporti i Komisionit Evropian.

Kolona e dytë, trupat e Kuvendit të Kosovës, përkatësisht komisionet parlamentare.

Kolona e tretë, janë paraqitur veprimet e propozuara, të cilat parashihet të ndërmerren nga komisionet parlamentare dhe Kuvendi.

Dhe rreshti i katërt, janë paraqitur veprimet e realizuara së bashku me periudhën kohore apo realizimin e sfidave.

Më lejoni që të nënvizoj, se Kuvendi i Kosovës gjatë kësaj periudhe i ka miratuar të gjitha ligjet, që kanë dalë nga lista e Komisionit Evropian apo e njohur si lista e komisionarit Fuhle.

Nuk do t'i lexoj ligjet, sepse janë paraqitur në tabelor, ndërsa po ashtu, sipas planit të Qeverisë, të paraqitur në këtë Kuvend dhe të miratuara nga ju, kërkohet edhe miratimi i një numri të madh ligjesh, që është pjesë e kësaj agjende.

Ndërsa, mund ta potencojmë se dy ligje të mbetura nga viti i kaluar, tashmë Kuvendi në tremujorin e parë i ka realizuar, siç është për shembull, Ligji për RTK-në.

Po ashtu, me kërkesë sipas raporteve dhe rekomandimeve nga Komisioni, janë themeluar edhe dy komisione ad-hoc sipas marrëveshjes politike: Komisioni për Amendamentimin e Kushtetutës dhe Komisioni për Amendamentimin e Ligjit për zgjedhje, në veçanti për reformën zgjedhore, i cili dokument duhet t'i përfshijë të gjitha rekomandimet, që Komisioni përmes raportuesit të vet i ka paraqitë tek institucionet e Kosovës.

Zyra për medie dhe marrëdhënie me publikun në bashkëpunim me OSBE-në, e kanë iniciuar hartimin e platformës institucionale për dialog me Shoqërinë Civile dhe Kuvendin e Kosovës.

Deri tash janë ftuar dhe kanë raportuar 4 zëvendëskryeministra, 4 ministra të sektorëve të ndryshëm.

Problem potencohet, se kryesisht raportimi ka ndodhë para Komisionit për Integritet Evropian dhe Komisionit për Siguri, ndërsa komisionet tjera kanë dështuar në realizimin e kësaj të drejte, sepse është e shënuar, se cili komision, në cilin sektor apo cilin ministër e përfshinë në raportim. Por, nënkuptohet që edhe paraqitja e raporteve me shkrim për në periudhë, mundëson që komisioni ta realizojë këtë detyrë.

Ky progres nuk është raportuar në disa fusha të caktuara, siç është:

- Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, lidhur me ekzekutimin e vendimeve, që kërkohet nga institucioni;
- Raporti i Institucionit të Avokatit të Popullit, moszgjidhja e problemit të zëvendësve të Avokatit të Popullit, nga ana e Qeverisë.

- Kuvendi edhe më tutje nuk ka bërë emërimet të tre anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
- Sundimi i ligjit, në veçanti në pjesën veriore të Kosovës,
- Çështja e kufijve është brengosëse.
- Po ashtu, veprimet që kërkon komisioni, ndërmerren me luftë kundër krimit të organizuar, korrupsionit, trafikeve të ndryshme dhe problemeve tjera.

Ende mbeten për t'u realizuar çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorit, çështjen e papunësisë, funksionalizimi i Inspektoratit të Punës, skema e asistencës dhe shërbimet sociale, shëndetësia dhe sigurimet shëndetësore, siguria në trafik, menaxhimi i mbeturinave, çështja e ujit të pijshëm e detyra të tjera.

Një hap i rëndësishëm është formimi i Këshillit Kombëtar për Integritet Evropian, i cili u inaugurua më 27 mars të vitit 2012, nën udhëheqjen e presidentit të Republikës së Kosovës dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të partive politike, institucioneve tjera, shoqërisë civile dhe akterëve, që janë paraparë sipas skemës së miratuar.

Natyrisht, që ky raport nuk mund ta anashkalojë Vendimin e Këshillit të Ministrave të datës 5 dhjetor dhe fillimin e studimit të fizibilitetit, që është lansuar nga Komisionari për zgjerim, më 27 mars të vitit 2012.

Janë veprime konkrete, që i japin dimension krejt tjetër procesit të integritetit dhe natyrisht roli i Kuvendit duhet të vazhdojë të ndërtohet, në atë që thuhet në Raportin e Progresit, se rritja e kapaciteteve mbikëqyrëse të Kuvendit.

Edhe më tutje, sfida kryesore mbetet, që të monitorohet puna e Qeverisë, të mbikëqyret puna e Qeverisë.

Deri tash është raportuar vetëm një vizitë tek zëvendëskryeministri Petroviq, në Ministrinë e Pushtetit Lokal. Ndërsa edhe më tutje, mbetet që të shihet nga afër, se përveç Komisionit për Bujqësi, komisionet tjera nuk kanë paraqitë se sa kanë arritur me e zhvillu monitorimin e drejtpërdrejtë nëpër institucione relevante.

Më lejoni që t'i nënvizoj edhe dy detyra, që Kuvendi i ka realizuar në tremujorin e parë, praktikisht më 18 prill Kryesia e Kuvendit ka bërë ndryshimin, sipas rekomandimit dhe tash është marrë Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e organogramit të Administratës së Kuvendit dhe praktikisht është realizuar pika 6 dhe pika 7, sipas planit të veprimit të kërkuar, që nënkupton një fuqizim më të madh të sekretarit, strukturave të administratës dhe vetë Kryesisë së Kuvendit.

Mbetet kërkesë përkushtimi më i madh i komisioneve, komunikimi me ministrat e sektorëve dhe mbikëqyrja në emër të Kuvendit:

- Angazhim për koordinim më të mirë nga sekretari i Kuvendit dhe Shërbimi civil.
- Raportim i rregullt dhe komunikim në mes sektorëve dhe të komisioneve.

Dëshiroj në fund, të përmendi binjakëzimin dhe rolin që ky projekt e ka për Kuvendin, në ndërtimin e kapaciteteve monitoruese shpresojmë dhe tashmë Asambleja parlamentare e Hungarisë është udhëheqëse e këtij programi, që ju ftojme të bashkëpunoni ngushtë me këtë zyrë, sepse do të jetë në ndihmë të drejtpërdrejtë të komisioneve, e po ashtu edhe me Qeverinë Gjermane që përmes Programit të saj të partneritetit e ndihmon sektorin, ministrinë dhe Komisionin për Integritet.

Në fund, Kuvendi ka ndërmarrë vendime konkrete. Ne do të aplikojmë për përfshirje në bashkëpunim ndërparlamentar në regjion, që është njëra prej detyrave dhe përfshirja e Kosovës në KOSAP, tashmë është çështje që do të trajtohet në Samitin e Sarajevës.

Për fund, ju falënderoj dhe ju lus që detyrat e mbetura nga komisionet, të realizohen sa më shpejtë, sepse ky raport tregon qartë jo vetëm përkushtimin por edhe angazhimin konkret që kemi ndërmarrë ne në realizimin e kësaj agjende, që duhet realisht të jemi rigoroz nëse duam që raporti i këtij viti, më 12 tetor të del pozitiv dhe nëse duam që procesin e liberalizimit dhe studimi i fizibilitetit të jenë dokumente që e përcaktojnë qartë dhe e shkurtojnë rrugën, Komisionet Parlamentare duhet të kryejnë punën e vetë, që përfshijnë edhe rolin e deputetëve e në veçanti të atyre që e kanë për obligim me iu përmbajt Planit të veprimt, sepse është dokument që është miratuar nga Kuvendi i Republikës dhe është obligim, përgjegjësi e tyre me e realizua.

KRYESUESI: Falemnderit!

Tani radha është e përfaqësuesit të Qeverisë, nëse e do fjalën! Nuk e do fjalën!

Kryetarët e komisioneve parlamentare? Jo.

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare? Në emër të PDK-së, e ka fjalën deputetja Deliu.

BLERTA DELIU: Falemnderit, kryesues!

E nderuara ministre Çitaku,

I nderuari ministër Mujota,

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Gjatë këtij tremujori, Komisioni për Integritet Evropiane ka organizuar dëgjime parlamentare me ministra të Qeverisë si dhe ka marrë në vazhdimësi raporte lidhur me sfidat e Planit të veprimt të Kuvendit për integritet evropiane, për vitin 2012.

Komisioni ka vlerësuar se progres brenda kësaj kohe është arritur në fushën e demokracisë dhe të sundimit të ligjit, me ç'rast Kuvendi ka formuar Komisionin për Amendamentimin e Kushtetutës dhe të Ligjit për zgjedhje.

Zyra për media e Kuvendit bashkë me OSBE-në e ka iniciuar edhe hartimin e një platforme për dialog me shoqërinë civile.

Qeveria ka themeluar një grup ndërministror për ta përcjellë implementimin e Strategjisë për reformë të Administratës Publike.

Ministria e Drejtësisë e ka rritur numrin e gjyqtarëve dhe e ka proceduar në Kuvend Projekt-kodin e ri penal të Kosovës, dispozitat e të cilit kanë të bëjnë me luftimin e korrupsionit.

Po vazhdojnë punimet për ndërtimin e burgut të sigurisë së lartë. Brenda kësaj kohe, ashtu siç e tha edhe kryetari i Komisionit për Integritet, Kuvendi ka miratuar edhe Ligjin për transmetuesin publik, i cili garanton hapësirë të nevojshme edhe për komunitetin pakicë, kurse brenda 6 muajsh duhet të sjellë propozimet lidhur me mënyrën e parapagimit të Radio Televizionit të Kosovës.

Kuvendit i janë propozuar edhe anëtarët e KPM-së, kurse përzgjedhja e tyre pritet të bëhet nga komisioni ad-hoc i Kuvendit.

Qeveria e ka hequr tatimin mbi vlerën e shtuar.

Vlen të theksohet se në muajin tetor të vitit 2011 ka filluar lëshimi i pasaportave biometrike, kurse Kuvendi e ka miratuar plotësim-ndryshimin e Ligjit për menaxhim të integruar të kufirit dhe kontroll të kufirit shtetëror.

Është miratuar edhe Ligji për azilin, që rregullon dhënien e azilit dhe statusin e refugjatit. Është inauguruar qendra për azilkërkues, që përmbushë standardet e kërkuara nga Komisioni Evropian dhe kriteret për liberalizim të vizave.

Është miratuar Ligji për të huajt, kurse Qeveria e ka negociuar marrëveshjen për ripranim me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe të rajonit.

Më duhet të theksoj se, vetëm gjatë vitit 2011, janë nënshkruar 6 marrëveshje të tilla, kurse janë në proces marrëveshjet me Bullgarinë, Maqedoninë dhe Kroacinë.

Zyra për komunitete dhe kthim janë themeluar në shumicën e komunave të Kosovës, që merren edhe me ri-integrim të personave të riatdhesuar.

Është miratuar edhe një ligj, jashtëzakonisht i rëndësishëm, që është Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe pritet të hyjë në fuqi më 1 shtator të këtij viti.

Me gjithë progresin e arritur, janë evidentuar edhe sfidat që e kanë përcjellë këtë proces.

Mbikëqyrja e ekzekutivit nga ana e Kuvendit, mbetet ende sfiduese, sidomos kur bëhet fjalë për raportim të ministrave në komisionet parlamentare.

Vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës nuk po ekzekutohen në plotni. Institucioni i Avokatit të Popullit nuk ka arritur që të sigurojë pavarësi të mirëfilltë.

Shqetësuese mbetet edhe mbrojtja e fëmijëve, kurse vdekshmëria e foshnjave nuk është ulur.

Nuk është raportuar ende nëse është hartuar një strategji për rregullim të vendbanimeve joformale, përkundër faktit se Projektligji për shitjen e banesave ka ardhur në Kuvend.

Po ashtu, sfiduese mbetet edhe mbrojtja e konsumatorit, papunësia, funksionalizimi i Inspektoratit të punës, skemat e asistencës sociale, shëndetësia, sigurimet shëndetësore, siguria në trafik, mbeturinat, uji i pijshëm dhe shumë çështje të tjera.

Dhe krejt në fund, më duhet të përmend faktin se me ftesë të Komisionit për Punë të Jashtme të Parlamentit Evropian këtë muaj, për të parën herë ka marrë pjesë në dëgjim publik të organizuar për instrumentin e ri të para anëtarësimit, të njohur si IPA-2, kryetari i Komisionit për Integritet zoti Haziri. Komisioni Evropian me këtë rast i ka propozuar Parlamentit, por edhe Këshillit Evropian asistencë për vendet në zgjerim, përfshirë këtu edhe Kosovën. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit!

Kërkoj falje, por në emër të Komisionit, deputetja Novobërdaliu e ka kërkuar fjalën.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Falemnderit, i nderuar kryesues!

Përsëritet për të gjithë!

Unë e kam analizuar këtë raport të Komisionit për Integritet Evropian, mirëpo edhe pse Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi gjinore, Peticione dhe Persona të Zhdukur, i ka raportuar këtij komisioni për punën e kryer, në raport nuk janë të përfshira pikat e realizuara nga ky komision. Prandaj, kisha kërkuar, që në këtë raport nga stafi të kryhen përmirësimet e duhura.

Pra, duhet të bëhen ato përmirësime, sepse vetëm pika 54 figuron se është realizuar nga ky komision, sepse janë realizuar edhe pika 18; është pika 20, pika 52, në të vërtetë pika 1 e pikës 52 është e realizuar, pika 53 është realizuar dhe pika 54 edhe ashtu figuron se është e realizuar.

Prandaj, kërkoj që të vihen këto ndryshime të Komisionit, të punës së kryer të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Peticione dhe Persona të Zhdukur. Falemnderit, kryesues!

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i LDK-së, deputetja Osmani e ka fjalën!

VJOSA OSMANI: Falemnderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Pas fjalëve të mira që i dëgjuam për veprimet që janë ndërmarrë, unë besoj që qysh në paragrafin e parë të këtij raporti, të gjithë e vëreni që thotë, që numri i të arriturave është shumë i vogël. Prandaj, unë do të ndalem në aspektin tjetër të këtij raporti, që flet për ato që nuk janë arritur.

Në radhë të parë, natyrisht se duhet të ndalemi te institucioni, ku ne vetë jemi, pra në Kuvend. Sepse, sfida më e madhe është mbikëqyrja parlamentare mbi ekzekutivin.

Jo rastësisht, kjo pjesë është tek kriteret politike për integrim në Bashkimin Evropian, do të thotë, tek kriteret më të rëndësishme, sepse në çdo vend demokratik, apo në çdo vend që synon që një ditë të jetë pjesë e BE-së dhe strukturave euro-atlantike, në përgjithësi, kjo është një prej kriterëve, që vlerësohet më së shumti.

E kemi një numër të madh të komisioneve, ku nuk praktikohet raportimi nga ana e ministrave. Si duket ka komisione, që mendojnë se një gjë e tillë nuk është e rëndësishme, apo një gjë e tillë nuk duhet të bëhet sepse ministrat po e kryekan punën e mrekullueshme!

Por, në fakt, si shembull mund të merret pikërisht Komisioni për Integrim Evropian edhe pse udhëhiqet nga opozita, kurse Ministria udhëhiqet nga një parti tjetër, që ka qenë si shembull në Raportin e Progresit.

Kështu që, unë i ftoj të gjithë kolegët, që janë në udhëheqje të komisioneve, që të përmenden si shembuj në Raportin e Progresit të vitit 2012, për mbikëqyrje parlamentare dhe ftesat e ministrave, të cilët natyrisht se sipas këtyre standardeve, duhet domosdo të raportojnë me shkrim.

Ne kemi raste, ku ministri i Punëve të Jashtme asnjëherë nuk raporton në Komisionin për Politikë të Jashtme.

Zëvendëskryeministrja Tahiri asnjëherë nuk raporton as në Kuvend, as në komisionet përkatëse, përkundër faktit që e ka këtë për obligim edhe me rezolutë të Kuvendit, e mos të përmend edhe shembuj tjerë.

Kështu që, në këtë aspekt, mund të themi se Kuvendi ka mbetur jashtëzakonisht mbrapa dhe kritikata natyrisht duhet t'ia bëjmë institucionit ku ne jemi, e jo Qeverisë.

E dyta. Po flasim për reformën e Administratës Publike. Prapë, në vend se ta akuzojmë vetëm Qeverinë, ne duhet të fillojmë nga Kuvendi, sepse në Raportin e Progresit, një ndër kritikata kryesore për Kuvendin është kryesisht nepotizmi dhe punësimi në baza partiake.

Përkundër faktit, që po bëhen reforma në organogram nuk ka asnjë veprim konkret nga ana e Administratës së Kuvendit, që është ndërmarrë për të parandaluar këtë fenomen, që përmendet në Raportin e Progresit.

E treta. Në këtë raport flitet për marrëveshjet e ashtuquajtura IBM. Flitet për Shqipërinë dhe Maqedoninë.

Pyetja ime është: ku është Serbia? Meqenëse zëvendëskryeministrja dhe Qeveria në përgjithësi, me aq mburrje po e paraqesin marrëveshjen IBM me Serbinë, si marrëveshje ndërshtetërore, atëherë është e udhës që edhe Kuvendi ta përfshijë si të tillë, në qoftë se vërtetë e pranon. Në qoftë se nuk e pranon, qartazi duhet të thuhet edhe në këtë raport, që Kuvendi nuk e pranon marrëveshjen IBM me Serbinë.

E katërta. Është çështja e krimeve ekonomike. Përkundër faktit që janë ndërtuar strategji, nuk ka asnjë veprim konkret nga ana e institucioneve, për arrestimin e kriminelëve që merren me këto krime, që natyrisht ekziston edhe si sfidë kryesore në veri.

Dhe, përfundimisht, në faqen e fundit të pjesës së parë të këtij raporti, flitet për legjislacionin që ka të bëjë me institucionet mikrofinanciare dhe thuhet së ky legjislacion ende s'ka përfunduar.

Unë rekomandoj që kjo pjesë të ndryshojë, sepse ne e dimë që është miratuar një ligj për bankat dhe institucionet mikrofinanciare, por Kuvendi i Kosovës, në vend se t'i marrë për bazë standardet evropiane për këtë ligj, ka vendosur ta marrë për bazë Bangladeshin dhe Zambinë. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, deputetja Lama.

ALMA LAMA: Falemnderit, zoti kryesues!

Si fillim dua ta them se ky raport, në titull evidenton faktin që do të duhej të shihej puna e Kuvendit të Kosovës, mirëpo meqë i kam marrë parasysh të gjitha pikat që vijnë nga Raporti i Progresit dhe janë raportuar aty, atëherë edhe fjala ime do të jetë në përgjithësi për të gjitha këto vërejtje se si janë adresuar.

Si fillim dua të them se përpjekja e institucioneve të Kosovës, veçanërisht e Qeverisë, për të adresuar vërejtjet e Raportit të Progresit, mbetet sipërfaqësore dhe sa për sy e faqe. Siç e keni parë edhe në këtë raport, pra në raportin e parë të planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës, nuk shohim asnjë veprim domethënës, që ia vlen për t'u shënuar. Ka miratime ligjesh, por jo implementim të tyre.

Sa për informacion, po e filloj me reformën zgjedhore. Pikërisht sot, përfaqësuesi i BE-së në Kosovë ka dhënë kritika shumë të forta, sa i përket çështjes së reformës zgjedhore.

Duke pasur parasysh mbështetjen e fuqishme të Bashkimit Evropian për procesin e reformës zgjedhore në Kosovë, përfaqësuesi special i BE-së - shefi i zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë dhe shtetet anëtare të BE-së, të përfaqësuara në Prishtinë, thotë: duan të shprehin shqetësimin e tyre për mungesën e një përparimi substancial deri më sot, veçanërisht duke marrë parasysh mandatin e Komisionit Parlamentar për Reformën Zgjedhore, i cili përfundon më 22 prill 2012.

Pika tjetër, shumë e rëndësishme, e cila padyshim ngelet si një nga problemet më të mëdha, ka të bëjë me mbikëqyrjen e Qeverisë, nga ana e Kuvendit të Kosovës.

Kjo mbikëqyrje vazhdon të mbetet e zbehtë. Ministrat madje, as nuk marrin pjesë në seancat parlamentare edhe pse janë të detyruar me Rregulloren të Kuvendit dhe me Kushtetutë të Kosovës, e cila e sanksionon pikërisht Kuvendin, si mbikëqyrës të Qeverisë.

Madje, disa ministra edhe kur ju shtrohen pyetje parlamentare ose nuk marrin pjesë fare në seanca ose iu vjen shumë idhët, kur ne i pyesim. Këtu përfshihet edhe kryeministri.

Duhet t'ju kujtojmë se kjo ka qenë një nga vërejtjet kryesore të Raportit të Progresit, jo vetëm të vitit 2011, por edhe të viteve paraardhëse.

Problem tjetër mbetet mungesa e transparencës. Qeveria ende nuk e ka zgjedhur një zëdhënës, që është pengesë e madhe në punën e gazetarëve. Bile, ju kujtohet që kryeministri pat premtuar edhe këtu në seancën e Kuvendit, por në fakt, do të ishte çudi sikur ai ta mbante premtimin.

Në vend të kësaj, ministri i Drejtësisë në këtë raport, ka raportuar për një takim me asociacionin e gazetarëve në lidhje me nenin 37 të Kodit Penal, që është një mashtrim, pasi në fakt, është pikërisht Ministria e Drejtësisë që e ka sjellë Kodin Penal në Kuvend me dy nene shumë të dëmshme për lirinë e mediave dhe kërkesat e gazetarëve nuk janë marrë parasysh gjatë kohës, kur Ministria e ka hartuar Ligjin.

Në fakt, e konsideroj shumë fëmijërore tentativën e tij për t'i marrë meritat e dikujt tjetër, pasi fshirja e nenit 37, siç do ta shihni nesër është meritë e dikujt tjetër.

Ligji për qasje në dokumente zyrtare nuk po gjen zbatim dhe po pengohet dukshëm nga zyrtarët. Lexoni raportime të ndryshme në media dhe do të shihni se me çfarë vështirësish ndeshen gazetarët në rast se kërkojnë dokumente nga institucionet. Pothuajse në asnjë rast ata nuk marrin dokumente, duke pasur parasysh që është ligji në fuqi. E të mos flasim pastaj për qytetarët të cilët madje, as që janë të informuar për këtë të drejtë. Dhe, informimi për të drejtën e qasjes në dokumente zyrtare është pikërisht detyrë e Qeverisë.

Problem tjetër, i cili është evidentuar në raport, është çështja e Avokatit të Popullit, i cili ashtu sikurse vjet edhe këtë vit vazhdon të mbetet i pambështetur as nga Kuvendi dhe as nga Qeveria. Në fakt duket se është fare e qartë që askujt nuk i intereson që të forcohet ky institucion i pavarur dhe mund të themi që pavarësia e institucioneve të pavarura kanë probleme madhore për të qenë të pavarura, sepse në përgjithësi ato janë të kontrolluara nga një politikë “makiaveliste”, që synon mbajtjen e pushtetit me të gjitha mjetet, të ligjshme dhe të paligjshme.

Sa për luftën ndaj korrupsionit, tashmë kemi hyrë në një fazë cinike. Ju kujtohet task-forca antikorruption, e proklamuar me shumë pompozitet nga ana e kryeministrit, ndërsa njeriu i emëruar në krye të saj u arrestua për korrupsion dhe shantazhe. Qeveria e Kosovës ka tentuar ta heq nga vetja fajin, por ajo harron se ka kontroll politikë mbi gjyqtarë e prokurorë dhe struktura që i emërojnë ato. Mbase, kjo është ajo pjesa e strategjisë antikorruption, që në të vërtetë më shumë synon ta dobësojë sistemin e drejtësisë, në mënyrë që vetë të dalë mbi ligjin, pikërisht siç po bën çdo ditë.

Në këtë raport, të cilin e kemi para vetes thuhet, që ende mbeten për t'u realizuar çështje që kanë të bëjnë mbrojtjen e konsumatorit, të papunësisë, funksionalizimin e inspektoratit të punës, skemat e asistencës dhe shërbimeve sociale, shëndetësia dhe sigurimet

shoqërore. Në fakt, këto janë probleme shumë të mprehta sociale, në të cilat është vënë dorë fare pak nga ana e institucioneve.

Ka pasur disa ligje të cilat janë miratuar këtu në Kuvendin e Kosovës, mirëpo implementimi i tyre duket se nuk është as qëllim dhe as në vëmendje të Qeverisë.

Por, ka edhe më keq! Këto institucione, si për shembull, Inspektorati i punës, shpesh përdoret për qëllime politike, vënë në shënjestër kompani që nuk janë të lidhura me pushtetin apo biznese të vogla, të cilat mezi e sigurojnë bukën e gojës.

Në lagjen “Dardania”, për shembull, ku banoj unë, ka disa biznese të vogla, të cilat janë gjobitur në mënyrë marramendëse, në s’përputhje të plotë me vlerën e bizneseve të tyre.

Mirëpo, ky nuk është rasti me kompani të mëdha, pasi kur vjen puna tek ato, ato favorizohen dhe paraqiten në mënyrë shumë pozitive.

Rasti i “Feronikelit”, ku të drejtat e punëtorëve shkelen në mënyrë flagrante, ku punojnë në kushte të ndotjes së skajshme dhe ku filtrat e pastrimit mbahen aty dhe nuk përdoren, është një nga më skandalozet.

Po kështu, keqtrajtimi çnjerëzor, që iu bëhet punëtorëve që po ndërtojnë “Autostradën e Kombit”, siç e quan kryeministri, janë shembull i skllavërisë moderne.

Sa i përket ekspertizës, që është një nga vërejtjet kryesore të Raportit të Progresit, dhe i nevojitet Kuvendit, në lidhje me shqyrtimin e ligjeve, gjendja vazhdon të mbetet e njëjtë me disa ndryshime të vogla. Ka pasur disa punësime të vogla, por ndërkohë që Qeveria e Kosovës shpenzon milionë euro për ekspertë të huaj, ne ende nuk kemi ekspertë vendorë për të miratuar ligje dhe prandaj miratojmë ato shkelë e shko dhe të njëjtat ligje riciklohen në Kuvend.

Sa për çështje të sigurisë, nuk dua të ndalem, sepse kemi folur shumë këto ditë e fundit dhe është fare e qartë se në çfarë niveli të sigurisë është Kosova. Vlerësimi im është se progresi i arritur është mjaft i limituar dhe shumë formal, ndërkohë që problemet mbeten të mëdha në të gjitha fushat e jetës.

Sa i përket procesit të integritetit të Kosovës, gjendja vazhdon të mbetet e njëjtë. Është premtuar fillimi i studimit të fizibilitetit, mirëpo asnjë hap konkret nuk ka deri tani dhe asnjë garanci se do të tejkalohet ngërçi i pesësishës së BE-së, që nuk e njeh pavarësinë e Kosovës.

Ndërkohë, qytetarët e Kosovës vazhdojnë të mbeten më të izoluarit në Rajon, pasi procesi i liberalizimit të vizave, jo vetëm që nuk u bë realitet, ashtu siç ishte premtuar, por madje as që duket në horizont.

Përfundimisht, ne do ta miratojmë raportin, jo pse e miratojmë faktin që nuk janë ndërmarrë veprimet nga ana e Qeverisë dhe institucioneve të ndryshme, por për mënyrën se si është raportuar ky raport.

Shpresojmë që në raportin e ardhshëm të ndërmerren veprime të tjera, të cilat do ta përmirësojnë disi Raportin e Progresit, që pritet të dalë në tetor dhe të mos dalë i nxirë, ashtu siç ka dalë vitin e kaluar. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Gjini, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës!

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti nënkryetar!

Mendoj se edhe Raporti edhe debati tregojnë se Kosova nuk e ka marrë me të vërtetë, seriozisht procesin e integrimit evropian. Nuk po flas për fjalët e deputetëve, por po flas për seriozitetin.

Mendoj se po shihet qartë që në Kosovë të gjithë e dinë që jemi goxha shumë larg dhe të gjitha që po ndodhin, po ndodhin sa për sy e faqe. Aq më tepër, domethënë po provojmë edhe me i shitë si progres disa çështje të implementueme të cilat janë fundi i fundit gjysmë implementime të kushteve drejtë integrimit.

Për çdo vit jemi duke u marrë me progresin drejtë Unionit Evropian, për çdo vit me plan të veprimit, qoftë të Kuvendit, qoftë të Qeverisë. Dhe për çdo vit, në agjendë i kemi të gjitha sfidat që dalin prej Raportit të Progresit, në thonjëza po themi, do të thotë, “të gjitha në pjatën tonë” ose në menynë tonë e kemi totalin e asaj që shkruhet në Raport të Progresit për gjendjen në Kosovë.

Vetë fakti se në për çdo vit e kemi totalin në agjendë ose “në pjatë”, siç e thash më përpara, tregon se nuk ka seriozitet. Serioziteti kishte me qenë evident nëse edhe Kuvendi edhe Qeveria kishin me pas një studim serioz të mundësive të veta dhe të kërkesave në të njëjtën kohë dhe të kishin vendosë se çka është e nevojshme që të implementohet për çdo vit dhe të ketë një plan, shembull ta marrim, pesëvjeçar ose dhjetëvjeçar, pavarësisht për sa, në mënyrë që ne të jemi të qartë me vetveten se çka po implementojmë dhe ku duhet të arrijmë.

Dhe, në të njëjtën kohë, dua t’ju them se Aleanca mendon që ky rezultat është si pasojë e mungesës së angazhimit dhe mungesës së të menduarit serioz për integritime evropiane.

Edhe njëherë po ju them, është tepër evidente - e dhimbshme por, tepër evidente se askush, ama bash askush nuk e ke marr tepër seriozisht, me ndonjë përjashtim, pa dashtë me bo me gisht. Dhe, kur askush nuk e ka marrë me seriozitet, atëherë arrijmë deri në pikë që me akuzua njerëz të tillë. Ose e akuzojmë një ministër të caktuar ose një komision të caktuar. Për shkak se na duket se një ministër ose një komision e integron Kosovën në Unionin Evropian. Që, definitivisht dhe absolutisht e pavërtetë dhe është e padrejtë me drejtu gisht, nëse si total, si tërësi e institucioneve nuk po tregojmë seriozitet në këtë drejtim.

Shembull ta marrim, për ne më me rëndësi është Ligji për duhanin, shembull ta marrim, se vijat e asfaltit, të cilat po fshihen. Shihni në Autostradën e Kombit, asnjë vit nuk u bë që o lëshua, janë fshi. Po ju them me kompetencë, i kam pa vet, janë fshi.

Domethënë, krejt ato që janë praktike, e që kanë të bëjnë me integrim në Unionin Evropian, dikujt mundet me iu duk qesharake por po ju premtoj, pa dashtë me i atribue vetes shkollim ose diçka tjetër: integrimi në Unionin Evropian ka me përfundu edhe deri te vijat e asfaltit. E ndoshta ato vijat e asfaltit sot është më mirë me i bë në rregull, që nuk fshihen për nja 7-8 vjet, se me ba Ligj të duhanit, që edhe ne vetë e dimë që nuk implementohet, shembull ta marrim!

Ose, ose, me festue ditë të Evropës, që s'e feston kurrkush në rruzull tokësor, e në të njëjtën kohë me na pikë tualetet në spital, pra në procesin tonë drejt integritimit në Unionin Evropian.

Ne mendojmë se edhe Qeveria e Kosovës edhe Kuvendi duhet të fillojnë t'i qasen seriozisht këtij problemi. Jo vetëm një ministër, jo vetëm një komision, por të fillojmë të mendojmë si tërësi për me iu qas me seriozitet integritimit në Unionin Evropian duke konstatua fuqishëm se nuk jemi duke e marrë seriozisht këtë proces fare. Po na duket si i largët, si i huaj, si diçka që duhet me bo sa për sy e faqe për me na dal Raporti i Progresit i mirë. Se kur po na del i keq, atëherë po duhemi me u sha në mes vete. Do me thënë, krejt çka po bëjmë është për me na dalë Raporti i Progresit i mirë, e jo esencialisht me bë diçka për me e afër Kosovën drejtë Unionit Evropian.

Kështu që, duhet të fillohet që planet e veprimit të mos jenë plane të cilat derivojnë totalisht prej sfidave që dalin nga raporti por të jenë plane të menduara mirë, për ato që janë të mundshme me u implementu brenda një viti dhe ato që ne i fusim si pika për implementim të implementohen seriozisht. Pra, të mos jenë gjysmë të implementueme, të mos jenë pika, që sot implementohen, mirëpo kur vjen një raport i progresit një vit ose dy vite më vonë, prapë i nxjerr si sfida të implementimit të çfarëdo elementi, i cili del prej Raportit të Progresit.

Edhe një herë mendoj se mungon procesi i të menduarit, mendoj se mungon një qasje e vërtetë e totalit të institucioneve drejtë integritimit evropian dhe mendoj se ndoshta është koha me fillue tani. Pra, është koha me fillu me mendu tani se si me iu qas me të vërtetë këtij problemi. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, kryetarja e grupit Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, zotëri nënkryetar!

Përshëndetje për dy ministrat!

Përshëndetje për të gjithë deputetët!

Duke marrë parasysh se Raporti i parë i punës së zbatimit të Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritime evropiane për vitin 2012, është plan në të cilin duhet të angazhohet edhe Kuvendi, edhe Qeveria, edhe organizatat joqeveritare dhe të gjithë

qytetarët e Kosovës për arsye se raporti përfundimtar do të vjen dhe do ta sjellë notën a pozitive, a negative - do ta sjellë për gjithë Kosovën.

Pra, të shpresojmë, që në të ardhmen raporti të jetë më i mirë. Mirëpo në këtë raport të bëhen disa përmirësime, që kur të vijë Raporti i Progresit. Unë, do ta kisha përkrahur edhe parafolësin, zotëri Ardian Gjinin, që të mos kemi fyerje në mes Kuvendit dhe Qeverisë, por të kemi një vlerësim pozitiv për Raportin e Progresit.

Koalicioni për Kosovë të Re e përkrahë Raportin për zbatimin e Planit të veprimit të Kuvendit për integritet evropian, mirëpo të bëhen disa ndryshime. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Ju falemnderit! SLS-ja? Nuk ka të paraqitur! “6+”-i? Zoti Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Falemnderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po shihet se sipas këtij raporti dhe sipas asaj që thanë kolegët e mi të nderuar e që unë nuk do t’i përsëris, ka përparime dhe suksese, mirëpo ka edhe sfida dhe mjaft punë për t’u bërë.

Mirëpo, besoj se me angazhim të gjithë kryetarëve të komisioneve, të ministrave dhe Qeverisë, besoj se secili do ta japë kontributin e tij maksimal, në mënyrë që Raporti i ardhshëm i Progresit të jetë sa më pozitiv për Kosovën. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Radha është e deputetëve. Zoti Vehapi e ka fjalën!

IDRIZ VEHAPI: Falemnderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Unë do të flas në emër të Komisionit funksional dhe ajo që është përfshirë në Raport, mungojnë dëgjimet publike, të cilat i ka realizuar Komisioni funksional me 4 ministratë përgjegjëse dhe dua të ju kujtoj që këto dëgjime publike me tri ministratë janë mbajtur me datën 12.3.2012, ndërkaq ministri i Ministrisë së Arsimit ka raportuar më datën 19.3.2012.

Prandaj, ne ia kemi dërguar Komisionit për Integritet Raportin nga Komisioni funksional me datën 20.03.2012 dhe kërkoj që në këtë raportin gjithëpërfshirës për tremujorin e parë të këtij viti, sa i përket sfidave të dala nga Raporti i Progresit, për çka Komisioni Funksional i ka kryer këto dëgjime publike, të futen në Raportin gjithëpërfshirës për këtë tremujor. Falemnderit shumë!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputeti Neziraj!

XHEVDET NEZIRAJ: Falemnderit!

Pasi që ministresha e Integritetve Evropiane gjendet diku duke i dëgjuar bisedat e deputetëve, unë do të ndalem te integriteti i komuniteteve, që do të jetë sfidë edhe kthimi i tyre.

Unë dua të them se Komisioni për Komunitete, Këshilli konsultativ për komunitete, zyrat lokale për komunitete dhe shumë mekanizma, do të thotë, shumë mekanizma që janë për mbrojtjen dhe integrimin e komuniteteve, lirisht mund të them që janë sterile dhe nuk janë duke e kryer detyrën e vet.

Dhe, mendoj që, nëse Qeveria e komisionet nuk angazhohen prapë raporti për integrimin e komuniteteve dhe njerëzit e kthyer, do të jetë steril dhe do të jetë shterpë.

Unë dëshiroj që Qeveria duhet t'i përvjelë mëngët dhe mos t'i pret këta mekanizma, të cilat janë prodhuar mekanizma të cilat nuk janë duke funksionuar dhe lirisht mund të them se është bërë edhe një centralizim nga niveli qendror në ato nivele lokale.

Zyrat për komunitete nuk kanë kapacitete as njerëzore, as financiare me qëllim që të ballafaqohen me kthimin e qytetarëve, që po kthehen për çdo ditë. Dhe besoni që kemi probleme, ne si liderë të komuniteteve, për arsye se nuk është duke funksionuar kjo hallkë.

Nëse një person kthehet, nuk gjen shtëpi, nuk ka si t'i arsimojë fëmijët dhe do të ketë shumë probleme, për arsye se nuk ka mekanizëm në Kosovë i cili do të funksiononte shumë shpejtë. Prandaj, derisa të realizojë të drejtën dhe të merr një ndihmë, një familje që kthehet nga perëndimi dhe nga Evropa, do të kalojnë muaj të tërë dhe ai njeri mund të vdesë edhe nga uria deri sa të intervenojnë institucionet e shtetit. Prandaj, duhet të lehtësohet kjo gjë, me qëllim të integritetit të tyre më të shpejtë.

Unë besoj, që Komisioni për Komunitete dhe të gjitha këta mekanizma, që janë në Kuvendin e Kosovës, lirisht mund të them që janë duke i harxhuar mjete buxhetore pa nevojë për arsye se nuk janë duke kryer rolin e vet.

Ne kemi mekanizma më së shumti për mbrojtjen e komuniteteve, por kemi mekanizma që s'janë duke prodhuar sukses, prandaj duhet kjo të ndryshohet.

Një gjë tjetër që do ta kisha përmend, është strategjia për komunitetin rom, egjiptian dhe ashkali, që është një strategji në vete, që ka kaluar pa kaluar në Kuvend të Kosovës, ka kaluar në Qeveri. Shoqëria Civile dhe OSBE-ja dhe Bashkimi Evropian ia kanë shitë Qeverisë atë strategji dhe ajo strategji nuk mund të realizohet kurrë dhe atë strategji, unë si lider i komunitetit egjiptian e kam kundërshtuar, sepse nuk mund të realizohet, e Qeveria ka marrë një obligim që asnjëherë s'mund ta realizojë.

Prandaj, është mirë që strategjitë e tilla të shqyrtohen në Kuvend dhe të shqyrtohen me njerëz që e kanë votën e qytetarëve.

Nuk ka nevojë që komuniteti egjiptian, se s'ka probleme gjuhësore, pse të jetë një vërejtje e shumë njerëzve nga Evropa, që s'dinë të bëjnë dallim? Dhe, shpeshherë nëpër media shkruhet "komuniteti RAI", që unë e kundërshtoj, se ajo është antikushtetuese. Atë, po e

përdorin edhe mediat vend e pa vend. Dhe, është hy një “fusnotë”, prej shumë fusnotave, edhe ky “komuniteti RAI”.

Unë besoj, që Qeveria këtu duhet të jetë syçelë, me qëllim që raporti tjetër të jetë shumë më progresiv, të jetë shumë më përparimtar për Kosovën, duhet të ulet e të bisedohet në mënyrë shumë të qartë për të gjithë këta mekanizma, që s’janë duke funksionuar. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputeti Hyseni, e ka fjalën!

HYDAJET HYSENI: Falemnderit, zoti nënkryetar!

Zonja e zotërinj deputetë,

Më lejoni që duke ju përshëndetur ju të gjithëve, kësaj radhe ta përshëndes posaçërisht ministrin për Integritet Evropian dhe ta shquaj angazhimin e kësaj ministrie në një segment shumë të rëndësishëm për Kosovën, që e ka pasuruar edhe raportin dhe besoj se në fund do ta pasurojë edhe më shumë.

Unë besoj, që kjo nuk do të thotë që duhet të pajtohemi edhe me njëfarë prirje për ta reduktuar të gjithë angazhimin ndërkombëtar të Kosovës, angazhimin shtetëror të Kosovës vetëm në segmentin e integriteteve evropiane. Dhe, besoj që vetë ministria nuk do ta lejonte një prirje të tillë.

Mendoj se meriton komplimente edhe Raporti si i tillë. Është një raport i hartuar mirë dhe një qasje afirmative, të cilën duhet ta theksoj sidomos, duke pasur parasysh faktin që Komisioni që e ka hartuar këtë raport drejtohet nga opozita, e opozita është nganjëherë e prirë për një qasje nihiliste, e cila sidomos në këtë dimensionin me botën dhe me integritet evropian, si prioritet i yni i përbashkët - nuk kanë vend dhe nuk do të duhej të zinin vend.

U përmend këtu një prirje për ta bërë raportin sa më të mirë. Dhe, mendoj që edhe kur është e vërtetë, është e kuptueshme se është e motivuar pozitivisht. Është e pakuptueshme, sidomos prirja tjetër për ta bërë një raport sa më të zi, për të nxirë edhe imazhin e Kosovës, me një farë shprese absurde se ndoshta do të krijoheshin hapësira për përfitime politike.

Megjithatë, Raportit mund t’i bëhen vërejtje dhe unë do të theksoj ndonjë prej tyre.

Është theksuar edhe në debatin e mëparshëm, se do të duhej pasur më shumë kujdes në ndarjen proporcionale të angazhimeve dhe angazhimit të gjithë komisioneve. Nuk është çështja e integriteteve evropiane çështje, ekskluzivisht e Komisionit për integritet evropian dhe në njëfarë mënyre një përpjekje për t’i marginalizuar komisionet tjera. Vetëm me një qasje inkluzive, ne mund të dalim mirë e mbarë në këtë sfidë. Mendoj madje, jo vetëm si komisione, por edhe si grupe politike, edhe si komunitete etnike, e tjera.

Për shembull, Komisionit për Punë të Jashtme i janë lënë vetëm dy çështje, në të cilat do të kishte angazhim, madje ndonjë prej tyre edhe e kryer. Ta zëmë, ajo për përfaqësim rajonal, e tjera, kurse ka aq shumë punë, në të cilat Komisioni duhet ta gjejë vetveten dhe ne në Komision jemi marrë vesh, pavarësisht çka është shkruar në këtë plan të veprimit, megjithatë komisioni ta zgjerojë fushëveprimin e vet në përputhje me natyrën e fushëveprimit.

Është mirë, që është theksuar edhe rëndësia e diplomacisë parlamentare në të cilën është bërë pak, dhe e praktikës së binjakëzimit dhe njëfarë mentorimit në këtë proces, por mendoj që vendi i Komisionit për Punë të Jashtme këtu duhet jetë ai që është sipas praktikave parlamentare dhe ajo që do të dëshiroja ta theksoj, posaçërisht, do të duheshin krijuar edhe kushtet adekuate për një punë të tillë. Fakti që Komisioni për Punë të Jashtme, praktikisht nuk ka kurrfarë buxheti, stafi i tij mbështetës nuk ka as telefona me të cilët mund të komunikojë me partnerët ndërkombëtarë, madje as Shërbimi i protokollit te ne, nuk ka linjë të komunikimit ndërkombëtar, janë hendikepe që s' mund të justifikohen.

Është edhe një mangësi mendoj se do të duhej ritheksuar. Raportit i mungon qasja kritike, qasja e angazhuar. Në rregull që ne duhet të priremi nga një frymë kooperative dhe unë po dëshiroj të bëj një vërejtje, i bindur që anëtarët e Komisionit e drejtuesit e Komisionit, së paku do ta dëgjojnë. Po është fjala ndonjëherë edhe për anomalitë që i hasim në vetë Raportin e Progresit. Nga dëshira për të qenë shumë kooperativ dhe shumë fleksibil, mungon gatishmëria për t'u përballur edhe me konstatime të gabuara, të pabaza ndonjëherë edhe qëllimkëqija, ndonjëherë edhe të futura kontrabandë nga ata që s' ia duan të mirën Kosovës, ose nga ata që duan të përfitojnë nga ndonjë ndaj mbathje e një fenomeni që nuk ekziston në Kosovë, theksimit të ndonjë problemi që është kryer si punë e pakryer me qëllim që dikush të nxjerrë një projekt, por që mund edhe të ndodhë dikush të përfitojë nga këto, po imazhi i Kosovës dëmtohet shumë dhe procesi i integritetit të Kosovës në strukturat evropiane ngadalësohet ose vështirësohet.

Mendoj që Komisioni për Integritet Evropian duhet ta ketë edhe një angazhim, të angazhuar, kritik në këtë çështje. Veçanërisht si ilustrim do të përmendja kapitullin 2,3 në të cilën janë përfshirë çështjet rajonale dhe është vërtet një shembull i keq i qasjes, është tepër i njëanshëm, është tepër antishqiptar, është tepër antikosovar dhe vërtet është edhe si qasje profesionale krejt e pakuptueshme. Do të duhej ta thoshim, në mënyrë që edhe partnerët tanë të kenë kujdes ndonjëherë prej nga i marrin formulat të cilat pastaj na i servirin në raport dhe praktikisht na vënë në situatë të pamundshme.

Në këtë kapitull, Kosova nuk ka Kosova si të jetë kooperuese dhe të dalë mbarë, pa e ndryshuar qasjen që është një anomali. Për të mos u zgjatur mendoj se është mirë që janë theksuar edhe çështje si të pazgjidhura, çështje siç janë, ajo e menaxhimit të kufijve e tjera, por mendoj që në çështjet e tilla të hapura, do të duhej po ashtu një qasje e angazhuar. Kemi arsye për të angazhuar dhe për të shfrytëzuar përvojën e vendeve tjera. Unë dua të theksoj, veçanërisht, nuk mund ne ta injorojmë faktin që edhe në këtë proces punohet për marrëveshje, arrihen dofarë marrëveshjes, nuk informohemi ne sa duhet, thuhet që janë të atyre drejt të cilëve ne synojmë të ndikuara, të

influencuara ndonjëherë edhe të hartuara prej tyre, kurse praktikisht në praktikë nuk ka asgjë të mirë, përkundrazi imponohen praktika krejtësisht jo normale që pengojnë komunikimin e qytetarëve që kanë pasur komunikim të lirë. E kam fjalën veçanërisht te qytetarët e Luginës së Preshevës, të cilëve u është pamundësuar qarkullimi i lirë me komunat me të cilat janë të pashkëputur, kanë një pjesë të pronës andej, një pjesë të pronës këndeje, një pjesë të familjes andej, një pjesë të familjes këndeje, kurse në të vërtetë standardet janë të ndryshme edhe sa i përket përkatësisë etnike.

Si mund të justifikohen këto? Këto janë standardet evropiane... të cilat i synojmë? Pse nuk duhet ta kemi lirinë që këto çështje t'i themi hapur dhe t'i themi hapur madje edhe nëse drejtuesit e Komisionit nuk kanë gatishmërinë as që t'i dëgjojnë diskutimet... Ju faleminderit, shumë. I falënderoj edhe deputetët e Komisionit për vëmendjen e munguar.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Po flas në emër të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Komisioni për Shëndetësi posa e ka marrë planin e veprimit edhe detyrat dhe obligimet që janë paraparë nga plani i veprimit për Komisionin për Shëndetësi, e ka hartuar programin e punës. Mirëpo, po e shoh se sot në raport, është dal që në tremujorin e parë të bëhet monitorimi i Ligjit të Inspektoratit të Punës. Kërkoj që ky të hiqet sepse Ligji i Inspektoratit të Punës është monitoruar nga Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe ai ligj është votuar këtu në Parlamentin e Kosovës. Ndërsa, disa obligime të tjera që janë paraparë në tremujorin e parë të këtij viti, që janë obligimet e Komisionit për Shëndetësi, nuk kemi mundur t'i kryejmë edhe ato janë: Ligji për shëndetësi dhe Ligji për sigurimet shëndetësore. Kjo nuk është me fajin e Komisionit, por është me fajin e Qeverisë apo të Ministrisë së Shëndetësisë, sepse këto dy projektligje nuk janë sjell në Komision si dhe implementimin e legjislacionit për gjak, inde dhe qeliza. Janë këto projektligje të cilat nuk janë sjellë në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, për implementim. Falemnderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Safete Hadergjonaj

SAFETE HADERGJONAJ: Falemnderit, nënkryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, i ka bërë pjesë të planit të punës të gjitha çështjet të cilat janë ngritur nga Raporti i Progresit. Gjatë këtij tremujori, Komisioni për Buxhet ka mbajtur takim ku është raportuar apo është bërë një dëgjim publik me ministrin e Financave për çështje të cilat kanë qenë shqetësim të këtij raporti. Ne nuk kemi pasur ndonjë rast kur kemi ftuar ministrin e Financave, me të cilin më tepër jemi të ndërlidhur me punë dhe me mbikëqyrjen e punës së kësaj Ministrie, që ministri mos të jetë prezent në Komision. Domethënë çdo herë ka marrë pjesë në Komision, por njëkohësisht ka raportuar edhe me shkrim sa herë që ne kemi kërkuar që këto raporte të jenë në formën e shkruar.

Në këtë raport të cilin e ka paraqitur Komisioni për Integritet, janë paraqitur të gjitha të arriturat të cilat janë bërë në këtë sektor, por njëkohësisht janë paraqitur edhe hapa të cilat parashihen që të ndodhin në të ardhmen për përmirësimin e sfidave të cilat janë ngritur në Raportin e Progresit.

Nga raportimi të cilin e ka bërë ministri dhe nga aq mundësi sa kemi pasur të bëjmë në monitorimin në bazë të raporteve të cilat i janë dorëzuar këtij Komisioni, vërehen që në fushën e financave janë bërë përparime të dukshme deri me tash dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa është shumë i angazhuar që në të ardhmen t'i përcjellë të gjithë hapat të cilët janë paraparë nga Ministria për periudhën e ardhshme.

Dua të theksoj edhe një çështje, që e vërejta në raportin të cilin e ka paraqitur Komisioni për Integritet, tek pika 9, thuhet që: “Kuvendi duhet të vendos mekanizma më të fuqishëm për t'i mbikëqyrë shpenzimet buxhetore gjatë vitit financiar”

Tek veprimet e propozuara, thuhet se shqyrtimi i raporteve tremujore për nivelin e shpenzimeve të buxhetit si dhe miratimi dhe zbatimi i rekomandimeve për këto raporte dhe përcjellja e zbatimit të rekomandimeve. Ndoshta, Komisioni për Integritet Evropiane nuk e ka pasur informatën e duhur, sepse edhe ne si Komision, nuk e kemi dërguar duke menduar që këtë çështje, meqenëse janë edhe Kryesia e Kuvendit dhe sekretaria e Kuvendit që merren me këtë pikë që është ngritur në Raportin e Progresit, nuk e kemi paraqitur në raportin tonë dërguar këtij Komisioni, por unë dua të njoftoj Komisionin për Integritet Evropiane, se në Komisionin për Buxhet dhe Financa, shqyrtohet çdo raport tremujor i Kuvendi, i cili përgatitet nga stafi i administratës dhe dorëzohet në Komisionin për Buxhet. Komisioni për Buxhet i paraqet rekomandimet të cilat ia drejton Kryesisë së Kuvendit.

Dhe, një çështje tjetër të cilën e vërejtja tek Raporti të cilin e kemi në shqyrtim sot, është tek përmbledhja e të arriturave dhe sfidave gjatë periudhës raportuese, është në faqen 5, te paragrafi i tretë kur flitet për Ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës. Është e shënuar që është miratuar tashmë Ligji për Radiotelevizionin e Kosovës, mirëpo unë tek fjalë fundit në këtë paragraf thuhet se : “Qeveria e Kosovës, ndan një fond për mbështetje për media prej 5% nga momenti i ndërprerjes së parapagimit të RTK-së”.

Ndoshta, meqenëse është shënuar këtu që është miratuar Ligji për Radiotelevizionin e Kosovës, është mirë që ky paragraf, në këtë pikë të përmirësohet dhe të thuhet që, me miratimin e Ligjit të ri për Radiotelevizionin e Kosovës, është e paraparë që këtij mediumi t'i ndahen me Ligjin që është miratuar për Radiotelevizionin e Kosovës, është paraparë që 7% e të hyrave buxhetore duke përjashtuar të hyrat e njëhershme dhe të hyrat nga donacionet, të ndahen për Radiotelevizionin e Kosovës dhe në buxhetin e viti 2012, buxheti për Radiotelevizionin e Kosovës, është ndarë në shumën prej 7% nga të hyrat buxhetore. Prandaj këtu është mirë ndoshta të përmirësohet dhe të mos të shkojnë me këto çështje dhe tek pika e 9-të, të mos krijohet përshtypja se Kuvendi apo Komisioni nuk i shqyrton raportet tremujore të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sepse ato vijnë raporte shumë të detalizuara dhe është mirë të shënohet. Falemnderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Edhe ju kryetarët e komisioneve e keni pasur radhën kur të diskutoni, jo pas deputetëve, në emër të komisioneve, për t'u nxitur nga diskutimet. Përgatituni në kohë dhe diskutoni, diskutoni për komisionet kur e keni radhën, jo mbas kohe. Deputeti Pajaziti e ka fjalën, si deputet e jo si Komision.

ZENUN PAJAZITI: Falemnderit, zoti kryesues!

Ajo që dëshiroj unë të shtoj në këtë kohë që nuk është me vëmendje prej më të mirave si mund të jetë, sepse jemi shumë vonë, unë po e kam parasysh edhe kohën e deputetëve, ajo që dëshiroj të them unë, është lidhet konkretisht me formatin e raportit. Nuk është më duket korrekte krejt sot të flasim këtu për krejt Raportin e Progresit. Ne e kemi fjalën veç për raportin e një periudhe të punës së Kuvendit, presa i përket planit të veprimit të cilin plan ne e kemi aprovuar këtu dhe e dimë saktësisht se çka përmban ai plan.

Unë kam qenë edhe në një prej herëve të kaluara, kam propozuar që përveç kësaj formës tabelare të raportimit për punën e Kuvendit, për sa i përket implementimit të Planit të veprimit të partneritetit evropian, është një plan i cili nuk e kemi shpikur ne, ka vite me radhë prej se ekziston kjo agjendë në Kosovë që raportohet kështu. Unë kam propozuar që të jetë edhe një pjesë si të thuash hyrëse dhe është shumë mirë që Komisioni tani më e ka bërë një format tjetër. Ajo që nuk është mirë mendoj, tash është se në kuadër të kësaj pjese hyrëse, ka edhe çështje që janë shpjeguese dhe me asnjë prej kriterëve nuk mund të themi që njëra çështje është më shpjeguese se duhet jetë si një çështje tjetër, për më tepër kur disa prej çështjeve janë jashtëzakonisht... janë çështje e kompetencave të ekzekutivit, pra duhet të raportojë edhe të njëjtin raportim duhet ta bëjë Qeveria ose dikasteret e Qeverisë në Komisionin Evropian. Është për shembull punësimi i 29 zyrtarëve në një prej departamenteve të Policisë, është çështje ekskluzivisht që është e raportimit, ani pse ka raportuar Ministria e Brendshme në njërin prej takimeve në Komisionin për Integritet Evropian.

Unë mendoj që duhet të fokusohemi në çështje që janë shumë më konkrete dhe të ketë rekomandime. Cilat sfida të Kuvendit janë si të thuash sfidat që nuk ka kapacitete ose cilat janë pengesa pse këto sfida nuk mund të tejkalohen dhe të gjinden, debati të orientohet aty? Cilat kapacitete duhet të ndërtohen për tejkalimin e këtyre sfidave ose realizimin e atyre aktiviteteve. Po ashtu, unë mendoj se duhet të ishte mirë të theksoj, pat edhe këtu që thanë, nuk është vetëm një prej Komisionit që është, Komisioni për Integritet e ka punën më të madhe është facilitator i këtij procesi, por duhet të shohim a ka bashkëpunim të komisioneve tjera, a ka kapacitete në komisionet tjera, a ka agjendë të mjaftueshme të Kryesisë së Kuvendit për t'i futur në koordinim të gjitha këto aspekte e tjerë, në mënyrë që të tejkalohen këto sfida që janë vetëm të Kuvendit të Kosovës.

Dhe, një çështje tjetër që duhet ta përmend, për sa i përket zbatimit, mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit ose të funksionimit të institucioneve, duhet ta theksojmë që në raportin e fundit është theksuar progres për sa i përket monitorimit të zbatimit të ligjit, por monitorimi i zbatimit të ligjit nuk do të thotë se ne duhet të merremi edhe me menaxhimin ditor të institucioneve të ekzekutivit apo të agjencive të ndryshme të

zbatim të ligjit, por kështu edhe kjo agjendë duhet të përcillet edhe me një, si të thuash, me një ide ose një raport se cilat prej kapaciteteve duhet t'i ndërtojë Kuvendi për të arritur ta mbikëqyrë ose monitoruar zbatimin e plotë të ligjit? Ju falemnderit!

KRYESUESI: Ju falemnderit!

Ju kisha lutur mos u paraqitni më.

E fundit është Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Falemnderit, kryesues!

Unë nuk do të zgjasë shumë, vetëm desha kolegen time nga Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, ta plotësoj, sepse në raport thuhet se Ligji për shërbime sociale dhe familjare nuk ka kaluar, ndërsa Komisioni ka punuar dhe ky Kuvend e ka miratuar të njëjtin ligj, kështu që konsideroj që nuk janë përfshirë të gjitha të arriturat e komisioneve në Raportin e Ministrisë të Tregtisë dhe Industrisë.

KRYESUESI: Falemnderit! I fundit, zoti Haziri e ka fjalën!

LUTFI HAZIRI: Falemnderit, zoti nënkryetar!

Për ta përmbyllur, më lejoni të mbes borxh që ta them edhe një herë, raportuesja e rregullt në Komision në çdo tre muaj, është ministrja Çitaku. Është e vetmja ministre, që mbi bazë të rregullta edhe me shkrim edhe me paraqitjen e saj para Komisionit edhe me gojë, del dhe arsyeton, kërkon ose ndërmerr veprime që kanë të bëjnë duke e njohur rolin e Komisionit Parlamentar, ndërsa ministrat tjerë ftohen sipas nevojës. Unë i përmenda disa nga komisionet, i kam mbetur borxh Komisionit për Arsim, është Komisioni më i rregullt në realizimin e agjendës që del nga Plani i veprimit, ndërsa si përgjigje ndaj asaj që e tha Zenuni, është që plani jonë i veprimit pikë për pikë, rresht për rresht del edhe ndërtohet nga Raporti i Progresit, sepse ai dokument tregon qartë ku është Kosova dhe ne veprimet i ndërmarrim sipas atij dokumenti.

E fundit që dua ta arsyetoj është që, atë që e tha zoti Hyseni, për veprimin që është realizuar. Unë nuk mund të konstatoj, sepse unë e kam marr një letër nga zëvendëskryeministrja si çdo deputet tjetër e cila na njofton për arritjet në përfaqësim rajonal, por sipas detyrës, në plan të veprimit është Komisioni për Marrëdhënie me Jashtë, ai i cili e konstaton realizimin e këtij veprimi apo jo, kështu që Komisioni duhet raportuar. Më 15 mars, ka qenë kërkesa zyrtare që kryetarët e komisioneve të raportojnë progresin, arritjet apo mosarritjet në Planin e veprimit, por e njëjta letër i është drejtuar të gjithë ministrave për t' i njoftuar se sa i kanë realizuar detyrat e veta. Reagimet kanë qenë dhe kanë qenë shumë të vogla dhe unë i mirëkuptoj kolegët kur tash vinë dhe thonë jo është realizuar kjo, por është fakt që tash, sot debatohet duhet paraqitur, por sekretaritë e tyre mbështese, do duhej për ia përcjellë në mënyrë më të rregullt dhe me e paraqitur dhe me raportuar te Komisioni me kohë veprimin edhe kur nuk ndërmerret, a ka veprime që nuk janë ndërmarrë, duhet të thuhet që nuk është ndërmarrë, dhe duhet ditur pse nuk është ndërmarrë sepse, nëse një komision do ta ftoj X ministrin të raportojë ose të shkojë ta monitorojë X veprimin, do të duhej ta bëjnë ata, nuk duhet pritur kurrkush për t' i thënë shko bëje se e ka detyrë primare, duhet realizuar.

Për tremujorin e dytë, prej tash kryetarët e komisioneve duhet ta dinë që 15 ditë pa u mbyllur tremujori i bie që ata duhet raportuar gjendjen për Planin e veprimt, a dokumentin e ka secili deputet, le t'u thonë njerëzve të tyre, le të merren edhe ata le ta koordinojnë punën ma mirë në këtë drejtim.

KRYESUESI: Falemnderit! Atëherë na mbetet votimi.

Lus regjinë dhe deputetë të përgatiten për votim.

Në sallë janë 65 deputetë.

Votojmë, tash.

Konstatohet se me 62 vota për, 3 abstenime, asnjë kundër, Kuvendi miratoi raportin për tremujorin e parë të vitit 2012, për zbatimin e Planit të veprimt të Kuvendit të Kosovës për Integritim Evropian.

Pika e shtatë e rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës për vitin 2011

Raportin vjetor të Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës për vitin 2011 e ka shqyrtuar Komisioni funksional dhe Kuvendit ia rekomanduar për miratim. Gjithashtu edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës, për vitin 2011 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri, zotin Pajazit për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Falemnderit, zoti kryesues!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e ka trajtuar këtë raport edhe pse Autoriteti i Konkurrencës konsiderohet ndër institucionet, agjencionet më të reja, ka pasur edhe sfidat e veta, Komisioni ka trajtuar një varg çështjesh që kanë të bëjnë edhe me funksionalitetin e këtij institucioni.

Komisioni ka aprovuar raportin dhe i rekomandon Kuvendit që ta aprovojë po ashtu.

KRYESUESI: Falemnderit! Komisioni për Buxhet dhe Financa, deputetja Hadergjona.

SAFETE HADERGJONAJ: Falemnderit, nënkryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2012, shqyrtoi raportin financiar të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2011 dhe vlerësoj se raporti i përmbush kushtet ligjore të parapara në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Agjensionit Kosovar i Konkurrencës, me Ligjin për buxhetin, i janë ndarë 240 mijë e 298 euro nga të cilat janë shpenzuar 195 mijë e 692 euro, çka do të thotë se janë shpenzuar 81% e mjeteve të planifikuara buxhetore.

Në kategorinë paga dhe mëditje, janë shpenzuar 90 mijë e 806 euro, apo 82% mjeteve të planifikuara me buxhet.

Në kategorinë mallra dhe shërbime, janë shpenzuar 101 mijë e 915 euro apo 93% e buxhetit. Vetëm për nënkategorinë e shpenzimeve të udhëtimit janë shpenzuar 56 mijë e 784 euro, kurse për derivate dhe lëndë djegëse 20 mijë e 54 euro.

Mjetet prej 17 mijë e 517 euro për shpenzime kapitale nuk janë shpenzuar fare. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin financiar dhe ka kërkuar nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës të dërgojë informata shtesë lidhur me planifikimet buxhetore, shpenzimet e buxhetit për secilën kategori dhe nënkategori ekonomike, të jepen të dhëna më të detalizuara për shpenzimet e udhëtimit dhe për shpenzimet e karburanteve të cilat informata janë ofruar dhe është sqaruar se arseja e shpenzimeve të udhëtimit më të larta jashtë vendit, është rezultat i nevojës për raportim lidhur me sfidat e Raportit të Progresit për pjesëmarrje në trajnimet e caktuara.

Ndërkaq, shpenzimet e karburantit kanë ndodhur si rezultat i vizitave dhe monitorimeve në terren.

Pas sqarimeve të ofruara nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, Komisioni ka vlerësuar se raporti i përmbush kushtet ligjore për raportim dhe e ka miratuar atë, me sugjerimet që raportet e ardhshme të jenë më të detalizuara, me specifikime të caktuara për kategoritë dhe nënkategoritë ekonomike, megjithatë Komisioni i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë këtë raport. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zonja Sala Berisha - Shala.

SALA BERISHA- SHALA: Falemnderit, kryesues!

Përshëndetje ministre e Integrimeve dhe ministër i Transportit, Kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin e Autoritetit të Konkurrencës. Ne e mbështesim në parim. Është viti i tretë që ekziston ky institucion, ballafaqohet me sfidat e ndryshme siç është mungesa e zyrave. Ne kemi marrë parasysh si Komision Parlamentar, e kemi shqyrtuar edhe si Grup Parlamentar dhe e mbështesim këtë raport.

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Hashim Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: I nderuar, nënkryetar,

Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,
Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar raportin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe do t'i paraqesë disa vërejtje lidhur me këtë raport.

Raportin që sot e kemi për shqyrtim edhe më shumë po më bind për punën joprofesionale që po e bën Autoriteti Kosovar i Konkurrencës. Kjo tregon se nuk i kanë marrë seriozisht vërejtjet që i kemi bërë në raportin e vjetëm. Po ashtu më duhet të shfaqë brengen se qasja që ka ai ndaj disa degëve të sektorëve ekonomik, mund të jetë shkatërruese për disa industri, përkatësisht që në vend të konkurrencës, ne treg të instalojë lojën e pandershme.

Kjo nuk është për befasi, me qenë se ky autoritet nuk e ka të qartë se çfarë pune bën dhe çfarë kompetenca ka. Po përmend, vetëm në faqen 8 ku do vetë konstaton se, edhe atë e citoj: Problem në vete paraqet edhe vetë të kuptuarit e punës së konkurrencës, qoftë nga ana jonë institucionet apo bizneset.

Vërtetë është për brengosje, nëse AKK-ja nuk e kupton punën e konkurrencës. Më tutje, po në këtë faqe, si sfidë përmendi edhe po citoj: përkrahen institucionet e pamjaftueshme si edhe ruajtja e pavarësisë vetë AKK-së. AKK-ja konstaton se nuk ka përkrahje të mjaftueshme nga asnjë institucion e që nuk është e vërtetë me qenë së pari ne si Komision, por edhe Kuvendi i Kosovës i ka dhënë përkrahje të plotë, por me kërkesë që t'i evitojë mangësitë. Nëse është e kundërta, atëherë AKK-ja të tregojë, të sjellë dëshmi konkrete se cilat institucione nuk po japin përkrahje dhe po e rrezikojnë pavarësinë e tij.

Janë edhe disa çështje tjera që sjellin në dyshim efikasitetin dhe efektet e punës së AKK-së. Ende nuk janë nënshkruar një numër i madh i udhëzimeve administrative dhe i akteve nënligjore, ndonëse ato janë të gatshme. Bordi është i cunguar meqenëse dy anëtarëve u ka skaduar mandati dhe punon vetëm me 3 anëtarë. Sado që e ka shumicën për vendosje, ai nuk është i plotë dhe me nga një të punësuar, funksionojnë Departamenti Mbikëqyrjes së Tregut, që ka tre sektorë dhe Departamenti Juridik dhe i procedurave me dy sektorë.

A thua, sa mund të jenë efikase dhe sa mund të bëjnë punë të besueshme këto dy departamente kur dy punëtorë mbulojnë 5 sektorë? E vërtetë kjo është e pakuptueshme.

Tash po ndalem në punën konkrete, përkatësisht në vendimet dhe rekomandimet që gjatë vitit ka marrë AKK-ja. Vendimi lidhur me policat e sigurimit kufitar TPL, në raport, në faqen 19 nuk ka ndonjë risi në krahasim me raportin e vitit 2010. Sërish AKK-ja përsërit dyshimet e disa veprimeve të kompanive të sigurimit, bien ndesh me ligjin, por me cilin ligj nuk e thotë. Ndërkaq, ai nuk mund të thotë këtë se dyshimet dhe hetimet që bëhen, ai bie ndesh me ligjin e Bankës Qendrore dhe rregullat që i ka caktuar Banka Qendrore e Kosovës.

Në këtë po i përmend edhe rekomandimet për bankat komerciale në faqen 21. Ko është kaptina më jo serioze dhe jo më profesionale e punës së AKK-së. Madje, a elemente edhe për punën jokompetente edhe për qasje diskriminuese ndaj bankave komerciale me kapital të huaj. Po përmend një nga një, në faqen 23 thuhet, citoj: “Kapitali i bankave ekzistuese dominohet nga kapitali i menaxhuar nga të huajt”. Ndihet nevoja që të bëhet rritja e bankave të reja dhe shtrirja e tyre e tyre në tërë vendin; duhet të bëhet liberalizimi i tregut bankar përmes licencimit të bankave të reja, përkatësisht duhet të rritet numri i bankave që operojnë në Kosovë.

Ky konstatim me shtyn të pyes se a është puna e AKK-së që të dirigjojë me kompetencat e Bankës Qendrore dhe në mënyrë indirekte për problemet që në tregun bankar t’i fajësojë bankat me kapital të huaj? Por se sa duhet të jetë numri i bankave komerciale, ashtu edhe të bëhet liberalizimi i tregut. Sipas AKK-së, a nuk mjaftojnë 8? Po ashtu kur AKK-ja e bën kërkesë, nuk i ka i ka paraqitur kapacitetet e tregut dhe lirinë që kanë bankat për të hyrë në këtë treg apo jo.

Në faqen 23, citoj: “mëgjithë rënien e shkallës së përqendrimit të depozitave të ProCredit bankës dhe Raifaisen bankës, ato detyrojnë rreth 68% të tregut”, do të ishte me interes të analizoheshin normat e interesit që ofrohen për depozitat e ultë dhe interesin në kreditë me përqindje të lartë. Vlerësimin e tyre si një strategji i menaxhimit të likuiditetit apo abuzimit.

Këtë konstatim e nxjerr AKK-ja si në pozitat e dyshimta dhe jashtë kompetencës që e ka. Ai nuk guxon të merret me dy bankat e mëdha, madje as t’ua përmend emrin si bartës i dyshimit për abuzim. AKK-ja me këtë qasje, manifeston urrejtje edhe ndaj bankave me kapital të huaj, ndonëse Kushtetuta e Kosovës dhe të gjitha ligjet në mënyrë të barabartë, i trajtojnë të gjitha kompanitë, pa marr parasysh prejardhjen e kapitalit. Po ashtu nocionet, interes i ulët, depozitat dhe interes i lartë kredi, janë jo profesionale, me qenë se bëhet fjalë për kamatat aktive dhe kamatat pasive dhe nëse është me interes të analizohen këto norma, atëherë këtë duhet ta bëjë AKK-ja para se të dalë me vlerësimet e këtilla.

Në faqen 24, citoj: “Mungesa e Ligjit të letrave me vlerë si dhe nxjerrja e tij” do të duhej të bëhet menjëherë në mënyrë që të hapet rruga për funksionimin e tregut të letrave me vlerë, me çka do të rritet hapësira për investimet kapitale.

Dhe, në fund dua të përmend dy- tri fjalë për prioritetet e punës për vitin 2012. Punët nuk janë të konkretizuara, ndonëse raporti që kemi në shqyrtim, lë shumë gjëra të hapura, të cilat një ditë duhet të mbyllën apo pas monitorimit të kenë vlerësimin meritë.

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së, propozon që në punën e AKK-së të përfshihet edhe tregu i energjisë elektrike, përkatësisht vendimi i Qeverisë që termocentrali “Kosova B” të futet në pakon e termocentralit “Kosova e Re”. A do të krijojë një monopol në treg, është me rëndësi kjo përgjigje posaçërisht pas dyshimeve që po ngritën nga shoqëria civile? Tjetër, të vlerësohet se a ka monopol në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, pas dhënies koncesioni në një konzerciumi privat.

Grupi Parlamentar i LDK-së, me gjithë vërejtjet që i ka në këtë raport, e mbështet këtë raport. Falemnderit!

KRYESUESI: Ju falemnderit! Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”, deputeti Ymeri.

VISAR YMERI: Falemnderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Po tentoj të jem më i shkurtër, me qenë se shumë çka që e pata ndërmend me e ngritë këtu, u thanë tashmë nga deputeti Hashim Deshishku. Natyrisht, kur lexohet ky raport, të krijohet një lloj përshtypje që në fakt është edhe kuantifikueshme që një pjesë e konsiderueshme e raportit, merret me diçka tjetër, përveç punës së autoritetit dhe kjo mendoj që është një prej vërejtjeve kryesore gjenerale ndaj këtij raporti, për shkak se shpenzohet shumë hapësirë duke na treguar se çfarë ka thënë Raporti i Progresit për Autoritetin e kështu me radhë gjërat të cilat ne kemi mundur edhe t'i lexojmë në Raportin e Progresit, por edhe të cilat janë diskutuar disa herë dhe konsideroj që nuk ishte dashur të jetë pjesë e këtij raporti në fakt kur ishte dashur të raportohet puna e Autoritetit. Po ashtu shihet që një pjesë e konsiderueshme e punëve janë vazhdimësia e asaj se çfarë është bërë në vitin 2010, në fakt ku janë lëshuar edhe vendime të reja për analizat edhe hulumtimet që ky Autoritet i ka bërë në vitin 2010, veçanërisht te kompanitë e sigurimeve, te këto kompanitë që shesin apo ofrojnë këto arka fiskale e kështu me radhë. Pra, disa janë disa punë të cilat janë kryer në vitin 2010 dhe tash në vitin 2011, faktikisht janë bërë edhe disa vendime shtesë, rekomandime shtesë e kështu me radhë.

Po ashtu unë desha me e ngritë këtë çështje, do me thënë tash me hy në disa pika konkrete konkrete të raportit. Është kjo çështja te sfidat me të cilat me të cilat është ballafaquar Autoriteti, por te sfida e fundit, në faqen 8 ku thuhet se mungon ose është e pamjaftueshme përkrahja institucionale dhe ruajtja e pavarësisë dhe të Autoritetit. Edhe unë njësoj si zoti Deshishku, do ta kisha ngritur këtë çështje duke kërkuar nga Autoriteti që të na tregoj se të cilat institucione, çfarë mënyre po e cenojnë pavarësinë e autoritetit, dhe po ndërhyjnë ose nuk po e përkrahin atë institucionalisht.

Pra në disa aspekte këtu, në mënyrë indirekte përmendet se ku mungon ajo përkrahja, mirëpo do të kishte kërkuar ky raport me qenë se është përmendur në mënyrë eksplicite, atëherë të tregohet se cilat janë institucionet të cilat e kanë penguar Autoritetin në kryerjen e detyrës së vet gjatë vitit 2011, në çfarë mënyre dhe në çfarë mënyre ato paskan vepruar kundër Ligjit për konkurrencën, për shkak se kjo mungesë e përkrahjes institucionale, e veçanërisht ndërhyrja në pavarësinë e Autoritetit, po qe se ka pasur të tillë, atëherë kjo është në kundërshtim me Ligjin dhe rrjedhimisht ne duhet ta dimë si deputetë kush në çfarë mënyre po e shkel ligjin, nëse e ka shkelur, nëse jo, atëherë nuk do të përmenden ato.

Çështja tjetër është që këtu në fakt te draftimi i udhëzimeve administrative dhe aktet tjera nënligjore te faqja 12, ne njëkohësisht në Komision e kemi bërë një monitorim të punës së Autoritetit, por veçanërisht monitorim të zbatimit të Ligjit të Konkurrencës dhe disa prej këtyre çështjeve janë ngritur edhe gjatë kësaj periudhe, pra janë një numër i

udhëzimeve administrative të cilat nuk janë nënshkruar, për të cilat konsiderojmë se duhet të nënshkruhen për shkak se ia lehtësojnë punën Autoritetit, natyrisht dhe ia mundësojnë atij në kompletimin e tërë asaj strukture të akteve nënligjore që është e domosdoshme për punën e tij. Dhe, për të hyrë në punën konkrete që e ka kryer ky autoritet gjatë vitit 2011, natyrisht këtu pjesa, domethënë te punët që janë kryer, janë disa çështje që kisha dashur me i ngritë këtu. Për shembull, te rekomandimi lidhur me shitjen e derivateve të naftës në rajonin e Vushtrrisë, thuhet në fund aty, është në faqen 20, thuhet që Autoriteti ka vendosur, pra pasi që e konstaton që ka pasur një lloj shkeljeje, ka vendosur që të mos aplikojë gjoba ndaj këtyre kompanive, por ka kërkuar shfuqizimin e këtyre praktikave të bashkërenduara për fiksime të çmimeve, furnizime selektive dhe monitorimi i tyre është në proces.

Nuk thuhet në raport pse ka vendosur, ose çfarë mënyre ka vendosur. Domethënë, nëse ka, është konstatuar shkelja e ligjit dhe në fund autoriteti vendos që të mos aplikoj gjoba, atëherë pse vjen ky vendim? Domethënë çfarë e ka shtyrë këtë vendim, ku është logjika e këtij vendimi? Pra, mendoj që një raport i punës do të duhej të na shpjegonte neve, por edhe secilit që është i interesuar të lexoj këtë për ta shtuar transparencën e këtij Autoritetit që na tregoj se si ka ardhur deri te ky vendim, për shkak se mendoj që duhet ta di secili qytetar i interesuar.

Po ashtu, në të njëjtën faqe, te C-ja përmendet te rekomandimi për shfuqizimin e marrëveshjes për qendrat e kontrollit, thuhet që më datën 3 maj 2011, Autoriteti i Konkurrencës ka nxjerrë vendimin numër 8, me të cilin jep opinion dhe rekomandime ministrive përkatëse, në veçanti Ministrisë të Infrastrukturës që të shfuqizojë nenin 36 të urdhërësës administrative numër 2008/13 dhe nuk thuhet më askund se çfarë është ndërmarr, a ka vepruar Ministria sipas rekomandimeve apo jo, për shkak se në disa raste tjera të punës të tyre, na tregojnë në fund edhe se çfarë efekti ka pasur rekomandimi i tyre, por në këtë rast nuk përmendet fare tash, a është që nuk ka vepruar fare Ministria në këtë drejtim apo kanë harruar ta përmendin, kjo është një pyetje që mendoj është legjitime për sa i përket kësaj për shkak se, nëse nuk ka vepruar Ministria, atëherë mungesa ose shpërfillja e këtij rekomandimi, është një lloj përkrahje e pamjaftueshme e institucioneve të Kosovës për këtë Autoritet ose të paktën ndoshta këtë e kanë menduar ata kur kanë thënë që ka mungesë të përkrahjes institucionale.

Natyrisht, pjesa e konsiderueshme e raportit edhe për mua më interesante ka qenë rekomandimi për bankat komerciale apo analiza që ky Autoritet e ka bërë për veprimin e bankës komerciale dhe natyrisht në shumë pika, shihet që në fakt Autoriteti i jep disa rekomandime të cilat as nuk janë në fushën e tij edhe dorën në zemër nuk janë edhe aq shpjeguese.

Për shembull, thuhet që pas analizës që e kanë bërë edhe pas një monitorimi gjashtëmujor, thuhet studimit të hollësishëm të transaksioneve kryesore bankare, i ka nxjerrë këto rekomandime dhe konkluzione. Konkluzioni i parë është kështu, vetëm po e lexoj: “Rrija dhe zhvillimi i sektorit bankar 2000-2010, është shoqëruar me krijimin e bankave dhe rritjen e numrit të tyre, me zgjerimin e produkteve të ofruara, me zgjerim të shtrirjes gjeografike duke mbuluar gjithë territorin e vendit.

Edhe pse konstatohet një përpjekje e vazhdueshme e operatorëve bankarë për sigurimin e një baze të gjerë të klientëve duke rritur konkurrencën, kjo rritje ende nuk ka pasur efekte të konsiderueshme në uljen e normave të interesit në kredi dhe në zvogëlimin e dallimit mes interesit dhe, pra kjo konkluzë, ky konstatim nuk është diçka që e ka nxjerr Autoriteti tash pas një studimi gjashtëmujor, nuk ka pasur nevojë fare për një studim gjashtëmujor, për ta konstatuar një diçka që e dimë të gjithë. Dhe konsideroj që kjo nuk ka vend në këto rekomandime që është dashur t'i jepen bankave ose për të na treguar neve se si funksionon tregu i bankave komerciale në Kosovë. Po ashtu e dyta është që kapitali i bankave ekzistuese dominohet nga kapitali i menaxhuar nga të huajt. Edhe këtë e din secili qytetarë dhe ndorën në zemër këtë mund ta lexosh në secilin raport të BQK-së. Edhe me sa di e di unë, BQK-së i bie kjo mënyrë i raportimit dhe ky lloj i raportimit e jo Autoritetit të Konkurrencës.

Pastaj thuhet që te një prej rekomandimeve që mungesa e transparencës të paraqitur më qartë përmes të pamundësisë të konsumatorëve për të krahasuar në mënyrë efikase shërbimet e ofruara nga banka dhe pastaj thotë që këto rrethana e krijojnë mundësinë e ofruesve që t'i rrisin çmimin mbi nivelin konkurrues të tregut, pa humbur pjesë tregu, por Autoriteti në këtë pikë duhet të na tregoj neve se a është kjo shkelje e parimit të konkurrencës dhe nëse është, çfarë duhet të ndërmerret autoriteti për këtë çështje dhe jo vetëm të konstatoj edhe pastaj të thotë që në fakt ky është një realitet të cilin ne nuk mund ta ndryshojmë, se ashtu nuk është dashur ta konstatoj hiq se këtë e dinë po ashtu. Edhe është një çështje të cilën Autoriteti është dashur të marrë masa. E njëjta gjë pastaj ndodh edhe me 68% të tregut që thuhet: do të ishte me interes të analizoheshin normat e interesit që ofron për depozita të ulët dhe të interesit me kredi të lartë, vlerësimin e tyre si një strategji e menaxhimit të likuiditetit apo abuzim.

Pra, përveç si fjali është nga pak vështirë për ta kuptuar, nuk duhet të na treguar neve Autoriteti se çka është mirë ta analizojmë, por duhet me analizuar se çka është mirë me analizuar ata kur te kryejnë analizën dhe kur të na japin rekomandime, pastaj do ta marrim vesh a ka qenë mirë apo jo me e analizua, por jo kështu të na propozoj neve se kush do ta analizoj pastaj, ne, Kuvendi?

Dhe një çështje e fundit që kisha dashur me e ngritë që lidhet me të njëjtën analizë, domethënë, thotë që te Banka Qendrore rekomandimet e Autoritetit, pra pasi që i kanë bërë rekomandimet për bankat, thotë që kanë gjetur mbështetjen si në nxjerrjen e Ligjit sigurimin e depozitave, zhvillimin e tregut të letrave me vlerë dhe rritjen e mbikëqyrjes së bankave komerciale. Mendoj që te pika e dytë, ne të gjithë e dimë që është një diskutim goxha afatgjatë për zhvillimin e tregut të letrave me vlerë dhe nuk mendoj se kjo ka ardhur si rrjedhojë edhe këtu, domethënë shtija e parë e këtyre letrave me vlerë nga Qeveria që ka ndodhur gjatë këtij viti, nuk mendoj se ka ardhur si rrjedhojë e rekomandimeve të autoritetit. Kjo është një plan goxha ma i kamotshëm dhe ato rekomandime që i ka bërë

Autoriteti këtu për tregun e letrave me vlerë, mendoj që në njëfarë forme edhe kanë dal jashtë kompetencave të tyre, por edhe kanë huqur ato që është e vërteta për shkak se ky treg me letra me vlerë, nuk mendoj se do të ndikojë siç edhe pra edhe po shihet që

nuk po e ndikon fare mënyrën e si funksionojnë bankat komerciale dhe nivelin e kamatave që ato e japin për ekonominë e Kosovës në përgjithësi dhe për qytetarët e Kosovës.

Dhe po ashtu, do me thënë në një pikë aty rekomandohet që duhet të rritet numri i bankave, gjë që konsideroj që u tha këtu më herët, domethënë që nuk e kemi ne problemin me numrin e bankave për shkak se kemi boll të tilla, por mendoj që në njëfarë forme këtu ka dështuar konkurrenca si koncept ekonomik. Pra të gjithë e besojnë këtë sikur të kishte qenë religjion, por askush asnjëherë nuk po e shtron pyetjen por çka nëse konkurrenca vërtet nuk i përgjigjet kësaj nevojë dhe duhet të kemi diçka tjetër? Dhe mendoj që këtu nuk është kjo puna e Autoritetit, por me qenë se e kanë prekur këtë temë, zgjidhja është plotësisht ndryshe e jo rritja e numrit të bankave në tregun e Kosovës. Ju faleminderit! Edhe vetëm të shtoj se ne do ta votojmë raportin me të gjitha këto mangësi, por i kisha bërë thirrje nga këtu këtij Autoriteti se edhe në vitin e kaluar, e kemi pasur problem me raportin që e ka dorëzuar. Edhe këtë vit raporti nuk është i nivelit të kënaqshëm dhe kishte me qenë mirë që të kujdesen pak më shumë kur ta dorëzojnë raportin në Kuvend. Ju faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi)

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës, deputeti Xhevdet Neziraj e ka kërkuar fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju falemnderit, zoti kryetar!

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës do ta përkrahë këtë raport, mirëpo i ka disa vërejtje dhe nuk do të shtoja më shumë se që i parashtruan përfaqësuesit edhe i LDK-së dhe i “Vetëvendosjes”, mirëpo është një kureshtje që në Raportin e konkurrencës, në faqen 8 thuhet që edhe vetë nuk e dinë fjalën “konkurrencë” edhe pse kanë harxhuar 56.000 euro për shpenzime jashtë vendit për trajnime në Shqipëri, Maqedoni, Bullgari dhe ende nuk e kanë të qartë. Prandaj, e kisha lutur Komisionin funksional që herëve tjera këtij Agjencioni bile t’ua mësojnë fjalën e konkurrencës.

KRYETARI: Ju falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, kryetar!

Komisioni e dha shqyrtimin se është shqyrtuar në Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, ky raport i Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, duke marrë parasysh se Autoriteti Kosovar i Konkurrencës edhe në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është i obliguar që në tremujorin e parë të vitit kalendarik, të raportojë brenda Komisionit Parlamentar dhe Kuvendit të Kosovës është i obliguar që tremujorin e parë të vitit kalendarik, të raporton brenda Komisionit Parlamentar dhe Kuvendit të Kosovës. Në këtë raport duhet të ceket si koalicion për Kosovën e Re, pikë së pari për arsye se këtu kemi vetëm një ministër të Qeverisë, zoti Mujota, që t’i bëhet ftesë Qeverisë që ta kompletojë Bordin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës

për arsye se ky autoritet funksionon vetëm me tre anëtarë. Njëkohësisht duke marrë parasysh se Kushtetuta e Kosovës e thotë shumë qartë që shteti i Kosovës, është një shtet cili bazohet në ekonominë e lirë të tregut dhe duke marrë parasysh rëndësinë e këtij autoriteti me një shtet demokratik, puna e këtij autoriteti nuk reflekton edhe aq mirë në këtë raport të cilin e kanë sjellë Komisioni Kosovar i Konkurrencës.

Në rast se shohim objektivat e autoritetit të cilat objektiva i potencon edhe Komisioni Evropian për vitin 2012, Raporti i Progresit thuhet se akoma duhet legjislacioni të plotësohet për mbrojtjen e konkurrencës që do të thotë se akoma duhet të punohet në këtë aspekt që Kosova të ketë një ekonomi të lirë të tregut dhe konkurrencë, dhe njëkohësisht Ligji mbi konkurrencën, duhet të ofrohet me standardet e BE-së.

Në rast se i shohim rekomandimet të cilat i nxjerrë ky Autoritet i Konkurrencës, thuhet se do të mbikëqyrë edhe çështjen e Ligjit për ndihma shtetërore, i cili hyn në zbatim, në fuqi në janar të vitit 2012, mirëpo në esencë, nuk mund të pritsh prej një autoriteti kosovar të konkurrencës një punë aq të mirë, kur pikë së pari çështja e funksionimit të këtij autoriteti prej themelimit dhe deri më tani, nuk janë ato kushte çfarë duhet t'i ketë një autoritet i cili mbikëqyr gjithë tregun kosovar të konkurrencës dhe për mbikëqyrjen e një tregu kosovar të konkurrencës, duhet të ketë përfaqësues apo persona të cilët kanë njohuri, dinë dhe donë të punojnë në këtë autoritet Kosovar të Konkurrencës.

I kemi qëndrimet e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës këtu në lidhje me disa marrëveshje të cilat ata i shohin të çështja e policave të sigurimit kufitar, policat e obligueshme, çështjen e bankave, çështjen e rekomandimeve për certifikimin e arkave fiskale, të gjitha këto çështje bëjnë atëherë kur tregun e zbaton një operator ekonomik i cili ka mbi 50% të tregut. Duhet të kemi kujdes.

Te çështja e bankave, ne duhet t'i drejtohem Bankës Qendrore në raportin e Bankës Qendrore, i cili vjen brena këtij Kuvendi dhe aty nga Banka Qendrore të kërkojmë çështjen e uljes së kamatave për qytetarët e tanë.

Edhe një herë si Koalicion për Kosovën e Re, kërkoj që ministri të japë këtë informatë në mbledhjen e Qeverisë që të plotësohet ky bord. Njëkohësisht që ky autoritet të përkrahet edhe nga Qeveria edhe nga Kuvendi që të kemi njerëz që dinë, donë dhe kanë moral të punojnë në këtë Autoritet të Konkurrencës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, deputetja Biserka Kostiq e ka fjalën.

BISERKA KOSTIĆ: Zahvaljujem, gospodine predsjedniče!

I parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke, razmotrila godišnji izveštaj Kosovskog autoriteta za konkurenciju i podržao usvajanje istog. Zahvaljujem!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar "6+", deputeti, kryetari i Albert Kinolli, e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Ju faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar “6+”, e ka shqyrtuar këtë raport vjetor të punës për vitin 2011, të Autoritetit të Konkurrencës dhe do ta miratojë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Sala Berisha -Shala.

SALA BERISHA - SHALA: Ju faleminderit, kryetar!

Unë më herët e mora fjalën në emër të Grupit Parlamentar, tani si deputete, po dua ta bëj vetëm një sqarim, po dua të lidhëm në diskutimin e deputeti Visar Ymeri, që ngriti shumë pikëpyetje lidhur me raportin në fjalë dhe të gjitha ato pikëpyetje që i ka ngritur, i ka marrë përgjigjet nga përfaqësuesit e Autoritetit të Konkurrencës, e për hir të njoftimit të drejtë të opinionit dhe të korrektësisë, është mirë të njoftohen edhe deputetët këtu, por edhe opinionit se unë dua t'i marrë vetëm dy çështje, ajo që lidhet me derivatet e naftës në rajonin e Vushtrrisë, që e ka bërë një hetim Autoriteti i Konkurrencës dhe thuhet se nuk i ka shqiptuar gjoba, sepse ata operuesit atje nuk kanë qenë në dijeni se kanë qenë në kundërshtim me ligjin për atë edhe nuk u janë shqiptuar gjobat dhe këtë përgjigje e kemi marr ne në Komisionin Parlamentar.

Edhe një çështje tjetër që ka të bëjë me rekomandimin mbi shfuqizimin e marrëveshjes për qendrat e kontrollit teknik në lidhje me një udhëzim administrativ që e ka nxjerrë Ministria e Infrastrukturës. Edhe në këtë pikëpyetje që e ngriti deputeti, e kemi marrë përgjigjen se është shfuqizuar ky udhëzim administrativ, kështu që është mirë që për hir të korrektësisë t'i flasim edhe ato që i dimë edhe pse është e ditur se opozita është e thirrur dhe e ka obligim që të paraqes vetëm pjesën më të errtë edhe atë që nuk është në raportin dhe gjithkund tjetër në punën e Qeverisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Ne po shkojmë nëpër pikat se nuk kemi kuorum me votuar, por kemi me diskutuar.

Tash e kemi pikën e radhës -

8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të organit shqyrtues të prokurimit publik për vitin 2011.

Raportin vjetor të Organit shqyrtues të Prokurimit publik për vitin 2011, e ka shqyrtuar Komisioni funksional dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadergjonaj, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

Safetja nuk është këtu! Kalojmë te kryetarët e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e do fjalën?

Deputetja Hasime Krasniqi e ka fjalën.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar,

I nderuar ministër,
Të nderuar deputetë,
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar dhe analizuar raportin e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe mendon se raporti është sjell me kohë në Kuvend dhe përmban në vete të gjitha të dhënat që i parasheh Ligji për prokurimin publik për të raportuar në Kuvend.

OSHP-ja ka ofruar të dhënat e detajuara për punën e bërë gjatë vitit 2011 në bazë të së cilës ka arritur të krijojë marrëdhënie të mira me publikun duke rritur besueshmërinë e operatorëve ekonomik dhe publikut ndaj OSHP-së që është mbështetur në punën e tij si institucion i pavarur gjatë shqyrtimit të ankesave dhe në marrjen e vendimeve në mënyrë profesionale dhe në afatin e paraparë ligjor.

Aktiviteti i këtij institucioni ka bërë që të rritet transparenca dhe përgjegjësia për shpenzim sa më ekonomik dhe racional të parasë publike, po ashtu edhe në ofrimin e kushteve për konkurrim të drejtë dhe të paanshëm të operatorëve ekonomik.

Duke u bazuar në Ligjin e prokurimit publik ku përcaktohet qartë se vendimet e OSHP-së janë përfundimtare, mirëpo disa autoritete kontraktuese nuk i kanë respektuar këto vendime me ç'rast OSHP-ja ka shqiptuar gjopa për këto autoritete kontraktuese të cilat janë paraqitur në faqen 33 të këtij raporti.

Gjatë analizës së këtij raporti vërejmë se nga 386 ankesa të shqyrtuara, në 25 raste është iniciuar padi kundër vendimit të OSHP-së në Gjykatën Supreme të Kosovës dhe OSHP është njoftuar vetëm në një rast nga kjo gjykatë për të cilën është aprovuar vendimi i OSHP-së.

Atëherë si Grup Parlamentar kërkojmë edhe një angazhim më të lartë të Gjykatës Supreme në kryerjen e këtyre lëndëve dhe t'u kthehet përgjigjja OSHP-së dhe të gjitha organeve kontraktuese. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Falemnderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,
ORSH-ja, Organi Rregullativ i Shqyrtimit të Prokurimit Publik nëpërmjet raportit për vitin 2011 ka përmbushur kriterin ligjor që parashihet në Ligjin e prokurimit publik, që të sigurojë informacione nëpërmjet raportit për Parlamentin, për procedurat e aktiviteteve të prokurimit si në fushën e funksionimit, arritjeve të prokurimit dhe objektivat e përmbushura nga ORSH-ja.

Organi Rregullativ i Shqyrtimit ka shqyrtuar gjithsej 419 ankesa nga të cilat 386 nga operatorët ekonomik, 30 ankesa nga autoritetet kontraktuese dhe 3 ankesa që kanë të bëjnë me kundërshtimin e interpretimit të KRPP-së.

Vërehet që ka një zvogëlim për 166 ankesa në krahasim me vitin 2010, por që nuk mund të kuptohet arsyeja e zvogëlimit. Ne po dëshirojmë dhe po e kuptojmë që ka një zbatim më të mirë të ligjit dhe procedurave të prokurimit në këtë drejtim, bile kështu dëshirojnë që ta kuptojnë këtë. Sidoqoftë ankuesit më të mëdhenj janë: Ministria e Infrastrukturës Rrugore, që ka gjithsejtë 32 ankesa po i përmend vetëm tri, zoti kryetar, pastaj është Korporata Energjetike, me 31 ankesë dhe Policia e Kosovës, me 26 ankesa. Ndoshta për shkak të volumit të madh që i kanë të lëndëve për prokurim, mund të ketë edhe ankesa më të mëdha, nuk po përbëjnë, domethënë në rregullsinë e këtyre.

Të dhënat e raportit tregojnë se disa segmente që kanë qenë si vërejtje në Raportin e Progresit, siç ka qenë përmbushja e disa gjobave apo shqiptimit të disa gjobave në raport tregohet më mirë se sa që ka qenë në Raportin e Progresit edhe që është bërë një inkasim i pjesërishëm i kësaj shume që është prej 130 mijë euro, mirëpo kjo është një përmirësim, domethënë në këtë brengë që ka qenë në Raportin e Progresit.

Është edhe një brengë tjetër e cila ka qenë po e njëjtë e paraqitur në Raportin e Progresit që ka të bëjë me shkelje të rregullave të prokurimit, por kur e kemi parasysh që ka zvogëlim të ankesave edhe këtu po dëshirojmë apo po kemi qejf që të konstatojmë që ka një përmirësim të saj.

Ajo që ka qenë një vërejtje në Raportin e Progresit që unë e konsideroj, nuk është në mandatin e Organit Rregullativ të Shqyrtimit të Prokurimit Publik, që ka të bëjë me përzierjen e kompetencave, sidomos në kompetencat që i takojnë KRPP-së, ORSH-së dhe APP-së.

Unë konsideroj që Ligjin e prokurimit publik i cili është shpallur tri apo katër herë të cilin ne si Komision e kemi kaluar nëpër dorë, unë e them me përgjegjësi që sponsorues 100% ka qenë Agjencioni Evropian dhe ashtu si e kanë kërkuar ata ne e kemi aprovuar, pa ndërhyrë në esencën, në strukturën e ligjit, mirëpo përsëri ata na kritikojnë edhe ne duhet t'i pranojmë këto kritika për arsye se vetë e sponsorojnë edhe vetë e vlerësojnë.

Sa i përket shpenzimeve të buxhetit vërehet një balancim, domethënë në mes të asaj që është planifikuar dhe asaj që është harxhuar. Në shënimet përfundimtare del që ka bërë një shpenzim të totalit në 94.31%, por ajo çka vërehet, zoti kryetar, ka një mospërputhje në llogaritje. Llogaritja e saktë del që këto që janë paraqitur në paga, domethënë, shpenzimet në paga, në mallra dhe shërbime, në këto komunalit edhe investime të tjera, janë më të vogla se sa që janë paraqitur. Mund të ketë ndonjë kalkulim, gabim teknik, mirëpo ne po e konsiderojmë kështu, me qenë se mund të ketë edhe ndonjë gabim i qëllimshëm duke menduar që deputetët nuk kanë kohë apo nuk i bëjnë kalkulimet.

Ajo çka vlen të theksohet është se Komisioni për Buxhet dhe Financa do të ishte mirë ta bëjë monitorimin e ORSH-së, domethënë si po i trajton ankesat dhe a është në pajtueshmëri me kompetencat dhe përgjegjësitë që i ka.

Në fund si raport, domethënë si libër, i cili është prezantuar në Kuvend është me një kualitetit të mirë edhe një raport i cili mund të lë të dyshojë edhe ta interpretojë secili deputet nga këndi i vend pozitiv ose negativ. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka deputetja Albana Fetoshi.

ALBANA FETOSHI: Falemnderit, kryetar!

Do të përpiqem të jem më e shkurtër për shkak se shumica e vërejtjeve këtu veç u dhanë nga grupet e tjera parlamentare.

Unë do të ndalem vetëm në një nga kompetencat dhe përgjegjësitë e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, domethënë që i shqyrton ankesat e palëve lidhur me shkeljet e mundshme.

Prej 12 mijë e 310 kontratave që janë bërë, ka pasur ankesë vetëm për 386 raste, kjo tregon një numër të vogël të ankesave të bëra dhe përkundër faktit se ka pasur pak ankesa në raport thuhet se paneli shqyrtues ka marrë vendim për anulimin në aktivitetet e prokurimit publik, ri tenderim, në 71 raste. Nisur nga shkeljet e konstatuara të dispozitave të Ligjit të prokurimit publik, për parregullsitë në dosjet e tenderimit, vlerësim jo të drejtë të ofertave apo për zhvillimin a mangësi të procedurave të prokurimit.

Nëse kemi kaq pak raste të ankesave në ndërkohë që edhe ato që janë, këto shifra na tregojnë që shumë pak kontrata gjatë shqyrtimit të këtyre ankesave janë anuluar. Ndërkohë që flitet shumë për korrupsionin, ky raport na praqet një gjendje mjaftë të mirë, atëherë ky raport është në shpërputhje me opinionet e bëra deri më tani për korrupsionin në Kosovë, domethënë, në rastin e tenderimit, ose raportet e bëra nuk janë korrekte, ose ky raport nuk është korrekt. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës, deputeti Burim Ramadani e ka kërkuar fjalën.

BURIM RAMADANI: Falemnderit, kryetar!

Është definitivisht prej raporteve më mirë të formuluar që kanë ardhur gjatë kësaj periudhe në Kuvend të Kosovës dhe si të tillë besojmë që duhet ta përkrahim si Grup Parlamentar i Aleancës. Por e vërteta sa i përket përmbajtjes dhe informatave që na jep OSHP-ja, vërtet është shqetësuese për faktin e numrit të ankesave të cilat kanë ndodhur dhe nëse i besojmë profesionalizmit të OSHP-së për të cilin nuk do të doja që tash të ngris dilema ose dyshime, ne shohim një numër vërtet të madh të rasteve kur brenda këtij numri të ankesave, OSHP-ja ka vendosur për ri tenderim komplet ose për rivlerësim. Pra, në të dy rastet ne duhet të jemi të vëmendshëm dhe të shohim se në momentin kur ka rivlerësim të ofertave dhe ritenderim, atëherë kemi të bëjmë me shkelje, shkelje të Ligjit për prokurim publik dhe kemi të bëjmë me përgjegjësi direkt të njerëzve të cilët janë në zyrat e prokurimit në agjencitë ose ministritë e caktuara.

Shkeljet ligjore sikurse thuhet në këtë raport, në shumicën e rasteve kanë hasur me parregullsi gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe marrjen e vendimeve të gabuara për shpalljen e fituesit, dhe hajde ta përkthejmë këtë çka i bije kjo? Kjo i bie që ata njerëz nuk e kanë respektuar ligjin, e kanë shkelur ligjin dhe kanë shpallur fitues të tenderëve, njerëz ose kompani, të cilat nuk e kanë merituar dhe, në momentin që nuk e kanë merituar, do të thotë e kanë shkelur ligjin dhe i kanë bërë padrejtë ofertuesve tjerë në procesin e tenderimeve që ka ndodhur.

Pra, prej 367 ankesave që janë shqyrtuar, mos harroni 177 raste janë gjetur me shkelje. 177 prej 367 ankesave janë rreth 50%, pra 46% të ankesave që janë bërë, OSHP-ja i ka gjetur që kanë të drejtë ankuesit, do të thotë, ka pasur shkelje, qoftë për rivlerësim, qoftë për nevojën për ritenderim komplet, dhe kjo nuk është e mirë. Dhe, kjo nëse e shohim mundësinë pse në shumë raste nuk janë ankuar për shkak se nuk i kanë besuar sistemit ose për diçka tjetër, atëherë këtë numër të ankesave e shohim se rreth 46% kanë pasur të drejtë, ka pasur shkelje dhe ka 46% të shkeljes së Ligjit të prokurimit në proceset tenderuese, dhe ky është fakti që jepet dhe që unë besoj plotësisht që ky raport duhet të merret menjëherë prej Prokurorisë në dorë dhe të shihet dhe të shkohet rend me rend, zyre për zyre për të parë se në cilat raste e kanë shkelur Ligjin e prokurimit publik, për cilat raste bëhet fjalë për rivlerësim dhe në cilat raste se bëhet fjalë për anulim komplet.

Dhe është mirë që ministri Mujota është këtu, sepse te Ministria e zotit Mujota ka më së shumti ankesa, prej 31 lëndëve të shqyrtuara, 19 janë gjetur shkelje, 12 janë aprovua si procese pa shkelje të ligjit, 19 janë gjetur shkelje, 10 në rivlerësim dhe 9 janë kthyer në ritenderim komplet. Dhe, a nuk ju duket shumë, prej 31-ve janë 19? Mos ta mendojmë tash se ka pasur ndonjë rast edhe që nuk janë ankuar, por është çështje e tyre pse nuk janë ankuar.

Edhe në ministri tjera, në Ministri të Drejtësisë prej 11, 6 janë gjetur si shkelje të Ligjit për prokurimin publik.

Në Ministrinë e Punëve të Brendshme, 4 janë gjetur me shkelje, prej 7 ankesave që ka ndodhur.

Në Ministrinë e Administratës Publike, 7 janë gjetur me shkelje prej 13 që kanë qenë ankesat.

Në komunë të Lipjanit, 7 lëndë janë shqyrtuar, 6 janë gjetur me shkelje, pra është vendosur që të ketë rivlerësim dhe ky është një fakt tepër shqetësues për atë që ne po e shohim prej punës që e ka OSHP-ja.

Edhe një element tjetër është me rëndësi ta themi se janë 7 institucione ose autoritete kontraktuese që po paguajnë gjoba për ato, ose janë dënuar me gjoba për faktin se nuk i kanë respektuar vendimet e paneleve shqyrtuese, domethënë, këto autoritete kontraktuese nuk i kanë respektuar këto.

Edhe Ministria e Infrastrukturës i ka 20 mijë euro gjobë, pikërisht për faktin se nuk e ka respektuar vendimet e paneleve shqyrtuese.

Unë besoj, që ky është një raport shqetësues për Kosovën, është një raport shqetësues për institucionet e Kosovës, jo vetëm për Qeverinë, sepse këtu bëhet fjalë edhe për komunat, madje edhe Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës e ka pasur një ankesë dhe iu ka kthyer në ritenderim, domethënë edhe në atë nivel është futur kjo logjikë e shkeljes së Ligjit të prokurimit publik. Dhe këto janë elemente që definitivisht duhet t' i marrë Prokuroria në shqyrtim. Falemnderit!

KRYETARI: A do, po shkurt? Fjalën e ka ministri Fehmi Mujota.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Falemnderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Me që raporti paraprak nuk u votua, unë nuk thashë ndonjë fjalë në këtë rast, por megjithatë po e ndjej të nevojshme të kthej mbrapa dhe falënderoj deputeten Shala që përmendi rastin e ndryshimi të një udhëzimi administrativ, i cili është edhe në raport besoj, nuk i di shkaqet teknike pse nuk ka ardhur.

Është e vërtetë që qendrat e kontroleve teknike tani e tutje po them me udhëzimin administrativ të ri, janë të pakufizuara, çdo kush ka të drejtë të konkurrojë, çdo kush që i plotëson kushtet ligjore dhe administrative, do të ketë mundësi të hapë qendër kontrolli teknik dhe kjo është një progres i arritur.

Tek Organi Shqyrtues i Prokurimit, Ministria e Infrastrukturës është e precizuar saktësisht me numrin e ankesave që ka pasur në shqyrtimin e lëndëve, deputeti Ramadani e ngriti këtë çështje. Për informimin tuaj, është shumë në rregull në qoftë se ekziston e drejta e ankesës. Po është e rëndësishme se sa kanë të drejtë në ankesë pastaj dhe organi që shqyrton që ne duhet t' i besojmë.

Ministria e Infrastrukturës në vitin 2011 ka pasur 19 lëndë të cilat janë kontestuar për kthim mbrapa në ritenderim ose rivlerësim ose në anulim të tërësishëm.

Dhe, për informimin tuaj brenda kompetencave që ka ministri, duke ruajtur autoritetin e plotë të pavarur Departamenti i Prokurimit dhe organi që i vlerëson këto gjëra dhe duke zbatuar secili detyrën e vet dhe punën e vet, pa pasur asnjë ndërhyrje ligjore dhe asnjë ndërhyrje tjetër, janë marr masa disiplinore të cilat parashihen me ligj. Përkatësisht, ka ndodhur suspendimi i tre zyrtarëve të lartë të prokurimit në Ministrinë e Infrastrukturës, ka ndodhur suspendimi i sekretarit të përgjithshëm dhe unë besoj se këto janë masat të cilat mund të merren brenda kompetencave të ministrit, në raport me shërbimin civil, por gjithmonë duke ruajtur pavarësinë e secilit autoritet. Të jemi të qartë, ministri nuk ka shkarkuar asnjërin përveç sekretarit, ndërsa persona tjerë sipas ligjit, komisionet disiplinore janë krijuar, kanë dhënë mendimin e tyre, gjendja është kjo që është. Mirëpo, duhet mos u hymë në hak në qoftë se ka raste kur padrejtësisht ndodhin kthime ose vlerësime jo fortë profesionale nga Organi Shqyrtues i Prokurimit. Nuk është në autoritetin e asnjë ministri dhe as Qeverisë për t' i vlerësuar këto punë, ky është organ i

Kuvendit dhe natyrisht unë besoj se ka shumë për dëshiruar dhe për të përmirësuar raportet mes OSHP-së dhe departamenteve të prokurimit në Kosovë dhe Ligjin e prokurimit. Por, masat po ndërmerren dhe këtu në këtë vend sundon ligji dhe do të sundojë ligji dhe jemi të gatshëm të ecim përpara në progres të vazhdueshëm në këtë drejtim. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Me qenë se u bë vonë pra, edhe kemi punuar shumë, unë do të diskutoj shumë shkurt.

Ne prej viti në vit po marrim raporte të cilat e vlerësojnë pozitivisht punën e agjencive edhe institucioneve të pavarura që duhet të mbikëqyrin procesin e prokurimit publik, i cili duhet të na mundësoj harxhimin e drejtë të parasë publike dhe është një nga faktorët kyç të korrupsionit. Në qoftë se shohim një vlerësim kaq pozitiv që i bëhet në këto raporte të punës së këtyre agjencioneve dhe në anën tjetër kemi të gjitha vlerësimet se korrupsioni ende nuk ka filluar të zvogëlohet në Kosovë, atëherë vetvetiu këtu do të thotë se kemi një defekt në trajtimin e këtij problemi. Dhe, ne duhet të hyjmë në analiza më të thella, sepse kam bindjen se nëse ne vazhdojmë që të trajtojmë në mënyrë të tillë se gjithçka po shkon në rregull me punën e organeve që e mbikëqyrin procesin e prokurimit publik dhe në anën tjetër korrupsioni nuk po zvogëlohet, atëherë këtu diçka nuk është në rregull, dhe ne si Kuvend mendoj se kemi një përgjegjësi që të shohim, të hymë në analiza pak më të thella.

Mendoj se Kuvendi ndoshta është mirë që çështjen e prokurimit publik dhe çështjen e përdorimit të parasë publike ta investigojë në disa studime të rastit dhe në komisione dhe komitete të posaçme të Parlamentit, e të shoh sa janë reale këto raporte. Për arsye se ne në qoftë se vazhdojmë në mënyrë të tillë të vlerësojmë pozitivisht dhe në anën tjetër korrupsioni nuk zvogëlohet, mendoj se nuk jemi duke e kryer punën mirë. Është fakt që ne kemi këtu rreth 12 mijë kontrata vitin e kaluar, vetëm 420 janë ankuar. Domethënë, në qoftë se e marrim vëllimin e numrit të kontratave sa janë lidhur, janë ankuar pak, domethënë është një përqindje e vogël e atyre që janë ankuar, por është shumë indikative që prej atyre që janë ankuar gati gjysma ka pasur të drejtë. E tash mos ka indikacione që këta të tjerë që nuk janë ankuar s'kanë guxuar të ankohen se më s'kanë ku të paraqiten te autoriteti kontraktues. Është një problematikë po them shumë delikate që nuk meriton që ne të trajtojmë vetëm me një aprovim rutinor të raporteve që na organizojnë këto agjenci. Prandaj, unë pletoj te Kuvendi që këtë çështje të prokurimit publik, ndoshta ta mbajë një mbledhje tematike, të diskutojë për këtë problem, të nxjerr konkluzë, sepse ne duhet të ballafaqohemi në mënyrë të ashpër dhe të vendosur me luftimin e korrupsionit. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit!

Po një gjë duhet ta dimë, ne edhe si komisionet të Parlamentit dhe si Parlament, nuk merremi me precepcionet, ne merrem me atë që e kemi në dokumentacion dhe flasim mbi

bazën e asaj që është në dokumente. Çështja e perceptimit është e shoqërisë civile edhe ata kanë të drejtë t'i ngrisin ato shqetësime.

Në emër të Grupit Parlamentar SLS-së, a e do dikush fjalën?

Nuk është lajmëruar. Të “6+”, nuk është lajmëruar.

Tani kemi edhe tre deputetë të lajmëruar për këtë çështje. Me qenë se është mirë vërtet qëndrimet e grupeve të përmbyllim me qëndrimet e atyre që flasin në emër të grupeve.

Megjithatë, fjalën e ka kryetari i Komisionit të Kontrollit, deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Falemnderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

U tha shumëçka edhe për shkak të kohës edhe unë do ta shkurtoj, por do t'i cek 2 – 3 pika ku unë mendoj se duhet të kemi një reflektim pak më të përafërt.

Nga 386 ankesa OSHP-ja, 106 aktivitete të prokurimit ka vendos të shkojnë në rivlerësim. Pra, nga 386 ankesa OSHP-ja ka marrë vendim që të shkohet në 106 aktivitete të prokurimit në rivlerësim. Është brengosëse se sa këto rivlerësime kanë zbatuar operatorët ekonomik ligjshmërinë në raport me to. Ka shumë prej tyre që kanë anuluar aktivitetet e prokurimit që shikuar në jetën praktike kjo ka domethënie edhe lënë gjurmë për t'u hulumtuar. Ka shumë prej tyre që ia ka dhënë përsëri të njëjtit operator, që është në kundërshtim me dispozita ligjore, pra në një mënyrë sa respektohen vendimet e OSHP-së, cilat janë vendime supreme, vendime të paankimime, por që duhet zbatuar, ka shumë çka. Dhe, unë mendoj se në raportin e auditimit që do të bëhet, këto do t'i prezantojmë një për një.

Brengos tjetër fakti se nga shqyrtimi i vendimeve të APP-së, nga 30 kërkesa të parashtruara nga autoriteti kontraktues, të pakënaqur me vendimin e APP-së, 23 prej tyre janë aprovuar nga ASHP, ndërsa vetëm 5 janë refuzuar, domethënë vetëm 5 raste APP ka marrë vendim të drejtë, në raport me 23 të cilat iu kanë refuzuar. Kjo flet shumë dhe unë mendoj se edhe këtu duhet gjurmuar dhe hulumtua pse e kemi një gjendje të tillë?

Baza e zotimit të shpenzimeve nga tabelat e paraqitura në raporte shihet se totali i shpenzimit të paraqitur në raport për kategorinë ekonomike është 94.31%. Të dhënat nga tabela shihet se është krahasuar buxheti i alokuar me shpenzime e jo buxheti i ndarë me shpenzime, siç duhet të jetë. Bazuar në tabelën e prezantuar del se buxheti i prezantuar dhe shpenzimet për vitin 2011 janë 94.31, por kjo realisht është shumë më e ulët. Të kemi parasysh se 30 mijë euro gjatë vitit Ministria e Financave i ka bërë shkurtime, dhe po të shkojë në atë bazë atëherë do ta shohim se këtë përqindje e ka paraqitur të fryrë, nuk i qëndrojnë. Pra, po t'i bëhet një auditim i rregullsisë do të konstatojë se tabelat nuk e figurojnë gjendjen reale në të cilën e ka takuar.

Sipas raportit të paraqitur shumë e mjeteve të zotuar për vitin 2011, është 256 mijë e 524 euro, kjo nuk do të duhej të jetë prezantuar kështu, sepse zotimit i paraprin shpenzimet dhe në rast kur ekzekutohet pagesa, atëherë shuma e mjeteve të zbatuara kalon në shpenzime. Në rastin konkret shuma e mjeteve të zotuar duhet të jetë zero, do të thotë tabela nuk e prezanton në këtë mënyrë.

Sipas Ligjit të LPP-së neni 118, operatorët ekonomik duhet të paguajnë tarifatat me rastin e paraqitjes së ankesës. Unë mendoj se Kuvendi duhet të mendojë për këtë, pse të paguajnë tarifa dhe ndoshta tarifa është një element pse ankesa kemi pak karshi mendimit të tyre se kanë të drejtë në ankimim apo jo.

Megjithatë, Organi Shqyrtues gjatë vitit 2011, në emër të tyre tarifave ka arkëtuar 89 mijë e 500 euro. Kjo është për ata operatorë të cilët gjatë shqyrtimit është vlerësuar se s'kanë pasur të drejtë. Pra, kjo na shtynë të mendojmë për pozicionin e parë që e thashë se duhet të mendojmë pse operatori kur të ankimon duhet të paguan një tarifë, cila është arsyeja?

Dhe, krejt në fund duke dashur ta kursej kohën, ndërsa gjobat e shqiptuara nga OSHP për autoritetet kontraktuese janë në shumë prej 131 mijë euro, nga kjo shumë janë inkasuar vetëm 63 mijë euro. Edhe kjo brengos, sepse këtu konstatojmë se thesari nuk po vepron në bazë të vendimeve të autoritetit suprem në këtë rast Organi Shqyrtues, por po kërkon vendimet e gjyqësorit. Në ligj është shumë qartë se vendimi i OSHP-së është vendim suprem dhe Thesari nuk do ta pret vendimin e gjykatës, por në këtë rast duhet ta kryejë ekzekutimin. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Deputeti Kurtan Kajtazi e ka fjalën.

KURTAN KAJTAZI: Falemnderit, kryetar!

Mendoj se, përceptcioni që është krijuar në Kosovë se ka korrupsion të lartë, vërtet ky raport i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik e dëshmon të kundërtën dhe këto janë shifra të sakta që mund të besojmë.

U tha nga dikush sepse disa nga autoritetet, operatorët ekonomik ndoshta nuk kanë guxuar t'u ankohen, por vetë fakti që janë përmby 12 mijë kontrata në Kosovë, që do të thotë vetë 4% e tyre kanë bërë ankesa, është niveli i ulët, por njëjta gjë dëshmon për seriozitetin e këtij organi, sepse nga gjysma e këtyre ankesave që janë bërë, rreth 48% të tyre janë aprovuar dhe mendoj që sot nuk po shqyrtojmë raportin e autoriteteve tjera po një raport një organi të shqyrtimit publik të Kosovës, që vetëm gjatë vitit 2011 janë kursye afër 4 milionë euro nga ky raport. Dhe po ashtu vetë fakti se këto 40% të ankesave janë aprovuar flet për seriozitetin e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe pavarësinë e tij. Kjo tregon se megjithatë operatorët ekonomik kanë një dritare për t'i adresuar ankesat e tyre.

Andaj, të nderuar deputetë, ju ftoj që ta miratojmë këtë raport, sepse edhe nga organet më prestigjioze të specializuara ndërkombëtare që monitorohet ky organ është vlerësuar me notë mjaftë të lartë. Falemnderit!

(Diskutim i dorëzuar me shkrim)

SAFETE HADERGJONAJ: Sipas LPP, OSHP është i obliguar të sigurojë mbrojtjen e operatorëve ekonomik ankues, por gjithashtu të garantojë që procedurat e prokurimit të zhvillohen në harmoni të plotë me parimet bazë të LPP, siç janë: transparenca, trajtimi

i barabartë dhe jo diskriminues i ofertuesve si dhe shfrytëzimi më ekonomik dhe racional i fondeve publike.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur me 2 prill 2012, ku ishte i pranishëm edhe kryetari i OSHP, shqyrtoi raportin e OSHP dhe vlerësoi se raporti është gjithëpërfshirës, teknikisht është i përgatitur mirë duke i përfshirë të gjitha të dhënat që LPP e obligon t'i raportojë.

Në pajtim me ligjin, raporti përmban informacione për numrin e përgjithshëm të ankesave të pranuar, numrin e ankesave të refuzuara për shkak të mosrespektimit të afateve kohore ose jo plotësisë sipas ligjit ose dështimit për të depozituar sigurimin e kërkuar nga ligji; numri i ankesave që janë konstatuar se nuk përmbajnë pretendime të vlefshme, numrin e aktiviteteve të prokurimit që janë anuluar si rezultat i një ankese, informata të detajuara mbi çdo ngjarje ku autoriteti kontraktues ka dështuar në respektimin e një urdhërese të OSHP-së, numrin e procedurave të shqyrtimit që kanë rezultuar në konstatimin se aktiviteti përkatës i prokurimit dhe dhënia ose vendimi janë bërë në mënyrë të vlefshme.

OSHP gjatë vitit 2011 ka pranuar 419 ankesa ku krahasuar me vitin 2010, janë zvogëluar për 166 ankesa, ku 376 apo 92% të ankesave janë nga operatorët ekonomik, ndërsa 30 ankesa apo 7% janë të autoriteteve kontraktuese për shqyrtimin e vendimit të APP dhe 3 ankesa janë kundër interpretimit të KRPP.

Në 190 raste OSHP ka aprovuar vendimet e autoriteteve kontraktuese duke verifikuar se palët ankimore nuk kanë mbështetur ankesat e tyre në argumentet ligjore që të pranohen ankesat e tyre.

Në 106 raste paneli shqyrtues ka marrë vendim për rivlerësimin e ofertave duke konstatuar se është bërë vlerësimi i gabuar nga komisionet vlerësuese, duke hasur në shkelje të caktuara të LPP dhe rregullave të prokurimit.

Në 71 raste paneli shqyrtues ka marrë vendim për anulimin e aktiviteteve të prokurimit.

8 ankesa janë hedhur poshtë për shkak të mos kompletimit të ankesës brenda afatit të paraparë e LPP.

Nga 30 kërkesa të autoriteteve kontraktuese për shqyrtimin e vendimeve të APP-së, 25 janë aprovuar nga OSHP-ja, ndërsa 5 kërkesa të shqyrtuara janë refuzuar, me arsyetimin se nuk kanë gjetur shkelje nga ana e APP-së dhe se vendimet e tyre kanë qenë të drejta dhe të bazuara në dispozitat e LPP-së.

Nga anëtarët e KBF janë ngritur heshtjet që kanë të bëjnë me Raportin e Progresit, lidhur me shkeljen e rregullave të prokurimit në kontekst të korrupsionit dhe janë interesuar se çfarë masash konkrete janë ndërmarrë nga OSHP-ja për reduktimin e kësaj dukurie dhe në përmirësimin e rregullave të prokurimit. Kryetari i OSHP ka raportuar se pretendimet për shkeljet e rregullave të prokurimit të paraqitura iu kanë atribuuar

kryesisht operatorëve ekonomik dhe ka qenë shkelje të riparueshme. Sipas tij këtë e tregon edhe rënia e numrit të ankesave, krahasuar me vitet e kaluara dhe vendimet e nxjerra nga OPSH kur është konstatuar se ka pasur apo jo parregullsi apo shkelje ligjore gjatë procedurave.

Sa i përket çështjes tjetër të ngritur në Raportin e Progresit lidhur me numrin e vogël të gjobave të shqiptuara në shuma të ulëta, u raportua se OSHP gjatë vitit 2011, ka shqiptuar 7 gjoba. Autoritetet kontraktuese janë gjobitur në vlerë totale prej 131.000 euro

KBF ka rekomanduar që në të ardhmen OSHP duhet të jetë më e vëmendshëm në marrjen e vendimeve dhe shqiptimin e dënimeve në rast të shkeljeve ligjore. Gjithashtu u sugjerua që organet e prokurimit të kenë një bashkëpunim më efikas ndërinstitucional në pajtim me kompetencat e përcaktuara në dispozitat ligjore. Ndërkaq, si sfidë u paraqit problemi i mosekzekutimit të vendimeve të OSHP-së nga autoritetet kontraktuese, të cilat janë gjobitur me gjobë duke u arsyetuar në pritjen e vendimeve të Gjykatës Supreme, si instancë e fundit.

Komisioni shqyrtoi edhe raportin financiar të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2011. OSHP-së i janë ndarë me Ligjin për buxhet 273.308 euro, kurse janë shpenzuar 230.991 euro apo 84%. Komisioni vlerësoi se raporti është i detalizuar dhe i përmbush kushtet e parapara për raportim sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

KBF ka vlerësuar se raporti vjetor i OSHP- i përmbush kushtet ligjore të raportimit të parapara me LPP dhe i ka rekomanduar Kuvendit ta miratojë raportin.

(Safete Hadergjonaj, d.v.)

KRYETARI: Faleminderit!

Diskutuesja e fundit është deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: I nderuar kryetar,

Përfaqësues të qeverisë,

I nderuar ministër se paske mbetur vetë,

Të nderuar kolegë deputetë,

U fol shumë se korrupsioni në Kosovë është vetëm perceptcion. Por ju lutem në çfarë baze formohet perceptcioni për korrupsionin kur kemi zyrtarë të lartë nën hetime për korrupsion, kur na arrestohet prokurori i shtetit kreu u Taks-Forcës, atëherë si ka të mos jetë, kur shpërblehen familjarë dhe militantë të partish me tender si ka të mos ketë perceptcion për korrupsion, në këto baza formohet perceptcion. Edhe këtë perceptcion e ka gjithë bashkësia ndërkombëtare për neve. Nëse Kosova më herët është shquar si për popull të durueshëm, si vend që po lufton për liri dhe pavarësi, tash këto janë harruar, ne po shquhemi në botë si popull me nivel të lartë të korrupsionit. Kudo që shkojmë jashtë edhe në takimet e larta diplomatike, neve e para që na përplasen fytyrës nga homologët

tanë, është se duhet ta luftojmë më shumë korrupsionin, e çka i bie kjo: “ju jeni burra të mirë, por ju lutem mos vidhni.”

Kur flasim për OSHP-në flasim për tenderë, kur përmenden tenderët e para gjë që na vijnë në mend është pasurimi i shumë politikanëve dhe shndërrimi i tyre në milionerë. A thua qysh, kah? Me rroga 300 euro, 500 euro dhe 1.000 euro, si ka mundësi që dikush të shndërrohen në milionerë? Përmes tenderëve politikanët dhe zyrtarët e thjeshtë u bënë milionerë, ndërkohë që qytetarët tanë taksapagues ngelën me rrugë që nuk ëndërrojnë as edhe një dimër, me shëndetësi pa ilaçe, me shkolla pa libra dhe me pak ose me hiq përkujdesje sociale.

T’ju kujtoj vetëm një gjë, pas publikimit të indeksit të korrupsionit për vitin 2011, të cilin nuk e bëri LDK-ja, por e bëri Transparency International në Prishtinë, erdhi zëvendësudrejtori ekzekutiv i këtij institucioni Miklos Marschall i cili erdhi me të vetmin qëllim që faktet e publikuara t’ua deshifroj me fjalë të tjera përgjegjësve të institucioneve tona. Dhe, më duhet të citoj çfarë ai tha: “Ai tha se pavarësisht disa reformave që ka bërë Kosova, korrupsioni në Kosovë vazhdon të mbetet pjesë e sistemit. Unë- tha porosis udhëheqësit vendorë që të ven si prioritet luftimin e korrupsionit, por jo vetëm me fjalë. Kosova ka potencial ta luftojë korrupsionin, por duhet vullnet e ky vullnet nuk mund të krijohet përderisa njerëzit po pasurohen përmes politikës dhe kjo është çka më brengos më së shumti. Duhet ta dinë politikanët tuaj se politika nuk është për t’u pasuruar. Më tutje Marschall tha se gjithkund ka korrupsion, korrupsion ka edhe në Gjermani, po atje nuk është pjesë e sistemit e në Kosovë tha: “ korrupsioni është pjesë e sistemit”. Si mund të përkthehet kjo në kontekstin e OSHP-së. OSHP-ja si organ i pavarur bën shqyrtimin e ankesave, kryesisht të operatorëve ekonomik që nuk fitojnë kontrata nga agjencionet kontraktuese dhe mendojnë se u është bërë e padrejtë. Sa ka padrejtësi, se si bëhet shpenzimi i parasë publike, se kush janë kompanitë që shpërblehen me tender, këtë e dimë ne të gjithë.

Unë kërkoj falje që po dal jashtë raportit dhe asaj çka është shkruar, por këtë të drejtë ia jap vetes duke u nisur nga ajo se nuk ka institucion në Kosovë që e kritikon vetveten në një raport pune. E ne duhet ta pyesim veten. A e ka krye OSHP-ja punën si duhet? A është e vërtetë se kompanitë, pra operatorët ekonomikë nëse nuk e fitojnë tenderin në Agjencionin kontraktues, shkojnë në OSHP, paguaj 10% ose më shumë, OSHP-ja anulon tenderin dhe shpërblen këtë të fundit. Këtu ka diçka të vërtetë, përndryshe nuk do të kishte nivel kaq të lartë të korrupsionit që sipas Transparency International ne jemi të renditur te 112, sa më poshtë që jemi në listë aq më i lartë është korrupsioni.

Ka plot raste që janë raportuar nga mediat se si shpërblehen me tenderë militantë partish, familjarë, ministrat dhe çka ka bërë OSHP-ja, absolutisht asgjë? Sa i besueshëm është ky institucion e tregon edhe numri i kompanive që ankohen në këtë institucion.

U tha edhe më herët dhe më duhet t’i përsëris faktet. Prej 12 mijë e 310 kontratave ka pasur vetëm 419 ankesa që është diku rreth 13%. Numri i ankesave ka ra për 28%, derisa perceptcioni për korrupsionin po mbetet i njëjtë. Nga këto raste 190 OSHP-ja i ka aprovuar vendimet, 106 raste OSHP-ja ka marrë vendim për rivlerësim që u tha edhe më

herët dhe 71 raste OSHP-ja ka marrë vendim për anulim të tenderit, do të thotë për ritenderim. Pra, OSHP-ja ka shqiptuar vetëm 7 gjoba gjatë këtij viti në shumën prej 130 mijë euro, këto gjoba nuk janë arkëtuar asnjëherë. Shkurt shqip i bie që çdo e dyta ankesë në OSHP ka pasur drejtë, atëherë lind pyetja pse nuk ankohen edhe operatorët tjerë ekonomikë kur kemi një nivel kaq të lartë për perceptcionit për korrupsionin. E përgjigja është sepse ankesat bëhen me negociim, nëse kompanitë gjejnë njerëz të negociojnë për përqindje të caktuar në OSHP, atëherë e dorëzojnë ankesën, përndryshe nuk kanë pse ta dorëzojnë.

Ajo çka është paradoksale është se përfaqësuesi i OSHP-së tha se me veprimet që i kemi bërë ia kemi kursye buxhetit të Kosovës rreth 4 milionë, e unë pyes- sa është dëmtuar buxheti i Kosovës? Dëmtimi i buxhetit të Kosovës kap shumë e pasurimit të paligjshëm të gjithë atyre që po abuzojnë me ligjin e ky dëm nuk është as 4 milionë, as 40 milionë, por është shumë më shumë.

Agjencionet kontraktuese dhe OSHP-ja fshehën pas justifikimeve të ndryshme për veprimet e tyre kur shpërblejnë kompanitë jomeritore. Nëse marrin për bazë çmimin më të lirë, thonë që këtë e bëjnë për ta kursye buxhetin e Kosovës, nëse marrin çmimin më të shtrenjtë, thonë se këtë e bëjnë për hirë të kualitetit.

Ne mendojmë se OSHP-ja dhe plot institucione tjera nuk po e kryejnë punën e vet. Kosova nga bota po shihet si vend i korruptuar me një elitë politike që po ndiqet për krime ekonomike. Derisa në Kosovë ka kaq shumë korrupsion, derisa institucionet si OSHP-ja nuk e kryen punën e tyre, është e padobishme të bëhen reforma në përmirësimin e ambientit të biznesit. Investitorët e huaj po ikin nga Kosova, pikërisht për shkak të korrupsionit, duhet të luftohet korrupsioni, por jo me deklarata por me veprime konkrete.

Dhe, skandali i fundit, arrestimi i prokurorit të shtetit kreut të Taks-Forcës kundër korrupsionit duhet t'i shërbejë kësaj Qeveria që t'i ndërpres praktikën që ta luftojë korrupsionin më të korruptuar, sepse korrupsioni nuk luftohet me njerëz të korruptuar. Dhe, të gjithë ata që mendojnë që nuk ka korrupsion në Kosovë, ju lutem urdhëroni dhe votojeni raportin e OSHP-së. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit, deputete!

Gjysmën e fjalës e ke pasur jashtë rendit të ditës. E kemi një raport që ke qenë pjesë e këtij Komisioni, që e ka bërë raportin me rekomandime, ishte anëtar i Grupit të juaj që foli në emër të grupit dhe tha krejt fjalë të tjera, askush nuk po thotë që në Kosovë nuk ka korrupsion, por ne këtu si deputetë nuk jemi të merremi me perceptimet. Ne e kemi një dokument edhe flasim mbi bazën e dokumentit që e kemi përpara. Përndryshe, zonja deputete edhe Prishtina është gjysma e Kosovës dhe nuk i shkruhet as asaj bash mirë, por ne nuk mund të flasim përsëri mbi bazën e perceptimeve, por flasim mbi bazën e një dokumenti që e kemi dhe ju kisha kërkuar si deputetë t'i përmbaheni raportit me rekomandime, pjesë e të cilit Komision keni qenë edhe ju.

9. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2011

Raportin vjetor i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2011 e ka shqyrtuar Komisioni funksional dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Kryetarja e Komisionit funksion për Buxhet dhe Financa, Safete Hadergjona, për arsyetim të raportit me rekomandime.

SAFETE HADERGJONAJ: Falemnderit, zoti kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më datën 2 prill të vitit 2012, shqyrtoj Raportin vjetor për vitin 2011 të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, ku ishte i pranishëm edhe kryetari i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe vlerësoi se Raporti është përmbajtësor, teknikisht i përgatitur mirë si dhe përmban të gjitha të dhënat të cilat duhet të raportohen sipas Ligjit për prokurimin publik.

Në raport janë përfshirë numri i kontratave të nënshkruar, vlera e kontratave të nënshkruar sipas burimit të financimit, llojit të prokurimit, sipas vlerës së prokurimit, sipas procedurave të prokurimit, aneks-kontratave, vlera e kontratave sipas operatorëve ekonomik, sipas afatit kohor për publikim dhe sipas kriterëve për dhënien e kontratave.

Janë analizuar aktivitetet e prokurimit publik që ka ndodhur në vitin 2011 dhe të dhënat e prezantuara janë paraqitur duke i krahasuar me vitet paraprake 2010 – 2009.

Numri i kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2011 është 12 mijë e 310. Gjatë vitit 2011 janë evidentuar edhe kontratat kornizë nga autoritetet kontraktuese ku janë diku 201 kontrata kornizë. Pjesëmarrja e prokurimeve publike në bruto produktin vendorë është 16,96. Përdorimi i procedurës së hapur në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara është 82.80%, shihet që se është procedura e përdorur më së shumti dhe e njohur si procedura më transparente.

Pjesëmarrja e procedurës së negociuar, pa publikim të njoftimit të kontratës është në zvogëlim e sipër. Në vitin 2011 kjo procedurë është përdorur vetëm në 6.21%, në vitin 2010 7.02%, në vitin 2009 10.88% dhe në vitin 2008, ka qenë 16.7%, çka shihet se ka tendencë të rënies së kësaj procedure krahasuar me vitet paraprake.

Përdorimi i procedurës së hapur dhe zvogëlimi i procedurës së negociuar, pa publikim të njoftimit të kontratës, janë indikatorë mjaftë pozitiv për sistemin e prokurimit për ekonominë e Kosovës dhe për të ardhmen e asaj drejtë integriteteve Evropiane.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik i ka kushtuar kujdes mirëmbajtjes së faqes informative në internet, që i ofron publikut qasje të pakufizuar në të dhëna dhe është përqendruar në zbatimin e procedurave dhe rregullave që promovojnë prokurimin efikas dhe zhvillimin e prokurimit elektronik dhe komunikimit brenda fushës së prokurimit publik.

Janë paraqitur edhe disa rekomandime tjera për mundësinë e ndërmarrjes së masave për përmirësimin dhe avancimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, në bashkëpunim me Konzorciumin Planet, të financuar nga Komisioni Evropian ka finalizuar 85% të legjislacionit dytësorë të nevojshëm për implementimin e Ligjit të prokurimit publik, i cili legjislacion dytësor ka hyrë në fuqi më 1 janar të vitit 2012.

Në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka bërë ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të prokurimit duke organizuar trajnime për 521 zyrtarë të prokurimit.

Ligji i prokurimit publik e obligon Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik të bëjë trajnime për nivelin e avancuar. Sipas kësaj kërkesë Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka filluar të organizojë trajnime për nivelin e avancuar për të gjithë zyrtarët që kanë kryer trajnimet themelore.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka bërë edhe monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të Ligjit të prokurimit publik dhe rregullave të nxjerra nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit, ku janë bërë 40 monitorime të autoriteteve kontraktuese në 210 aktivitete të prokurimit. Nga monitorimi është vërejtur se ka pasur mosrespektim, kryesisht të neneve 7, 8, 27, 40, 52, 57, 50 dhe 60.

Nga anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa është ngritur çështja e mos raportimit të tri komunave veriore, komunës së Zubin Potokut, Leposaviqit dhe Zveçanit dhe masave që ka ndërmarrë Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik që edhe këto 3 komuna të cilat e shfrytëzojnë buxhetin, të raportojnë për procedurat e prokurimit.

Përfaqësuesit e Komisioni Rregullativ të Prokurimit Publik kanë njoftuar se janë bërë përpjekje dhe janë marrë masa konkrete që të kontaktohet me zyrtarët e prokurimit të këtyre komunave, por nuk kanë pasur mundësi dhe qasje për shkak të rrethanave politike.

Deputetët kanë treguar interesim, domethënë anëtarët e Komisionit për Buxhet kanë treguar interesim dhe kanë kërkuar sqarim nga ana e Komisioni Rregullativ të Prokurimit Publik, për çështje të ngritura në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, për mos nxjerrjen e mjaftueshme të legjislacionit dytësor, për mospërdorimin e kontratave kornizë.

Kryetari i Komisioni Rregullativ të Prokurimit Publik ka njoftuar se është nxjerrë i gjithë legjislacioni dytësor që është i nevojshëm për prokurimin publikë. Ndërkaq, sa i përket kontratave kornizë u raportua se vërejtja e Komisionit Evropian nuk i referohet përdorimit të kësaj kontrate si instrument ligjor, por vërejtjet e Komisionit Evropian në këtë drejtim kanë të bëjnë me prokurimet e centralizuara që i referohen Agjencisë Qendrore të Prokurimit, apo ato që njihen si prokurime të përbashkëta.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka rekomanduar Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, të ketë bashkëpunim më të mirë me organe tjera të prokurimit dhe Agjencionin Kundër Korrupsionit dhe të zgjerojë aktivitetin në monitorimin e llojeve të kontratave të prokurimit, pasi që kjo ka qenë edhe një kërkesë që ka dal nga Raporti i Progresit.

Në përgjithësi nga të dhënat faktike të prezantuara dhe sqarimet e ofruara, u vlerësua se kemi përmirësim në fushën e prokurimit publik.

Komisioni vlerësoi të nevojshëm të bëhet një monitorim i fushës së prokurimit në mënyrë që të verifikohet realiteti i fushën e prokurimit, sepse bazuar në fakte që prezantohet mund të kontribuojë në ndryshimin e perceptimit për korrupsion e kështu do të kontribuohet edhe në të mirë të vendit tonë.

Komisioni shqyrtoi edhe raportin financiar të Komisioni Rregullativ të Prokurimit Publik. Nga 326 mijë e 523 euro të planifikuara, ky Komision ka shpenzuar 279 mijë e 468 euro, apo 85.59% të buxhetit.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e vlerësoi raportin si të detalizuar dhe që i përmbush kushtet të cilat janë paraparë me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.

Në fund Komisioni për Buxhet dhe Financa ka konstatuar se raporti vjetor i Komisioni Rregullativ të Prokurimit Publik, i përmbush kushtet ligjore të parapara me nenin 87, paragrafi 2.13 të Ligjit numër 04/L-042 të prokurimit publik në Republikën e Kosovës dhe Komisioni i rekomandon Kuvendit që të miratojë raportin vjetor të këtij Komisioni për vitin 2011. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Tani është radha në emër të grupeve parlamentare. Kisha kërkuar që të mos zgjatin më shumë se 5 minuta se mendoj që janë të mjaftueshëm për të thënë atë që duhet thënë. Fjalën e ka në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetja Hasime Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Falemnderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është pro këtij raporti dhe kërkon edhe një angazhim më të madh nga KRPP që të monitorojë dhe të mbikëqyrë të gjitha aktivitetet e prokurimit publik dhe menaxhimit të kontratave me qëllim të zbatimit të Ligjit të prokurimit publik në dobi të autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomikë. Falemnderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Pak më i relaksuar , unë po flas sot, në emër të LDK-së. Faleminderit, kryetar!

KRPP-ja ka vepruar në bazë të Ligjit të prokurimit publik që parashihet për raportime vjetore të cilat edhe i ka prua me kohë të cilën komisioni i ka shqyrtua dhe normalisht edhe ne i kemi diskutuar në Grupin Parlamentar të LDK-së.

Raporti përmban për vitin 2011 numrin e kontratave të nënshkruara, vlerën e tyre, llojin e prokurimeve, të gjitha këto janë të krahasueshme, domethënë, është përdorë metoda komperative që mund të bëhet krahasimi prej viti në vit që është shumë e dobishme për analiza të mëtutjeshme.

Shihet që janë nënshkruar diku rreth 12 mijë e 300 kontrata me një vlerë prej 552 milionë euro, plus kontrata për autostradën që diku domethënë janë mbi 730 milionë euro për vitin 2011. Këto kryesisht kanë qenë kontrata me procedurë të hapur apo respektivisht 82.80% të kontratave kanë shkuar në këtë procedurë, ndërsa të tjerat janë proceduar me negocim. Të kemi parasysh në dy forma të negocimit, domethënë kur publikohet njoftimi i kontratës dhe kur nuk publikohet njoftimi i kontratës. Nga këto janë 73.29% të kontratave që iu kanë përmbajtur afateve kohore sipas ligjit dhe pjesa tjetër 26.71 janë me afate të shkurtuara, por të gjitha këto janë të normuara me ligj janë brenda ligjit.

Është mjaft brengose që edhe më tutje po vazhdon që tri komunat e Republikës së Kosovës nuk po raportojnë dhe këto tri komuna: Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi nuk kenë pjesë e raportit që është shumë brengose, për arsye se këto marrin parandë publike, parandë e taksapaguesve kosovarë, ndërsa nuk japin ndonjë llogari apo ndonjë raportim lidhur me shpenzimet të cilat i marrin nga buxheti i Kosovës.

Është një e mirë që ka filluar të përdorët kontrata kornizë, një metodë mjaftë e avancuar, mjaftë e mirë dhe shpresojmë që kanë me u vazhdua edhe më tutje nga KRPP-ja. Unë e di që mund të ketë shumë shqetësime por ky është institucion i cili ka për obligim zbatimin e ligjit dhe nuk është një organ i cili pritët nga ky që ta luftojë korrupsionin. Unë besoj që organet tjera kompetente duhet ta mbikëqyrin KRPP-në në zbatimin e ligjit, por nuk mund të thirremi që KRPP-ja të luftojë korrupsionin. Deputetët kanë të drejtë edhe besoj që edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe çdo deputet tjetër, të bëjë monitorime të cilitdo kontratë prej 12 mijë kontratave dhe nëse ka dyshime të shkojë deri në fund dhe atë t'ia paraqes Kuvendit dhe prokurorit që të ndiqet nëse gjendet dhe besoj që në këtë sasi të madhe të kontratave mund të ketë edhe parregullsi.

Sa i përket shpenzimeve të buxhetit që e tha kolegja ime Hadergjonaj, këta kanë shpenzuar në nivelin e 95.41%, të buxhetit të paraparë, është një përqindje e cila mund të konsiderohet si e balancuar me planifikimin buxhetor i cili ka qenë për këtë institucion. Falemnderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Falemnderit, deputet! Në emër të “Vetëvendosjes, kush e do fjalën?
Deputetja Albana Fetoshi e ka fjalën.

ALBANA FETOSHI: Falemnderit, zoti kryesues!

Sa i përket Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, unë do ta kisha ngritur vetëm një çështje që ka të bëjë me tri autoritetet kontraktuese që janë nga komuna e Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit, të cilat nuk i kanë paraqitur raportet vjetore në

Komisioni Rregullativ të Prokurimit Publik. Mendoj se kjo është një problem goxha i madh që të mungojnë këto raporte vjetore për shkak se mund të bëhet praktikë që këto autoritete kontraktuese të këtyre komunave edhe në vitet e mëtutjeshme, të mos i paraqesin këto raporte vjetore, kështu që mendoj që dikush duhet ta marrë përgjegjësinë për mungesën e tyre raporteve në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik. Falemnderit!

KRYETARI: Pasi të njëjtën gjë e tha tre deputetë dhe unë po them për ato tri komunat është dashur të jetë një rekomandim, por ju në bazë të kësaj që rekomandimet që i keni dhënë gjithçka është në rregull. Në emër të Aleancës kush e kërkon fjalën? Deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Falemnderit, zoti kryetar!

Jo edhe unë do të ndalem në atë që ju e thatë për rekomandim. Rekomandimi po dihet mund të dalë edhe nga seanca, nëse ne jemi të zotët të mos u japim buxhet atyre tri komunave, atëherë do të kishte me qenë në rregull edhe nuk do ta shqyrtojmë fare, unë s'do ta analizoj fare organet tjera dhe komunat tjera të cilat i kanë dorëzuar raportet, kur skemë të drejtë t'i kërkojmë tri raporte, në tri komuna tjera dhe as s'i përgjigjen këtij organi, atëherë nuk e di edhe pse t'i shqyrtojmë.

Ndërsa atë që e tha zoti, nënkryetar Naser Osmani, secili deputet e ka materialin, nëse dyshon diçka mund të shkon deri në fund për zbatueshmërinë e ligjit të këtij organi. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit!

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Zoti kryetar,

Nejse, edhe prapë po i bie shkurtë, por ne po flasim këtu. Para se të kaloj këtu konkretisht dua të them rreth problemit të perceptimeve. Perceptimet janë perceptime dhe perceptimet krijojnë pasoja të caktuara. Në qoftë se ne kemi perceptimet një anë e gjenden në anën tjetër, domethënë ne nuk po bëjmë asgjë që të krijojmë imazhin e vërtetë, por politikat gjithkund në botë krijohen në bazë të perceptimeve se perceptimet flasin shumë.

Çështja tjetër që është këtu me rëndësi, ky raport është mjaftë cilësor, sepse na jap shumë të dhëna për ta parë situatën ku e kemi. Dhe, situata, ne mund të themi që operacioni është i suksesshëm, por pacienti s'i ka punët mirë, të kuptohemi.

Çështja tjetër ka të bëjë me këtë procedurën e negocimit ose të kufizuar ose krejtësisht me negociata. Ne lavdërohem se i kemi 80%, kjo është krejt në rregull, por në qoftë se shihni ku janë, ne duhet t'i shohim, duhet të analizohet situata në KEK, për arsye se në qoftë se i shihni në cilat organizata i kemi këto procedura të shpejtuara ose procedura të negocimit, të pjesërishtë ose tërësishtë, ju do të shihni që 90% të këtyre janë në KEK, atje ndoshta urgjenca ndonjëherë krijon probleme, por nuk jam i sigurt që gjithmonë kem të bëjmë me urgjencë.

Prandaj, mendoj se vështirë është që gjatë diskutimit të raportit ne t'i zgjidhim krejt problemet e korrupsionit, por raportet i ndikojnë diçka edhe Kuvendi nuk besoj që nuk duhet ta merr një rol shumë të rëndësishëm në monitorimin e harxhimit të parasë publike dhe luftimin e korrupsionit.
Falemnderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputet, e di çka është, mendoj se çdo njëri prej neve e dinë çka është perceptioni, mirëpo ne po kemi raporte konkrete, një. Dy, për të biseduar dhe debatuar për korrupsionin e perceptcionit, 6 deputetë mund ta bëjnë kërkesën për debat dhe debatojmë. Tjetër, me Kushtetutë e keni 40 deputetë mund ta formojnë një komision hetimor për të shkuar dhe për gjurmuar se vërtet cila gjendje është në secilin institucion që i përgjigjet Kuvendit të Kosovës, ose zgjidhet nga Kuvendi i Kosovës. Prandaj, si deputetë ne duhet t'i kryejmë do detyra e përgjegjësi tjera. Por po ju them këtu ne nuk kemi të drejtë të flasim për perceptcionin, ne flasim për dokumentin që e kemi, raportet që ka ardhur nga Komisioni dhe Komisioni ka raportuar për t'i miratuar. Prandaj, ne gjithnjë po flasim për çështje që konkrete për çështje tjera, deputetët, secili grup me 6 vetë ka të drejtë ta shtrojë çështjen në rend të ditës dhe e diskutojmë nëse kemi material për të diskutuar. Por edhe te marrëveshjet që po bëhen me jashtë nuk e di a janë krejt perceptcion a jo. Deputeti Ali Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Me që u tha edhe jem kah fundi, po e shoh se edhe janë të lodhur njerëzit edhe interesimi ka rënë do t'i ngre vetëm disa pika që mendoj se, po i pres deri ta kryejnë, s'ka problem. Nga 12 mijë e 310 kontrata publike, 1183 kanë qenë aneks kontrata, çka i bie se çdo i 10-ti rast ka shkuar me aneks kontratë. Ligji e ka paraparë edhe këtë mundësi, por ky nivel është i lartë dhe unë mendoj se duhet hulumtuar.

Një çështje tjetër që po ashtu në pika që shkurtat desha ta ngrit. Nënshkrimi i kontratave sipas afateve kohore me afat normal janë nënshkrua 404.6 milionë euro ose 73.29%, ndërsa me afat të shkurtuar janë nënshkruar 147.5 milionë euro, shprehur në përqindje 26.71, duke mos e përfshirë autostradën Merdar – Morinë. Mendoj se edhe kjo në veçanti për pozicionin e parë te aneks kontratat, shtrohet dilema nga u siguruar fondet dhe a janë siguruar fondet për ato aneks kontrata. Po e them sepse shumë herë gjejmë operatorë ekonomikë ose shfrytëzues buxhetorë që hynë në obligime pa mbulesë, kjo duhet të jetë një objektiv i hulumtimit.

Dhe pika e tretë, vlera e kontratave të nënshkruara sipas kriterit me çmim ekonomik më të lartë, shihet se dominon 84.55%, në raport me 15.46%. Analizuar mund të na duket se është mirë, por këtu mungon njësia matëse e përmbushjes së standardeve të këtyre kontratave. Shumë herë në emër të kontratës për çmim ekonomik më të favorshëm apo më të ulët, më të ulët në rastin konkret, kemi shumë herë që standardet nuk përmbahen dhe korrupsioni zakonisht këtu mendohet se është.

Dhe, krejt në fund duke mos dashur t'ju lodh shumë, mendoj se duhet ta kemi një rekomandim për KRPP-n, në shumë organizata buxhetore hartimi apo formimi i dosjes së tenderit, në veçanti ruajtja e dosjes së tenderit mungon, çka nënkupton se nëse dom ta

bëjmë një analizë çfarë ju kërkuat, zoti kryetar, në shumtën e rasteve ti s' do të mund të vish deri te të dhënat konkrete, sepse mungojnë dosjet. Pra, motivi im është këtu që Kuvendi duhet t'i rekomandojë KRPP-ës që ta nxjerrë një legjislacion dytësor ku i obligon organizatat ekonomike në formën e formimit të dosjes dhe në veçanti në ruajtjen e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Replikë ka kërkuar deputeti Muhamet Mustafa!

MUHAMET MUSTAFA: Jo replikë, por desha me thënë se ne i kemi këto raporte, por edhe i kemi raportet e Auditorit gjeneral. Në secilin prej atij raporti, ka vërejtje substanciale në procedura të prokurimit. Edhe ai është dokument, prandaj ky Kuvend duhet t'i ketë parasysh të gjitha dokumentet dhe duhet të preokupohet seriozisht me këtë çështje. Këtë desha ta theksoj.

KRYETARI: Edhe unë, në një masë, jam dakord. Dhe ky Komisioni rregullativ i prokurimit publik, realisht e ka të drejtën me ligj për t'i mbikëqyrë të gjithë prokurimin publik, dhe me i bë diku bashkë, e pse nuk funksionon është çështje e tij, por në raport me rekomandime, s'e keni thënë.

(Ndërhyrje)

Prandaj, po kalojmë edhe në pikën e fundit, e pastaj, besoj se na vijnë deputetët t'i votojmë të gjitha këto raporte.

Pika e dhjetë:

10. Shqyrtimi i Strategjisë dhe planit të veprimit kundër korrupsionit për periudhën 2012-2016.

Komisioni për legjislacion e ka shqyrtuar Propozim-strategjinë dhe planin e veprimit kundër korrupsionit për periudhën 2012-2016 dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandimin për shqyrtim në mbledhje plenare.

Përfaqësuesi i Qeverisë, nuk është këtu! Kryetari i Komisionit legjislativ, Arben Gashi, nuk është!

Atëherë, shkojmë me radhë, diskutimi në emër të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e kërkon fjalën? Për fjalë është lajmëruar Fatmir Xhelili!

FATMIR XHELILI: Unë jam lajmëruar, po dua të diskutoj individualisht, për atë arsye se Behari është anëtar i Komisionit....

KRYETARI: E në emër të Grupit, kush e do fjalën? Deputeti Behar Selimi, e ka fjalën!

BEHAR SELIMI: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, e ka shqyrtuar Strategjinë e planin e veprimit dhe Kuvendit i rekomandon ta aprovojë Strategjinë dhe planin e veprimit.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, deputetja Vjosa Osmani, e ka fjalën!

VJOSA OSMANI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Natyrisht se Qeveria, nuk është këtu!

A po befasohet ndokush? Natyrisht, se askush nuk befasohet! Dhe natyrisht që askush nga PDK-ëja nuk flet për strategjinë antikorrupsion, sepse nuk janë të interesuar që ta luftojnë korrupsionin.

Mirëpo, ne kemi shumëçka për të thënë, në veçanti për këtë strategji. Kjo strategji natyrisht se është ndërtuar, thuhet ashtu së paku, duke pasur parasysh sfidat që kanë dalë nga “implementimi” në thonjëza i Strategjisë 2009-2011. Një ndër sfidat kryesore në implementimin e kësaj strategjie, thuhet të jetë mungesa e mbështetjes dhe mungesa e angazhimit të fortë për të zbatuar objektivat dhe masat e strategjisë dhe planit të veprimit, nga udhëheqësia e lartë. Nga udhëheqësia e lartë, do të thotë ka munguar vullneti politik për ta luftuar korrupsionin dhe kjo ka qenë sfida kryesore.

Si rregull, në çdo vend normal dhe në çdo institucion normal, ajo sfida kryesore që ka qenë për vitin 2009 – 2011, pastaj bëhet objektiv primar, apo objektiv numër 1 për strategjinë 2012 – 2016.

Por, cili është objektivi primar për Strategjinë 2012 – 2016? Në këtë strategji, thuhet: është ngritja e besimit të publikut në institucionet. Kinse problemi qenka te publiku e jo te institucioni që është i korruptuar. Shkojmë më tutje!

Deputetë të nderuar,

Pasqyra e Republikës së Kosovës sot, është pasqyrë e një Kosove të korruptuar, dhe kjo është shumë e qartë, dhe kjo pasqyrë ndërtohet pikërisht përmes veprimeve siç ka qenë emërimi i task-forcës antikorrupsion nga ana e kryeministrit, udhëheqësin e të cilit institucion, ne e dimë ku është.

Përndryshe, roli i këtij institucioni, roli i Kuvendit në Strategjinë antikorrupsion, vetëm sa është minimizuar. Dhe, po e përmendi një shembull.

Në këtë strategji, zoti kryetar i Kuvendit, thuhet se “në mënyrë që Kuvendi ta luajë rolin e vet mbikëqyrës për antikorrupsion, po u dashka me u lidhë një dekret në mes të Kuvendit dhe Qeverisë”, një praktikë shumë e çuditshme kjo. A ka vërtet nevojë për dekret në mes të Kuvendit dhe Qeverisë, në mënyrë që të zbatohet praktika e mbikëqyrjes parlamentare? Jo! Sepse ky është obligim kushtetues, dhe ne të gjithë e dimë.

E treta. Thuhet që një veprim, që duhet të ndërmerret dhe që do të ndihmonte në luftimin e korrupsionit, është konfiskimi i pasurisë së paligjshme. Dhe, si veprim konkret, është

përmendur miratimi i Ligjit për konfiskimin e kësaj pasurie që në këtë strategji thuhet se është miratuar.

Zoti kryetar, ju e dini, dhe secili deputet që sadopak e përcjell punën e këtij Kuvendi, e di që Ligji për konfiskimin e pasurisë së paligjshme, nuk është miratuar në këtë Kuvend.

Në tërësi, kjo është një strategji e kotë! Kjo është një strategji që nuk e ka ndërmend të paraqesë masa konkrete për luftimin e korrupsionit. Kjo është një strategji që edhe një herë tregon se cili është vizioni i Qeverisë Thaçi për luftimin e korrupsionit dhe ai është i kundërt, është vizion për ta mbështetur korrupsionin, e jo për ta luftuar atë. Dhe, besoj që s'kam nevojë që ta sqaroj se cila do të jetë vota e LDK-ës për këtë strategji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Vetëvendosjes, deputetja Albulena Haxhiu, e ka kërkuar fjalën!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

(Polemikë)

Po pres deri sa të qetësohen pak! Nuk është befasuese kjo qasje jo serioze e Qeverisë por edhe e deputetëve të pozitës karshi strategjisë kundër korrupsionit. Madje edhe votimi i kësaj strategjie, kur është bërë në Qeveri, është bërë pa asnjë vërejtje konkrete. Pra, Qeveria e ka votuar këtë strategji për ta sjell në Kuvend, mirëpo nuk e ka bërë asnjë vërejtje konkrete. Dhe, arsyet dihen pse!

Komisioni për legjislacion nuk e ka votuar këtë strategji. Pra, rekomandimi i Komisionit për legjislacion ka qenë që të mos e miratojë këtë strategji, por t'ia kthejmë Agjencionit kundër korrupsionit.

Fillimisht strategjia kundër korrupsionit 2012-2016 tregon se si nuk luftohet korrupsioni.

Unë do të doja të sjell në vëmendjen tuaj faktin që ne kishim një strategji kundër korrupsionit për vitet 2009 – 2011, e cila ishte një strategji me shumë dobësi, pa kurrfarë analiza paraprake e cila nuk prodhoi asnjë rezultat.

E njëjta strategji, siç ishte e viteve të kaluara, e njëjta na është sjellë për vitet 2012-2016. Pra po flitet për një strategji pesëvjeçare e cila është një strategji koti dhe në këtë strategji shohim vetëm shifra e tabela, por asgjë konkrete.

Agjencia kundër korrupsionit dhe të gjitha institucionet tjera, duhet ta kenë të qartë që strategjia pesëvjeçare kundër korrupsionit nuk bëhet me dy-tri ditë pune intensive në Ohër, ashtu siç e kanë shkruar në raport.

Edhe OJQ-ët në vitet e para të pas luftës, kanë qenë më serioze në strategjinë e tyre se sa që është tani Agjencioni kundër korrupsionit.

KRYETARI: Ju lus deputetë, për qetësi!

ALBULENA HAXHIU: Në këtë strategji nuk janë marrë fare parasysh çështjet më të rëndësishme. Pra Agjencioni kundër i kundërkorrupsionit nuk e ka bërë ndonjë studim – hulumtim të raporteve të cilat e tregojnë natyrën, shkaqet e korrupsionit dhe shkallën e nivelit të korrupsionit në Kosovë. Gjithashtu, Agjencioni kundër korrupsionit nuk ka bërë ndonjë analizë të thuktë mbi mos zbatueshmërinë e strategjisë kundër korrupsionit 2009-2011. Pra ky raport është tejet sipërfaqësor dhe për keqardhje.

Po ashtu, mbetet shqetësues fakti i mos përfshirjes së vërejtjeve dhe rekomandimeve të shoqërisë civile në këtë strategji. Në raport thuhet se shoqëria civile ka qenë pranishme mirëpo asnjë vërejtje dhe rekomandim i tyre nuk është marrë parasysh. Pra, mungesa e kësaj qasje gjithëpërfshirëse e bën edhe më të mangët këtë strategji.

Kjo agjenci nuk ka qenë efikase në luftën kundër korrupsionit, pavarësisht shifrave që paraqet dhe kemi thënë disa herë, e po e përsëris prapë, se Agjencioni kundër korrupsionit është shndërruar në një institucion ku vetëm dërgohen deklaratimet e zyrtarëve të lartë, pra deklaratimet e pasurisë. Dhe me apo pa këtë strategji korrupsioni në Kosovë në vazhdimësi po rritet dhe nuk ka një denoncim të korrupsionit si një e keqe shoqërore dhe dëmet që po na i shkakton, e dihet se Qeveria aktuale është shkaktare e saj.

Në fund, ajo çka qytetarët e Kosovës presin, është që Agjencioni kundër korrupsionit të na sjell rezultate konkrete përmes denoncimit të aferave korruptive, nga niveli lokal deri te majat më të larta të shtetit. Pra, deri te Qeveria, e jo të na sjell një strategji të kotë të cilat plotësojnë një tregues në raportin e progresit.

Pra, këtë strategji si të tillë, ne si subjekt, nuk do ta mbështesim, pasi që mbështetja jonë për këtë strategji do të ishte në fakt pajtim me gjendjen e tanishme dhe heqje dorë nga luftimi i korrupsionit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Në emër të Aleancës, a ka të interesuar për fjalë? Deputeti, Burim Ramadani e ka fjalën!

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Kjo strategji e cila është miratuar nga Qeveria e Kosovës më 11 janar 2012 realisht fjalët më të këqija të mundshme i flet për Qeverinë e Kosovës dhe i flet për lidërsipin e Qeverisë së Kosovës. Dhe është çudi, vërtet çudi se si njerëzit edhe të Qeverisë, por po shihet edhe të koalicionit qeverisës në Kuvend, vërtet nuk e kanë lexuar. Sepse, ky dokument flet keq për Qeverinë, flet fjalët më të rënda të mundshme për Qeverinë, për të cilat unë besoj se është e vërtet dhe janë pak sa janë thënë këtu.

Ja disa elemente. Për shembull thotë, perceptimi i përgjithshëm dhe ky është dokument që e ka miratuar Qeveria e Kosovës. Pra, Qeveria e Kosovës na thotë se perceptimi i përgjithshëm është se edhe pse ka kuadër ligjor, ai nuk respektohet dhe nuk sanksionohen shkelësit e ligjit. Këtë po e dimë!

Sfidat ndaj planit të kaluar 2009-2011, thotë se nuk ka pasur bashkëpunim dhe koordinim ndërinstitucional, thotë se nuk ka pasur proces të mirë të monitorimit dhe duhet, tash duhet pas katër viteve që është kjo Qeveri, duhet të ketë mbështetje të fortë nga udhëheqësia e lartë në institucionet publike. Tash Qeveria neve po na thotë se duhet mbështetje për luftën kundër korrupsionit, pas katër vjetësh se deri tash nuk ka pasur.

Janë pesë prioritete kryesore dhe prioriteti kryesor në faqen 5, të kësaj strategjie, Qeveria thotë se duhet të adresohet niveli i ulët i besimit në institucione publike, në ato politike, gjyqësore dhe në administratë dhe ky është prioritet kryesor në ndërtimin e një shteti të besueshëm që funksionon në interes të publikut. Pra, kjo Qeveri, me këtë dokument po na thotë se publiku në Kosovë nuk iu beson institucioneve publike, duke i përfshirë edhe institucionet publike respektivisht edhe veten. Pra, këta po na thonë se nuk na beson publiku në Kosovë.

Në faqen 20, te objektivat horizontale të strategjisë, ndër të tjera thuhet se institucionet e Kosovës ende nuk kanë plan të duhur të integritetit dhe Zyra e kryeministrit tash ka filluar përgatitjet e nevojshme. Pritet që korniza e ardhshme të sjell integritetin, përveç rregullave etike. Dhe këtu na tregon prapë Qeveria se që 4 vjet nuk ka punuar me i ndërtu këta mekanizma, sikur që është korniza për integritetin në punë, në administratën publike, është fjala.

Në faqe 23, te objektivat specifike për sektorët prioritarë, që është vërtet e çuditshme çka na thotë Qeveria. Thotë, një fushë në të cilën ndërhyrja politike është rrezik për korrupsion dhe është më e dukshme, janë emërimet politike që janë në kompetencë të Qeverisë. Kur të vazhdohet me emërimet në agjenci të ndryshme rregullatore, që rregullojnë bordet e ndërmarrjeve publike e të tjera, Qeveria duhet të dëshmojë transparencë maksimale dhe të miratojë zbatimin e standardeve të caktuara - profesionalizmin, sepse na thotë Qeveria e Kosovës, duke i zbatuar vetëm kriteret politike në emërimet, vazhdohen të ngritën dyshimet e nepotizmit dhe klientalimit. Pra, Qeveria po na thotë se deri tash nuk ka pas kritere profesionale, por ka pasur kritere politike në emërimet politike në këto ndërmarrjet dhe bordet e ndërmarrjeve publike, respektivisht po e pranon se ka nepotizëm dhe klientalizëm.

Në faqen 24, te administrata qendrore, ja çka thotë. Analiza e plotë e situatës, konstaton se korniza ligjore është ende shumë e kompromentuar nga ndërhyrjet politike. Prandaj, po ju them, nuk e kanë lexuar se Qeveria po na thotë që ka ndërhyrje politike në këto elemente. Administratës publike i mungon kanali i duhur i brendshëm për të lejuar raportimin nga denoncuesit pa frikë prej hakmarrjes.

Pra, Qeveria na thotë se në administratë publike njerëzit frikësohen që të raportojnë sepse kanë frikë nga hakmarrja.

Arsimi dhe shëndetësia, sikurse edhe planifikimi hapësinor thotë në Strategji, që është miratuar prej Qeverisë dhe me qëllim po e përsëris shumë herë që me pa edhe këta vetë, vazhdojnë të jenë të ndjeshëm ndaj korrupsionit që ende është duke u konsideruar si i

përhapur. Pra, Qeveria na thotë se në arsim, shëndetësi dhe në planifikim hapësinor ka korrupsion dhe është shumë i përhapur korrupsioni.

Te zbatimi i Ligjit, në faqen 26, tash na thotë se duhet të bëhet prioritet adresimi i korrupsionit brenda gjyqësorit dhe policisë, prokurorisë dhe forcimit të kontrollit të brendshëm dhe mekanizmave disiplinorë, që duhet të jenë prioritet në lidhje me ndërtimin e besimit. Pra, tash na thotë se nuk ka pas prioritet adresimi i korrupsionit në gjyqësi, në polici dhe në prokurori dhe tash e tutje po do jkan me pa se qenka dashur me u adresuar ky problem si prioritet.

Politika dhe masa shtesë kundër korrupsionit duhet të jenë të pranishme në shërbimet korrektuese, të cilat deri tash nuk kanë planifikuar ose zbatuar ndonjë prej masave të tilla. Qe katër vjet kjo Qeveri del na thotë se shërbimet korrektuese asnjë lloj mase kundër korrupsionit as s'kanë planifikuar, as nuk kanë zbatuar dhe tash po fillojnë që të mendojnë e duhet t'ia nisim me planifikuar masa kundër korrupsionit.

Dhe, ajo që është më skandalozja, dhe e cila vërtet e bën Grupin Parlamentar të Aleancës të votojë kundër, është përfundimi. Përfundimi thotë: në mënyrë që kjo të jetë e suksesshme, implementimi i strategjisë duhet të trajtohet seriozisht dhe nënkupton vullnetin politik dhe angazhimin financiar të Qeverisë. Pra, nëse një strategji edhe në dokumentin e vet thotë se kjo e tëra varet prej vullnetit politik të Qeverisë dhe angazhimit financiar, neve na bën me pas qëndrim të tillë, sepse kjo nuk do të ndodhë, prandaj një strategji e cila ashtu kështu është kot, dhe e cila nuk do të implementohet, nuk do ta marrë votën e Aleancës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë po pajtohem, deputetë, por realisht projekti Strategjia kundër korrupsionit 2012 – 2016 është e Agjencionit antikorrupsion, që është organ i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Qeveria, si duhet s'e ka lexuar dhe e ka miratuar...! Fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani!

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Shefja e Grupit! Duke marrë parasysh se ju potencuat mjaft mirë se kjo strategji është e Agjencionit kundër korrupsion, nuk është vonë të luftohet korrupsioni edhe sonte, edhe nesër, edhe pasnesër, mirëpo esenca është që të luftohet. Dhe këtu, të gjithë deputetë që janë këtu në këtë seancë, dhe më vjen mirë që është arrestuar personi i taks-forcës, pavarësisht në rast se gjykata nxjerr se ai person është i korruptuar, kishte me qenë mirë që shumë njerëz të korruptuar të gjenden aty ku e kanë vendin. Mirëpo, jo ne deklarohe mi, se ne jemi politikëbërës, ndërsa gjykata e ka fjalën e fundit. Ne bëjmë politika.

Projekt-strategjia kundër korrupsionit 2012 – 2016 dhashtë zoti që të zbatohet kështu si është përpiluar dhe më s'do të kemi mundësi në këtë sallë të Kuvendit të debatojmë për korrupsionin. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! I kemi edhe katër deputetë dhe unë i kisha lutur të jenë konciz dhe ta përmbyllim këtë seancë. Fjalën e ka deputeti Fatmir Xhelili!

FATMIR XHELILI: Përshëndetje, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Me të vërtetë po pajtohem me shumicën e asaj që thanë parafolësit, se strategjia në fjalë është një dokument që, përkundër dëshirës dhe tentimit të Grupit punues të kësaj strategjie për me nxjerr një strategji adekuate për ta luftuar këtë fenomen, që është fenomen shumë negativ dhe perceptimet janë negative në drejtim të kësaj dukurie po edhe vlerësimet e faktorëve që janë monitorues në luftimin e llojeve specifike të krimit dhe fenomeneve e dukurive negative në Kosovë, që u evidentua edhe nga Komisioni Evropian, përkundër dëshirës së tyre për të nxjerrë një strategji adekuate, që do t'i kishte koordinuar të gjitha institucionet tona për të vepruar në mënyrë të planifikuar dhe për t'i parashikuar veprimet adekuate në luftimin e saj, nuk ka dalë një strategji e tillë.

Ndoshta, sikur t'ia kishim ndërrua emrin dhe ta kishim quajtur strategjia parandaluese për korrupsion, ndoshta kishte pas kuptim ky Kuvend me e votuar këtë strategji.

Në start është gabimi, ku adresimi dhe përgjegjësia për hartimin e strategjisë, është orientuar te Agjencioni antikorrupsion, që në bazë të ligjit për veprimin e saj, nuk e ka mandatin e plotë të zbatuesit të ligjit për me hartuar një dokument të tillë strategjik dhe një plan të veprimit dhe sipas mendimit tim strategjinë në nivel shtetëror për luftimin e korrupsionit ka qenë e nevojshme me bë grupi punues ku ishin Policia e Kosovës, Prokuroria, gjyqësia, Administrata Tatimore, Dogana, Ministria e Financave dhe institucionet tjera të cilat kanë të bëjnë me pjesën parandaluese të strategjisë, pjesën ndëshkuese të strategjisë.

Tri komponentat e zbatimit të ligjit që janë kryesore në zbatimin e ligjit, siç është policia, gjyqësia dhe prokuroria, bashkë me doganat, ende nuk janë mekanizma dhe struktura që kanë kapacitet të mjaftueshëm për ta luftuar këtë dukuri dhe para se gjithash nuk është bërë një vlerësim real i rrezikut të korrupsionit nga Grupi punues vendor për të identifikuar qartë nivelet ku zhvillohet korrupsioni, metodologjitë si zhvillohet korrupsioni dhe duke i përcaktuar qartë metodologjitë, mënyrat dhe koordinimin e këtyre mekanizmave për ta luftuar korrupsionin, gjithherë duke i pas parasysh edhe nevojat e këtyre segmenteve për edukime shtesë, për trajnime shtesë, për plotësimin me mjete teknike e teknologji informative, në mënyrë që t'i arrijmë kapacitetet e plota.

Pikërisht, indikatorët të cilët flasin për suksesin a mos suksesin e këtij fenomeni, tregojnë se nuk është duke u bë punë e mjaftueshme në drejtim të luftimit të korrupsionit, duke filluar prej gjyqësisë, që ka problem dhe ende do të ketë problem prej pajisjes me teknike teknologjike për evidentimin dhe distalizimin e të dhënave të saj, deri te shqiptimi i dënimeve dhe ndëshkimeve të rënda për ata që e ushtrojnë këtë veprimtari, deri te koordinimi me prokurorinë dhe policinë për të qenë sa më efikas. Gjithsesi duhet potencuar edhe profilizimin e kuadrit gjyqësor për tu marrë edhe me luftimin dhe ndëshkimin e njerëzve që involvohen në këtë veprimtari se duhet me qenë një gjyqësi, ose disa gjyqtarë të profilizuar për këtë fushë-lëmi qysh duhet me qenë edhe prokurorë të profilizuar për këtë fushë-lëmi, siç është e profilizuar edhe drejtoria për luftë kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik në Policinë e Kosovës, e cila ka avancuar bukur shumë në drjetim të hetimit të rasteve të korrupsionit, mirëpo për fat të keq, ato nuk po

finalizohen në prokurori dhe gjyqësi, që edhe kjo është një mundësi dhe metodë për me hetuar pse nuk po finalizohen produktet e Policisë tonë përmes prokurorisë dhe gjyqësisë, kur Policia jonë ka të dhëna bukur të mira për shumë individë që janë të korruptuar, e pse mos me pranuar edhe publikisht këtë.

Besoj se ndoshta nderin dhe punën më të mirë vendit ia kishim bërë, sikur të kishim kthyer këtë strategji me një rekomandim që strategjia të hartohet në nivel shumë të gjerë, me elementet, grupet dhe institucionet të cilat i përmenda dhe me dalë prej saj një strategji me objektiva të qarta, me mekanizma të veprimit të përcaktuar në drejtim të koordinimit të aktiviteteve të tyre dhe me veprime konkrete të planifikuara në plan të veprimit për një afat kohor të caktuar, pse jo edhe afatshkurtër, trevjeçar e ndoshta edhe pesëvjeçar mirëpo duke marrë parasysh se do të vlerësohemi prej Komisionit Evropian edhe faktorëve që na monitorojnë, që do të jenë këto edhe vlerësime për raport të progresit, me siguri se duhet bërë.

Pavarësisht kërkesave dhe nevojave që të dëshmohej para Evropës dhe para monitoruesve se jemi të aftë me e luftuar korrupsionin, ajo fillimisht duhet me qenë dëshirë e vullnet i yni për ta luftuar korrupsionin sepse fundi i fundit ato janë paret tona, të hollat tona dhe po shkurtohen mundësitë e financimit të shumë projekteve që janë jetike dhe domethënëse për Kosovën, por edhe po shkurtohen financat për ata që kanë nevojë për ta përmirësuar mirëqenien e qytetarëve tanë. Kështu që unë sot nuk do ta votoj këtë strategji, ose me rekomandim që me u kthye e me u plotësuar me strategjinë të cilën jam duke e propozuar. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Ardian Gjini, e ka fjalën!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Sot është një pikë tjetër të rendit të ditës, dhe unë fola për mos seriozitetin institucional të Kosovës në tema tepër serioze dhe nuk fola në veçanti për një person, një ministër, një institucion por fola për mos seriozitetin total institucional për me iu qasur problemeve, dhe isha duke folur për integritet evropian.

Ajo që kemi parë atëherë është një tabelë, një tubë e detyrave që ia japin vetes pa menduar seriozisht me i krye ato detyra. Do të thotë një sjellje sikur e nxënësve të këqij që i bëjnë detyrat vetëm sa me i bërë, pa provuar me i marrë vesh, pa provuar me i studiuar, pa provuar me pa se çka po bëjnë, domethënë, duke shpresuar se mësuesi nuk i këqyrë bash mirë.

Ky mos seriozitet është evident, definitivisht, edhe tash. Domethënë në këtë element për të cilin po flasim, dhe më duhet me ju thënë se është mirë me provue në mënyrë kuantitative pak me shpjeguar se çka do me thënë mos seriozitet në këtë rast.

Qeveria jonë i ka 19 ministra, 3 zëvendëskryeministra që nuk kanë port-folio dhe kryeministrin, që bëjnë diku nga 54 njerëz, në fakt bëjnë 24 njerëz, plus i kanë 32 ministra dhe diku nga 180 këshilltarë politikë, do të thotë po flasim diku për 250 të emëruar politikë në Qeveri, të cilët, po ju garantoj se nuk e kanë lexuar këtë dokument. Sikur ta

kishin lexuar, nuk e kishin lëshuar kështu, për shkak se është goxha fyerje me e votu një dokument që të shanë, drejtpërdrejt. Dhe, Qeveria nuk ka treguar vullnet deri më tani me ofrua dokumente me vetëdije, të cilat e kritikojnë këtë mënyrë. Domethënë i kemi diku 25 të emëruar të lartë politikë që kanë kerre, shoferë, paga, telefona, e krejt dhe nuk e lexojnë një dokument, cili dokument është edhe baza me tregu se ne kemi njëfarë ideje për integritime evropiane – lufta kundër korrupsionit, nën - a. Domethënë a-ja e nisjes. Kjo është ajo, domethënë, çka ne jemi duke parë këtu e aq më tepër, domethënë pa dashur me hy në detaje, serioziteti shihet edhe me mospjesëmarrje të Qeverisë kur hartohet ose kur votohet në Kuvend një dokument i tillë.

Aspekt tjetër, është se është e vërtetë që dokumentin e ka prodhuar Agjencioni antikorrupsion dhe mendoj se në Kosovë është goxha interesant me kuptuar se Agjencioni antikorrupsion nuk e lufton korrupsionin. E në fakt, edhe nuk është aty për me e luftue korrupsionin.

Agjencioni Antikorrupsion është për me iu ndihmue institucioneve të Kosovës me e luftue korrupsionin. Ky është roli i Agjencionit. Përndryshe, ne kishim mund me u sjell në vazhdimësi sikur sot. Me i thënë Agjencionit bëni ju strategjinë, nuk kemi nevojë as me e lexue atë strategji që e keni bërë ju, se ju jeni për me e luftue korrupsionin, ne eventualisht “me e bërë” – në thonjëza. Dhe sjellja që po e shohim sot, është tipik e tillë: Agjencioni e prodhon një dokument që e quan strategji e mirë ose e keqe dhe nuk po dua me hy në atë temë dhe atë dokument që e ka prodhue një institucion i Kosovës, që e kemi themeluar ne në Kuvend, është e vërtetë, Qeveria e Kosovës e kalon, e voton dhe e kalon pa e këqyrë se çka ka, se as që i intereson ajo punë. As që i intereson hiq bile, se çka prodhuar një agjencion i tillë. Dhe, kjo është e vërteta. Nuk ka të vërtetë tjetër këtu.

E prapë, po them, mospjesëmarrja e dëshmon, pra, është edhe një dëshmi shtesë mospjesëmarrja e Qeverisë për këtë.

Çështje tjetër është edhe futja në agjendë si pikë e fundit e rendit të ditës, kur gjithkush në Kosovë, po thotë se kemi problem me korrupsionin, kur vetë Agjencioni antikorrupsion po na e prodhon këtë dokument që po e voton Qeveria e që kemi problem me korrupsionin, kur e gjithë dynjaja po na thotë se kemi problem me korrupsionin – po edhe Unioni Evropian, që po domi me u integruar, e sot e kemi kaluar njëfarë dokumenti, Qeveria nuk do as me ndie, dhe nuk është këtu.

Çështje tjetër, të cilën desha me e përmend, përpos asaj që mos pritni se Agjencioni e lufton korrupsionin, institucionet duhet me e luftuar me ndihmën e Agjencionit e po shihet që s’e kanë as në plan, është zoti kryetar, sot nja dy ose tri herë ju iu keni drejtuar deputetëve, iu keni thënë që – mos ju po merreni me perceptcion, kur kanë folur për korrupsionin. Po më duket që është koha me t’thënë që nuk jemi duke folur për perceptcion. Nuk është perceptcion korrupsioni në Kosovë, për deri sa edhe dokumentet zyrtare të cilat sot priten me u votue këtu, po tregojnë çfarë korrupsioni ka, nuk është perceptcion korrupsioni. Le t’me falin deputetët tjerë që po i parafrazoj, por ata thanë se ka korrupsion, se perceptcioni për korrupsionin është në rritje, dhe ju iu thatë mos folni

për perceptcion. Kanë gabuar që kanë thënë se është perceptcion. Nuk është perceptcion. Është e vërtetë! Faleminderit!

KRYETARI: Jo, unë më tepër kam thirrur për të debatuar e të diskutuar për atë që është në rend të ditës. Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Kolegë deputetë,

Faktikisht ne kemi pasur rastin ta shqyrtojmë edhe në komisionin funksional, në Komisionin për legjislacion dhe mendimi ka qenë i ndarë me arsye që shumica u potencuan edhe nga kolegët deputetë, por parafrazimi kryesor i takon asaj sepse legjislacioni në fuqi që është i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ndarja e pushteteve, nuk reflekton me këtë strategji të paraqitur dhe me këtë plan të veprimit.

Për këtë u cekën shumë arsye dhe shumë deklarata nga kolegët tanë. Unë mund t'i përsëris disa prej tyre të cilat vetëm e devalvojnë vlerën dhe luftën kundër korrupsion, pa dashur me hy në detale, apo në atë që ne po e quajmë brengën kryesore të të gjithëve se sa po luftohet korrupsioni në të gjitha nivelet.

Arsyeja pse Qeveria e ka kaluar lehtë këtë strategji kundër korrupsion, nuk duhet të anashkalohet...

KRYETARI: Deputetë! Jemi në përfundim, ju lutem për qetësi!

ARMEND ZEMAJ: Me të vërtetë, këtë strategji e ka Agjencioni në fjalë, por komunikimi në mes Kuvendit është bërë përmes kryeministrit Hashim Thaçi me nënshkrimin e tij dhe ne sot konkretisht po debatojmë për këtë strategji. Nuk është me rëndësi këtu që të luajmë ping-pong në mes veti a pajtohemi apo jo me ato se a ka korrupsion, por esenca është që Kuvendi të nxjerrë rekomandime dhe ta begatojë këtë strategji me shumicën që u thanë:

E para, roli i Agjencisë kundër korrupsion është parandalues, preventiv, ndërsa këtu janë përzier rolet dhe janë përzier kompetencat dhe kjo strategji do të mbetet vetëm letër, do të mbetet jo efikase dhe e cila do të jetë jo e zbatueshme. Atëherë, interesi i kujt është që mos të zbatohet kjo strategji, lind pikëpyetja nga organet të cilat janë shumë, domethënë që janë të thirrura për ta zbatuar ligjin, siç është Policia, Prokuroria, gjykatat, por edhe vetë Agjencioni.

Nuk është, apo të them më mirë është jo serioze, të ceken gjërat të cilat për ne janë të papranueshme. Të thuhet që është miratuar ligji për konfiskimin e pasurisë, të thuhet se ekziston agjencioni për konfiskim. Ekziston agjencioni për menaxhimin e pasurisë së konfiskuar dhe dihet cili është roli dhe cila është përgjegjësia e tij. Dhe, nuk është e drejtë dhe nuk mund të përzihen kompetencat e prokurorisë, policisë me Agjencionin kundër korrupsion.

Sot ne kemi edhe një Këshill të famshëm të ndërtuar nga presidentja, një këshill koti i cili edhe ai, po ashtu, do ta luajë rolin e njëjtë në letër sikur kjo strategji e cila për mua është shumë e dyshimtë se sa do të implementohet. Unë vetëm po e mbështes propozimin të cilin e tha njëri prej kolegëve tanë, t'i kthehet Qeverisë për ridraftim, të hiqen të gjitha këto dilema dhe elemente të cilat e devalvojnë luftën kundër-korrupsion, e devalvojnë edhe rolin e Kuvendit mbikëqyrës sepse, shihni çka thotë: dekretimi i vendimit për bashkëpunim të përhershëm në mes të Kuvendit dhe Qeverisë në lidhje me zbatimin e politikave kundër korrupsion dhe ka edhe – miratimi i rregullave të qarta dhe transparente për emërimin e të gjitha organeve publike që punojnë nën autoritetin e Qeverisë. Janë ligjet, zotëri të nderuar! Nuk ka nevojë që ne të zbulojmë rregulla ndryshe, ashtu siç e thonë të gjitha ligjet.

Dhe, sidomos te monitorimi i zbatimit të legjislacionit dhe roli i Kuvendit, aq është i paqartë këtu dhe aq është parafrazuar në mënyra dhe në forma të cilat jo që nuk i bëjnë nder luftës kundër korrupsionit dhe Qeverisë, por vetëm tregojnë një jo seriozitet të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës, pa dallim. Dhe, atëherë cili do të jetë roli i Kuvendit si organ mbikëqyrës ligjvënës dhe si pushtete të ndara.

Prandaj unë propozoj që kjo t'i kthehet Qeverisë, Qeveria e di formën e komunikimit, t'i mbledhë të gjitha këto dikastere që i ka potencuar dhe ta harmonizojë luftën kundër korrupsion dhe t'i ndajë përgjegjësitë sipas dikastereve. Se ne, nëse sot kemi iks zëvendëskryeministra, që tash, për shembull i kemi 5 zëvendëskryeministra që merren me politikën e jashtme, nga 5 që merren me politikën nacionale, 5 që merren për sektorin e shëndetësisë, e thuhet që janë edhe 5 që luftojnë korrupsionin, ose janë pjesë e korrupsionit. Më mirë, nuk është e tepërt të thuhet edhe ajo.

Prandaj, mos të shikohen edhe diskutimet e deputetëve, me ndonjë tendencë të theksuar sepse roli ynë, atëherë edhe përgjegjësia jonë do të japin llogari para dikujt dhe dikush ata janë qytetarët e Republikës së Kosovës. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu! Ju kisha lutur, e përmbyllni deri në 5 minuta, mos ta zgjasim shumë, sepse jemi në fund.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Korrupsioni është sëmundje e cila është duke brejt shoqërinë tonë që nga pas lufta, prandaj çdo sëmundje fillimisht duhet të diagnostifikohet saktë dhe pastaj të merret me shërimin e saj.

Agjencia antikorupsion dhe Qeveria e Kosovës e kanë bërë përshkrimin real të gjendjes çfarë është, që i bie diagnostifikimi i saj dhe pastaj ne të gjithë duhet së bashku të japim kontributin në hartimin e strategjisë, që i bie për shërimin definitiv të shoqërisë nga një sëmundje e keqe.

Prandaj, unë i kam përgatitur, i nderuar kryetar këtu disa rekomandime, sa i përket strategjisë, mirëpo për të mos marrë kohën e të nderuarve deputetë dhe për ta respektuar kërkesën tuaj për të qenë konciz, unë fjalimin tim do t'ia dorëzoj administratës. Ju faleminderit!

(Diskutim i dorëzuar me shkrim)

BEKIM HAXHIU: I nderuari kryetar!

Këtu do të paraqes vetëm disa elemente që duhet të kihen parasysh në luftën antikorruicion, si:

Nën 1. Politikat e qarta antikorruption,

Nën 2. Legjislacioni antikorruption,

Nën 3. Bashkëpunimi ndërkombëtar,

Nën 4. Bashkëpunimi me qytetarët, dhe

Nën 5. Analiza dhe raporte, Plani i veprimit.

Politikat Antikorruption

Kuvendi i Kosovës duhet udhëzoi hartimin e politikave antikorruption, bashkë me Strategjinë antikorruption, si dhe të krijoj instrumente për zbatim dhe monitorim të politikave dhe strategjisë antikorruption.

Legjislacioni antikorruption

Duhet të shikohet se legjislacion në i hartuar, a është ëi mjaftueshëm për të arritur objektivat ne luftë kundër korrupsionit dhe për të implementuar strategjinë antikorruption.

Bashkëpunimi me qytetarët: Mendoj se është çelësi i luftës antikorruption, duhet promovuar bashkëpunim me qytetarët ne luftën antikorruption.

Bashkëpunimi ndërkombëtar, është shumë i rëndësishëm në luftën antikorruption dhe duhet të merren edhe tek ne përvojat e vendeve që kanë arrite suksesshëm ta lufto këtë të keqe të shoqërisë.

Dhe në fund, Analiza dhe raporte duhet të jenë të sakta duke pasqyruar atë që është, ngase ka ndodhur në të kaluarën që këto mekanizma shpeshherë në raportimet e tyre dhe në analiza, kanë ditur ta shpërndajnë përgjegjësinë dhe hedhin fajin ne institucione tjera, ndërsa qytetarit nuk i intereson kush po raporton ma mirë e kush më keq, ... por kush ma tepër po arrin të luftoj korrupsionin.

Dhe gjithsesi qytetarët janë faktor shumë me rëndësi n luftën antikorruption duke bashkëpunuar me institucionet gjegjëse të hetuesi dhe drejtësi.

(Bekim Haxhiu,d. v.)

KRYETARI: Deputet, jemi në fund të debatit. Nuk kemi më të lajmëruar...! Për fjalë u paraqit deputeti Sabri Hamiti!

SABRI HAMITI: Unë, shkurt do të flas!

Së pari, do të flas në dobi të kryeparlamentarit Krasniqi! Se s'mendon që korrupsioni në Kosovë është perceptcion, ky e ka dëshmuar me nënshkrimin e një dokumenti në mes Parlamentit Evropian dhe Parlamentit të Kosovës, dokument i prodhuar në bazë të bisedimeve dyditëshe në Bruksel, ku njëra prej pikave, thotë:

“Korrupsioni në Kosovë është sistematik dhe sistemor”. Ai dokument është. Është i shpërndarë, është dokument zyrtar.

Pra, ju e keni nënshkruar e unë besoj se s'mund të ju thotë kurrkush që e konsideroni perceptim. E kisha fjalën për atë, nga biseda që u bë këtu.

Është dokumenti! Dhe secili e ka marrë, dhe mund ta shikojë.

E dyta. Pa një ligj, që në kuptimin popullor e kanë quajtur anti-mafia, në të vërtetë është Ligji për konfiskim të pasurisë së paligjshme, nuk ka shans që të bëhet detyrimisht funksionues ajo që po quhet “luftë kundër korrupsionit”.

Dokumenti është pa klishe dhe të gjitha dokumentet parashikues, që i kanë katër vite, janë pak a shumë klishe, mos u çuditni. Edhe Agjencia, s'e ka prodhuar vet, po ju garantoj, por është dokument klishe, të cilën klishe e ka bë Agjencia, klishe e ka përcjell deri te ne Qeveria, po ne mund t'i themi se është klishe dhe ta kthejmë në ripunim dhe në specifikim.

(Ndërhyrje)

Po e ka përcjell te ne!

Tutje. Problemi është bërë pak formale. Kjo puna lufta kundër korrupsionit dhe kjo bëhet më pak luftë për aq sa rriten institucionet. Janë katër a pesë që i di unë deri tash, që pretendojnë ta marrin flamurin ose bajrakun e kësajfarë lufte. I fundit është ai Këshilli nacional, që e ka bërë presidentja. Dhe, ju e dini shumë mirë që në publik ndryshe bisedohet për atë Këshill, dhe duhet të jemi parlamentarë të vërtetë dhe përfaqësues popullorë, e ndryshe kur mblidhet ai.

Në publik, pjesëmarrësit e saj posa dalin thonë nuk është ligjore, nuk është kushtetuese. Atje shkojnë dhe marrin dorë e thonë është. A mundet një këshill i tillë dhe organizmat e tillë vërtet të luftojnë korrupsionin në Kosovë? Kuvendi, duhet ta shqyrtojë këtë problem,

edhe task-forca, edhe Këshilli nacional kundër korrupsionit, edhe strategjitë që i ndërton Agjencia kundër korrupsionit.

E unë mendoj që Kuvendi, së paku, duhet t'i jep zor ta krijojë ligjin themelor dhe ligjet që duhet të plotësohen dhe kanë të bëjnë me konflikte interesash. Kjo është pjesa legislative që na takon ne. Pjesa tjetër, është përcjellje e ekzekutivit të Kosovës. Kjo është pjesa e vërtetë që i takon Kuvendit.

Në këtë vështrim, unë sa dëgjova diskutimet, ndoshta po afrohen idetë që kjo kështu të mos kalojë sot, por të kthehet dhe të ripunohet. Faleminderit, zotni kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi në përfundim.

Më lejoni t'i them edhe unë tri-katër fjalë, si deputet dhe po i them nga kjo pozitë që jam këtu.

Thuhet një fjalë “shumë mami e rrezikojnë fëmijun”! Realisht, në Kosovë janë formuar shumë institucione, prej atyre ligjore e deri te ato jo ligjore, që nuk parashihen me asnjë ligj dhe as me Kushtetutë dhe e kemi këtë gjendje që e kemi.

Unë mendoj që kjo projekt-strategji që është ardhur, kundër korrupsionit, është e Agjencisë antikorruption, të cilën në një mënyrë e tha edhe deputeti Ardian Gjini, po e them edhe unë. Unë po theksoj se, megjithatë, dy detyra:

Detyra e parë është, pak a shumë me bë zhurmë në opinion. Dhe detyra e dytë është – nëse i shkojnë njerëz, ka të dhëna, ato të dhëna i dorëzon në prokurori dhe aty përfundon detyra e obligimi i këtij agjencioni.

Nëse sistemi i drejtësisë, duke përfshirë edhe Policinë për krime ekonomike, nuk e kryejnë detyrën e tyre mbi bazën e ligjeve që janë në fuqi, ne mund t'i hipim në qafë këtij agjencioni, dhe ky mundësi tjera nuk ka, përveç një komunikim me opinionin dhe dorëzim të materialeve ose fakteve, nëse i ka, për t'i dorëzuar në prokurori. Dhe nëse sistemi i mëtejshëm, sistemi që është përgjegjës për ta luftuar këtë mungon, realisht ky agjencion nuk ka kompetenca të tjera. Jam dakord që edhe ne si deputetë, nëse e kemi përcaktuar dhe e kemi bindjen se ne kemi detyrë parësore detyrën e deputetit dhe jo detyrë dytësore, atëherë duhet të merremi ndoshta edhe me hartimin e ndonjë ligji dhe unë jam për atë që e ngriti deputeti, nënkryetari i Kuvendit Sabri Hamiti, që të bëhet ky ligj për konfiskimin e pasurisë të ngritur në mënyrë të paligjshme.

Po dua edhe në herë ta them. Unë mendimin tim e kam shumë të qartë ndaj korrupsionit, por si drejtues i seancës dhe si kryetar i Kuvendit me përgjegjësinë ta respektojmë rendin e ditës që e kemi, kërkesa ime ka qenë që deputetët të janë në rend të ditës, e pastaj nëse deputetët donë me debatuar edhe çështjen e korrupsionit, le ta bëjnë kërkesën që të hyjë në rend të ditës, dhe mundet secili ta thotë fjalën e vet. Por, rendi i ditës edhe për ta respektuar, se përndryshe seancat kurrë nuk përfundojnë nëse nuk respektohet rendi i ditës.

Të nderuar deputetë, prezentë i kemi 68 deputet që do të thotë se mund të shkojmë në votim.

E kemi shqyrtuar - **Raportin vjetor të Autoritetit të konkurrencës së Kosovës për vitin 2011**, na ka mbetur pra vetëm votimi.

Raporti thotë që të miratohet ky raport dhe lus deputetët e regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 57 vota për, 2 kundër dhe 5 abstenime, Kuvendi e miratoi Raportin vjetor të Autoritetit të konkurrencës së Kosovës për vitin 2011.

Në radhë e kemi votimin për - **Raportin vjetor të Organit shqyrtues të prokurimit publik për vitin 2011**.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 54 vota për, 7 kundër dhe 6 abstenime, Kuvendi e miratoi Raportin vjetor të Organit shqyrtues të prokurimit publik për vitin 2011.

Tash votojmë për pikën e nëntë: - **Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit rregullativ të prokurimit publik**.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 54 vota për, 4 kundër dhe 8 abstenime, Kuvendi e miratoi Raportin vjetor të Komisionit rregullativ të prokurimit publik për vitin 2011.

Dhe, në fund e kemi për votim, pas shqyrtimit të saj: – **Strategjia e planit të veprimit kundër korrupsionit për vitin 2012 – 2016**.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 19 vota për, 39 kundër dhe 6 abstenime, Kuvendi nuk e miratoi Strategjinë dhe planin e veprimit kundër korrupsionit për vitin 2012 – 2016.

Me kaq, kjo seancë i përfundon punimet. Shihemi nesër në ora 10.

E përgatiti:

Njësia për transkriptim e Kuvendit të Kosovës